

FAQE 01

FAQE 02

MONITORIMI I SIGURISË NË KOSOVË NGA PERSPEKTIVA GJINORE

Botues: Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Drejtores e hulumtimit: Luljeta Vuniqi

Udhëheqëse e hulumtimit: Sibel Halimi

Ekipi hulumtues: Albulena Metaj, Artan Krasniqi, Florie Xhemajli, Laura Berisha

Lektura: Bekim Kupina

Redaktimi Teknik, Dizajni dhe Shtypi: Delja e Zezë (DZG | info@dzgonline.com)

© 2007 Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Të gjitha të drejtat e rezervuara


www.kgscenter.org

Ky hulumtim është financuar nga:

Kvinna Till Kvinna

Swiss Agency for Development and Cooperation/ SDC in Prishtina

Network Women Program – Open Society Institute (OSI), New York



FAQE 03**PËRMBAJTJA**

04	HYRIA
06	AKRONIMET
07	KONKLuzionET
016	REKOMANDIMET
019	KONCEPTET DHE PERCEPTIMET E BURRAVE DHE GRAVE MBI SIGURINË
022	MENDIMET E DISA AKTERËVE MBI ÇËSHTJEN E DEFINIMIT TË SIGURISË, NGA PERSPEKTIVA GJINORE
024	REZOLUTA 1325 "GRATË, PAQJA DHE SIGURIA"
026	NJOHURIA MBI REZOLUTËN 1325 NGA PËRFAQËSUES TË MEKANIZ MAVE IMPLEMENTUES
029	GRATË DHE ROLI I TYRE NË NDËRTIMIN E PAGES NË KOSOVË
030	STRUKTURA GJINORE DHE POZITAT VENDIMMARRËSE NË INSTITUCIONET E KOSOVËS
031	STRUKTURA GJINORE DHE POZITAT VENDIMMARRËSE NË INSTITUCIONET E SIGURISË NË KOSOVË
036	TRAJNIMET NGA FUSHA E BARAZISË GJINORE TË ORGANIZUARA NË INSTITUCIONET E SIGURISË NË KOSOVË
037	MBROJTJA DHE RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË GRAVE NË KOSOVË
038	DHUNA NË FAMILJE
045	TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE
055	NDIKIMI I ARMËVE TË VOGLA DHE TË LEHTA NË DHUNËN GJINORE
059	PËRDORIMI I ARMËVE TË VOGLA DHE LEHTA NË DHUNËN NË FAMILJE
061	SIGURIA E GRAVE DHE BURRAVE NË BURGJET E KOSOVËS
068	ARSIMI DHE SIGURIA
072	DHUNA NË SHKOLLA DHE DUKURITË TJERA QË RREZIKOJNË SIGURINË E NXËNËSVE DHE MËSIMDHËNËSVE
075	EKONOMIA DHE SIGURIA
081	KUJDESI SHËNDETËSOR DHE SIGURIA
083	NDËRPRERJA E SHTATZËNISË (ABORTI)
087	KANCERI I GJIRIT
089	HIV/AIDS
091	EPIDËMITË
092	USHQIMI
093	UJI
094	AJRI
095	SIGURIA E GRUPEVE ETNIKE NË KOSOVË
097	QASJA NË ARSIM DHE SHËNDETËSI
0100	ANEKSET
0100	REALIZIMI I HULUMTIMIT
0102	LISTA E TË INTERVISTUARVE
0104	BIBLIOGRAFIA

FAQE 04

HYRJE

Në Kosovë, si edhe në vende të tjera të botës, koncepti tradicional i sigurisë nënkupton dy faktorët kryesorë të sigurisë së vendit: ushtrinë dhe policinë. Për këtë arsye, të gjitha diskutimet e deritanishme për çështjet e sigurisë dhe për sistemin e ardhshëm të sigurisë në Kosovë, është përqendruar kryesisht rreth Shërbimit Policor të Kosovës dhe ushtrisë së ardhshme të Kosovës.

Këto diskutime rrallë ndonjëherë kanë trajtuar aspektet e sigurisë që janë 'më pak tradicionale' dhe të cilët do të përfshinin pikëvështrimet e grave në çështjet si: armët e lehta dhe ndikimi i tyre në dhunën e bazuar në gjini, liria e lëvizjes për gratë dhe burrat (jo vetëm në baza etnike), dhuna në familje, trafikimi, siguria e shëndetit dhe ambientit, etj.

Qëllimi i këtij studimi është shqyrtimi i çështjeve të ndryshme të sigurisë nga perspektiva gjinore, me theks të veçantë në çështjet e sigurisë "jo tradicionale" apo të "sigurisë njerëzore", term ky i cili po përdoret gjithnjë e më shumë kur flitet për çështjet e sigurisë "jo tradicionale". Në këtë studim janë trajtuar disa nga çështjet e sigurisë njerëzore të cilat afektojnë jetën e burrave dhe grave në mënyra të ndryshme, perspektivë kjo që shpeshëherë nuk merret në konsiderim nga vendimmarrësit dhe politikëbërësit në Kosovë.

Rezultatet e raportit e kanë vënë në pah se qasja e grave në vendim-marrje në institucionet e sigurisë dhe në proceset e ndërtimit e të ruajtjes së paqes është shumë e kufizuar. Këto rezultate po ashtu shtrojnë nevojën e rritjes së përfaqësimit dhe të përfshirjes së tyre. Për të siguruar këtë, njëri prej shumë rekomandimeve të dalura nga ky raport është që gjatë hartimit të politikave dhe strategjive nga ana e autoriteteve dhe institucioneve që garantojnë sigurinë në Kosovë, të merren për bazë aspektet e sigurisë njerëzore dhe perspektiva gjinore.

Gratë nga shoqëria civile luajtën një rol të rëndësishëm në vetëdijesimin e vendim marrësve për implementimin e Rezolutën 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria". Ato parashtuan gjithashtu edhe një varg çështjesh të rëndësishme

FAQE 05

që kanë të bëjnë me sigurinë e grave gjatë tetë viteve të fundit. Megjithatë, në përgjithësi ato nuk u përfillen nga institucionet qeveritare, dhe rrjedhimisht, ndikimi i tyre në sektorin e sigurisë në Kosovë mbetet ende i ulët. Të dhënat dhe analizat që dalin nga ky raport përkitazi me çështjet e sigurisë njerëzore në Kosovë, tregojnë se shkalla e rrezikshmërisë së grave dhe vajzave është në rritje, sidomos në fushën e dhunës në familje dhe trafikimit.

Të jetuarit pa frikë nga dhuna është e drejtë fundamentale e jo privilegj, prandaj institucionet e sigurisë dhe të gjithë faktorët e tjerë shoqërorë në Kosovë duhet të punojnë në mënyrë të vazhdueshme në krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë. Për të arritur këtë duhet të ndërtohen kapacitetet, të ngritet vetëdija e popullatës në përgjithësi dhe e vendim-marrësve në veçanti, duhet të sigurohen të dhëna të sakta, të funksionalizohen mekanizmat institucionalë dhe të ndërtohen mekanizma të tjerë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare për implementimin e Rezolutës 1325 dhe për përmirësimin e avansimin e sigurisë e të pozitës së grave në shoqëri.

Luljeta Vuniqi,
Drejtoresh Ekzekutive

FAQE 06**Lista e shkurtesave**

ABGJ	Agjensioni për Barazi Gjinore
AVL	Armët e Vogla dhe të Lehta
AVUK	Agjencioni i Veterinarisë dhe i Ushqimit të Kosovës
DASHC	Departamenti i Administratës të Shërbimit Civil
FIQ	Forumi i Iniciativës Qytetare
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KFOS	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
KIP	Programin e Iniciatës Kosovare
KIPRED	Instituti Kosovar për Kerkime dhe Zhvillim të Politikave
KLMDNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
KOGJ	Klinika Obstetrike-Gjinekologjike
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
QK	Qendrat Korrektuese
QKSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
RAE	Romë, Ashkali dhe Egjiptian
RRGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
RSSB	Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme
RZHNUK	Raporti i Zhvillimit Njerëzor të Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UNAIDS	Joint United Nations Programme on HIV/AIDS
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UNFPA	United Nations Fund for Population Activities
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNIFEM	Fondi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara për Gratë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZKM	Zyra e Kryeministrit

FAQE 07**KONKLuzionet****Perceptimet e burrave dhe grave mbi sigurinë**

Përderisa, qasja e sigurisë tradicionale i referohet shtetit dhe politikat e saj janë të dizajnuara për të promovuar kërkesat që i atribuohen shtetit më shumë sesa individëve, siguria njerëzore nënkupton çdo gjë që u nevojitet burrave dhe grave në botë: ushqim i mjaftueshëm për familje, strehim i përshtatshëm, shëndet, arsimim, mbrojtje nga dëmet e shkaktuara nga njeriu ose natyra, si dhe një shtet, i cili nuk i shtyp qytetarët e tij, por që udhëheq me miratimin e tyre.

Të intervistuarit, përfaqësues të institucioneve dhe mekanizmave të sigurisë në Kosovë, shoqërisë civile dhe institucioneve ndërkombëtare, kanë pasur këndvështrime të ndryshme lidhur me konceptin e sigurisë. Disa prej tyre më shumë i ofrohen qasjes tradicionale të sigurisë, derisa pjesa tjetër sigurinë e lidhin me çështje të tjera, të cilat si të tilla i ofrohen më shumë qasjes së sigurisë njerëzore. Gratë dhe burrat kanë perceptime të ndryshme mbi sigurinë. Kjo vije si rezultat i pozitës, përvojave, nevojave dhe roleve të ndryshme që ata kanë në shoqëri. Përderisa gratë kanë bindjen se atyre u kanoset rreziku në çdo sferë të jetës, burrat mendojnë së gratë janë më të rrezikuara nga trafikimi, sulmet dhe plaçkitjet në rrugë (nga diskutimet në fokus grupe të QKSGJ-së).

Në bazë të rasteve të raportuara në SHPK vërehet se numri më i madh i viktimave të trafikimit të qenive njerëzore, dhunës në familje, ngacmimit seksual, dhunimit janë gratë.

Përkundër faktit se OJQ-të aktive të grave kosovare me sukses kanë parashtruar një varg çështjesh të rëndësishme që kanë të bëjnë me sigurinë e grave gjatë tetë viteve të fundit, në përgjithësi ato nuk përfillen nga institucionet qeveritare, ndaj ndikimi i tyre në sektorin e sigurisë mbetet i ulët.

Rezoluta 1325, "Gratë, Paqja dhe Siguria"

Rezoluta 1325 nuk njihet nga shumë institucione qeveritare. Madje, Rezoluta si e tillë nuk ka një sendërtim konkret nga mekanizmat ndërkombëtarë në Kosovë.

FAQE 08

Shërbimi Policor i Kosovës dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës kanë njohuri dhe marrin për bazë Rezolutën 1325.

Gratë nga shoqëria civile luajnë një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e vendimmarrësve për Rezolutën 1325. Kjo bëhet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si p.sh: takimet me vendimmarrësit, organizmi i debateve në media, organizimi i trajnimeve dhe protestave, projekteve, rrjetëzimeve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare, nëpërmes të cilave lobuan në promovimin e implementimit të kësaj Rezolutive.

Gratë aktiviste përdorën Rezolutën 1325 si mjet avokues për pjesëmarrjen e grave në bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës.

Të gjithë mekanizmat për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë, e posaçërisht Agjencia për Barazi Gjinore, nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm, legjitimitet dhe status të qartë. Këto probleme institucionale kanë ndikim negative në gjendjen e gruas në Kosovë.

Struktura Gjinore dhe pozitat vendimmarrëse në Institucionet e Kosovës

Në Kosovë janë bërë hapa të dukshëm në avancimin e pozitës së grave në IPVQ, mirëpo ende mbetet shumë për t'u bërë që të arrihet nivel i përfaqësimit gjinor, siç është paraparë me Ligjin për Barazi Gjinore, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Përfaqësimi gjinor në strukturat udhëheqëse në Kosovë është jo proporcional. Raporti i përfaqësimit gjinor në poste udhëheqëse është përafërsisht 1 me 10 në favor të burrave.

Struktura Gjinore dhe pozitat vendimmarrëse në Institucionet e Sigurisë në Kosovë

Gratë janë në nivel të ulët të përfaqësimit në institucionet vendimmarrëse dhe në institucionet e sigurisë.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Siguri është 14, prej tyre 4 gra dhe 10 burra.

Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, struktura gjinore e të punësuarve është e dominuar nga burrat, prej 725 të punësuarve, 436 janë burra dhe 289 janë gra. Prej tyre në pozitat udhëheqëse janë 8 gra.

FAQE 09

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Ministrinë e Drejtësisë është 246. Prej tyre 73.90 përqind janë burra dhe vetëm 26.10 përqind gra. Përfaqësimi i grave në strukturat e Shërbimit Policor të Kosovës është rreth 14 përqind. Krahasuar me përqindjet tjera të përfaqësimit të grave në institucione të sigurisë në Kosovë, mund të thuhet se kjo përqindje është relativisht e mirë. Stafi aktiv punonjës i TMK-së përbëhet nga një numër shumë i vogël i grave. Prej tyre numri më i madh janë në pozitën e tetares (22), rreshtere (16), kaptere (19), togere (10), kapitene (12), majore (3), nënkolonele (1) dhe kolonele (1). Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Shërbimin Korrektues të Kosovës është 1.850. Prej tyre 1.305 ose 82.59 përqind janë burra dhe 275 ose 17.40 përqind gra.

Trajnimet e organizuara nga perspektiva gjinore në institucionet e sigurisë në Kosovë

Institucionet e Sigurisë në Kosovë, si Shërbimi Policor i Kosovës dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës, ndjekin dhe organizojnë trajnime nga fusha e barazisë gjinore. Këto trajnime janë përkrahur kryesisht nga UNIFEM-i.

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të grave

Në Kosovë janë hartuar një sërë ligjesh dhe strategjish për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave në Kosovë, por problemi më i madh mbetet implementimi dhe respektimi i tyre. Legjislacioni mbi çështjet e barazisë gjinore nuk është i përshtatur me situatën ekzistuese në Kosovë.

Dhuna në familje

Është rritur numri i raportimit të rasteve të dhunës në familje në Shërbimin Policor të Kosovës.

Bazuar në të dhënat e marra nga SHPK-ja, dhuna në familje më shumë prekë gratë sesa burrat. Prej 1.370 rasteve të raportuara në vitin 2005, 1.107 ose 81 përqind janë gra dhe vetëm 19 përqind janë burra. Ndërkaq, për vitin 2006 numri i viktimave është 77 përqind gra dhe 23 përqind burra.

FAQE 010

Dhuna në familje më së shpeshti është e shprehur te çiftet bashkëshortore. Megjithatë, rastet e dhunës në familje nuk kufizohen vetëm në relacionet bashkëshortore. Dhuna në familje ka një shtrirje më të gjerë dhe marrëdhënia familjare në mes të viktimës dhe të kryesit prekë edhe relacione të tjera brenda familjes së gjerë.

Procedurat gjyqësore në trajtimin e rasteve të dhunës në familje zakonisht vonohen, duke mos u respektuar kështu Rregullorja 2003/12, sipas së cilës kërkesa për mbrojtje duhet të vendoset brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e marrjes së kërkesës nga gjykata.

Në përgjithësi mediat, gjatë raportimit dhe trajtimit të dukurisë së dhunës në familje, nuk tregojnë ndjeshmërinë e duhur, për më tepër shpesh herë me gjuhën të cilën e përdorin, konfirmojnë dhe forcojnë paragjykimet ekzistuese karshi kësaj dukurie.

Mungojnë mekanizmat institucional për risocializimin e viktimës së dhunës në familje, dhe për këtë arsye në të shumtën e rasteve mundësia e vetme që u mbetet viktimave është kthimi në ambientin e njëjtë ku janë keqtrajtuar më parë.

Trafikimi i qenieve njerëzore

Numri i vajzave që trafikohen brenda për brenda Kosovës është në rritje. Në Kosovë, viktima më të shpeshta të trafikimit janë gratë dhe vajzat, të cilat kryesisht trafikohen me qëllim të shfrytëzimit seksual.

E përbashkëta e të gjitha raporteve mbi trafikimin e qenieve njerëzore, është se shumica e viktimave vijnë nga viset rurale, me status të ulët socio-ekonomik dhe nivel të ulët të arsimimit.

Shpeshherë, për shkak të mentalitetit, viktimat e trafikimit nuk kanë përkrahje nga familja dhe shoqëria dhe në të shumtën e rasteve etiketohen si prostituta. Mungon vullneti politik i institucioneve ndëkombëtare dhe vendore për luftimin e dukurisë së trafikimit në Kosovë.

Ndikimi i armëve të vogla dhe të lehta në dhunën gjinore

Armët vrasin dhe plagosin më shumë burrat sesa gratë.

Kosova, zë vendin e parë si për nga numri i kryesve të veprave ashtu edhe nga numri i viktimave në krahasim me 5 vende të Ballkanit (Shqipëri, Bosnjë

FAQE 011

e Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Mal të zi. Nga numri i përgjithshëm i autorëve të krimeve me armë zjarri në Kosovë, 98 përqind prej tyre kanë qenë burra, ndërsa vetëm 2 përqind prej tyre gra. Të dhënat tregojnë se burrat jo vetëm që janë kryes më të shpeshtë të krimeve, por janë edhe viktimat. Kësisoj nga numri i përgjithshëm i viktimave në Kosovë, 93 përqind janë burra, ndërsa 7 përqind gra.

Në fokus grupet e organizuara nga QKSGJ-ja, gratë dhe burrat pjesëmarrëse, pajtohen se në Kosovë ka numër të madh të armëve të vogla dhe të lehta në duar të qytetarëve.

Për gratë, prania e armëve në shtëpi është e panevojshme, sepse ato cilësohen më parë si mjete të rrezikut, sesa të sigurisë personale. Përderisa, burrat kanë deklaruar se duke pasur parasysh gjendjen aktuale të sigurisë në Kosovë, mbajtja e armëve në shtëpi është e nevojshme.

Duke pasur parasysh faktin se gratë janë viktimat më të shpeshta të dhunës në familje, përdorimi i armëve të vogla dhe të lehta në këto raste rrezikon më shumë gratë.

Siguria e grave dhe burrave në burgjet e Kosovës

Gjendja e përgjithshme e burgjeve në Kosovë nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Burgjet janë të mbipopulluara. Mungesa e dhomave intime është problem në të gjitha burgjet dhe shtëpitë korrektuese të Kosovës.

Numri dhe kohëzgjatja e vizitave të të burgosurve gra dhe të mitur në Qendrën Korrektuese në Lypjan janë të pamjaftueshme.

Në kuadër të programeve edukativo-arsimore, në burgun e Dubravës dhe në Qendrën Korrektuese të Lypjanit funksionojnë shkollat ku ndjekin mësimet të burgosurit, përkatësisht gratë dhe të miturit. Në shkollën e Qendrës Korrektuese në Lypjan ka mungesë të kuadrin arsimor.

Arsimi dhe siguria

Qasja dhe mundësitë e barabarta të gjinive në arsimim, determinojnë në një masë të madhe nivelin e sigurisë si dhe zhvillimin socio – ekonomik të shoqërisë në përgjithësi.

Mungesa e regjistrimit civil në Kosovë ka bërë që të dhënat statistikore mbi

FAQE 012

analfabetizmin të mos jenë konsistente.

Në bazë të raporteve të ndryshme, analfabetizmi ndër gratë shqiptare në Kosovë kap shifrën 9 përqind dhe është tri herë më i lartë sesa tek burrat shqiptarë.

Nuk dihet numri i saktë i braktisjeve të shkollimit, si pasojë e mungesës së regjistrimit civil dhe migrameve të brendshme.

Braktisja e shkollimit është më e shprehur te vajzat sesa te djemtë, si rezultat i kushteve të vështira socio - ekonomike (favorizimi i djemve për të vazhduar shkollimin) dhe aspekteve të sigurisë (largësia e shkollave dhe mungesa e transportit).

Dukuria e dhunës në shkolla është mjaft prezente. Ajo manifestohet në formën fizike dhe verbale. Derisa dhuna fizike afekton më shumë djemtë, ndaj vajzave ushtrohet më shumë dhunë verbale.

Dhuna në shkolla adresohet nga institucionet vetëm atëherë kur ajo ushtrohet në mënyrë brutale, ndërsa forma tjera të dhunës, si ajo verbale, psikologjike, etj. nuk trajtohen si problem dhe nuk i kushtohet vëmendje e duhur.

Ekonomia dhe siguria

Njëri prej burimeve kryesore të pasigurisë ekonomike të grave është papunësia, e cila rezulton nga mungesa e qasjes së barabartë në resurset elementare.

Sipas vlerësimit të fuqisë punëtore, papunësia arrinë nivelin 44.9 përqind të fuqisë aktive të punës në vitin 2006. Numri i grave të papuna arrinë shifrën 47 përqind. Mundësitë e punësimit për gratë janë më të vogla. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, mundësia për punësim te gratë kapë shifrën 8.4 përqind, kurse për burra 35.1 përqind.

Punësimi sipas sektorëve, tregon se gratë janë të përqendruara në sektorin publik me 42.4 përqind, përderisa burrat kryesisht janë të angazhuar në sektorin privat me 54.3 përqind.

Në Kosovë, paga mesatare e grave është më e ulët se e burrave. Njëra prej arsyeve të kësaj pabarazie në paga është se gratë shumë rrallë janë të punësuar në pozita udhëheqëse.

Kriteret që përcaktohen në shumicën e konkurseve për vende të lira të punës, kërkesa për rikualifikim dhe ristrukturimi i vendeve të punës janë jofavorizuese për gratë e moshës së mesme.

Varshmëria ekonomike është dy herë më e lartë te gratë sesa te burrat. Kështu, 77 përqind e grave dhe 33 përqind e burrave jetojnë nga të ardhurat që sigurohen nga ndonjë person tjetër.

FAQE 013**Kujdesi shëndetësor dhe siguria**

Kosova prinë me vdekshmërinë perinatale të foshnjave me 23 fëmijë në 1 mijë lindje, që vlerësohet si shkalla më e lartë në Evropë.

Shifrat e vdekshmërisë maternale në Kosovë janë të përafërta me vendet e zhvilluara. Megjithatë, këto shifra, reflektojnë numrin e vdekjeve maternale të raportuara vetëm nga institucionet shëndetësore.

Numri i përgjithshëm i vdekjeve të foshnjave, gjatë këtyre katër viteve, të ndara në baza gjinore, tregon se foshnjat e gjinisë femërore prijnë me numër më të lartë të vdekjeve.

Ndërprerja e shtatzënisë (Aborti)

Shifrat e sakta të aborteve në Kosovë nuk dihen, pasi që një numër i konsiderueshëm i tyre kryhen në klinika private dhe të cilat nuk mbajnë evidencë për këtë gjë.

Ndër arsyet më të shpeshta të abortit janë: kushtet ekonomike, preferenca për për fëmijë të gjinisë mashkullore (zgjedhja e gjinisë me abort), aborti si metodë e planifikimit familjar, etj.

Kanceri i gjirit

Kanceri i gjirit është sëmundje, e cila në 90 përqind të rasteve shfaqet te gratë. Mungojnë të dhënat e sakta të numrit të grave, të cilat janë të sëmura nga kanceri i gjirit. Megjithatë, në rajon çdo e dhjeta apo e njëmbëdhjeta grua është e prekur nga kjo sëmundje.

Niveli i ulët i informimit, edukimi i pamjaftueshëm shëndetësor, mungesa e specialistëve adekuat të fushës, strategjive, politikave dhe institucioneve shëndetësore, si dhe mungesa e të dhënave statistikore ndikojnë që trajtimi dhe mbijetesja e grave të prekura me kancer të gjirit të jetë e kufizuar në Kosovë.

Mungesa e infrastrukturës shëndetësore si dhe mungesa e shërbimeve adekuate onkologjike (mungesa e Institutit Onkologjik) paraqet shqetësim të madh për sigurinë shëndetësore të grave.

FAQE 014

HIV/AIDS

Për pjesën më të madhe të shoqërisë kosovare, është i panjohur fakti se HIV/AIDS është sëmundje seksualisht e transmetueshme. Në këtë mënyrë, rreziku nga seksi i pasigurt afekton drejtëpërdrejtë më tepër gratë për faktin se zakonisht vendimmarrës për shumë çështje në familje janë burrat, duke mos përjashtuar as përdorimin e mjeteve kontraceptive.

Çështja më e ndërlikuar sa i përket kësaj sëmundjeje është testimi vullnetar i qytetarëve të Kosovës, që vazhdon të mbetet një proces sfidues për akterët kyç që merren me parandalimin e infektimit me HIV.

Epidemitë

Kosova është vendi më i goditur nga sëmundjet ngjitëse në shkallë të Evropës, sepse në çdo 100 mijë banorë, ekzistojnë diku rreth 5.500 - 6.000 persona të prekur nga sëmundje të tilla.

Sëmundjet ngjitëse zakonisht nuk janë karakteristike për moshën, përveç një grupi të sëmundjeve që janë sëmundje të fëmijëve, përderisa gratë janë më të prekura nga sëmundjet ngjitëse, gjatë periudhës së shtatzënisë dhe lehonisë. Ato janë më të prekura si rezultat i rënies së imunitetit.

Ushqimi

Duke pasur parasysh gjendjen e rëndë ekonomike në Kosovë, ku pjesa dërmuese e popullatës jeton në varfëri, qasja në ushqim, përveç që është e kufizuar, në të shumtën e rasteve është edhe e pasigurt.

Mungesa e ligjit mbi ushqimin dhe paqartësitë e kompetencave institucionale, vështirësojnë qasjen e sigurt në ushqim si dhe kontrollin i tij nga ana e institucioneve kompetente.

Uji

Në mungesë të ujit të pijshëm dhe sistemit të ujësjellësit, në shumë vende të Kosovës, banorët janë të detyruar të furnizohen nga pusët e tyre.

Gjysma e popullsisë kosovare pi ujë higjienik, të kontrolluar nga ujësjellësi, kurse pjesa tjetër e popullsisë pi ujë të pakontrolluar.

FAQE 015**Ajri**

Cilësia e ajrit është më problematike në zonat e zhvilluara urbane, veçanërisht Prishtina, për shkak të ndikimit nga termocentralet Kosova A, Kosova B dhe automjetet e shumta, pastaj Mitrovica si pasojë e mbetjeve industriale në kompleksin e Trepçës.

Në rajonin e Mitrovicës, prezenca e sasisë së lartë të plumbit (Pb) në gjak lë pasojë të rënda në organizmin e njeriut si: çrregullime në biosintezën e hemoglobinës dhe anemi, çrregullime në sistemin kardiovaskular, dëmtimin e sistemit nervor, dështimet dhe lindjet e parakohshme etj

Siguria e grupeve etnike në Kosovë

Kur flitet për sigurinë, në kontekstin e pakicave kombëtare që jetojnë në Kosovë, liria e lëvizjes është pa dyshim boshti i problemit. Pakica serbe konsiderohet me liri më të kufizuar të lëvizjes.

Problemet me të cilat ballafaqohen minoritete në Kosovë, kryesisht trajtohen në kontekstin e përgjithshëm politik, duke lënë anash perspektivën gjinore. Komuniteti RAE në Kosovë, veçanërisht gratë ballafaqohen me një numër të madh të vështirësive sociale, politike dhe ekonomike, siç janë liria e lëvizjes për shkak të pasigurisë së krijuar pasluftës, diskriminimi etnik, niveli i ulët i arsimit dhe mungesa e përfshirjes në vendimmarrje.

Shoqëria civile ka dhënë kontribut duke përkrahur dhe promovuar aktivitete të ndryshme që kanë për synim përfshirjen e këtyre komuniteteve në shoqëri, dhe përmirësimin e gjendjes së tyre.

Ministria e Arsimit, ka përcaktuar kuotën për regjistrimin e minoriteteve në Univeristetin e Prishtinës. Këto vende të rezervuara për minoritete, kanë mbetur të lira për një kohë të gjatë.

Analfabetizmi dhe braktisja e shkollimit janë dukuri shqetësuese për gratë dhe vajzat e komunitetit RAE.

Gratë e komunitetit RAE, ballafaqohen me vështirësi më të theksuar në qasje në shërbimet shëndetësore, si pasojë e kushteve socio-ekonomike, diskriminimit etnik, mungesës së informacionit, infrastrukturës shëndetësore, si dhe mungesës së politikave shtetërore për kujdes shëndetësor ndaj këtij komuniteti në përgjithësi.

FAQE 016

REKOMANDIMET

- Gjatë hartimit të politikave dhe strategjive nga ana e institucioneve që garantojnë sigurinë në Kosovë, të merren për bazë aspektet e sigurisë njerëzore dhe perspektiva gjinore.
- Të rritet bashkëpunimi ndërmjet OJQ-ve të grave dhe institucioneve qeveritare, posaçërisht institucioneve që garantojnë sigurinë, në adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë e grave.
- Të promovohet dhe implementohet Rezoluta 1325 nga institucionet qeveritare, joqeveritare dhe institucionet ndërkombëtare të pranishme në Kosovë.
- Të rritet pjesëmarrja e grave në proceset e krijimit, ndërtimit dhe ruajtjes së paqes dhe sigurisë në Kosovë.
- Të ngriten kapacitetet e mekanizmave institucional për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë.
- Të ketë përfaqësim më të madh dhe avancim të pozitës së grave në strukturat vendimmarrëse në institucionet e Kosovës, veçanërisht në institucionet e sigurisë.
- Të organizohen trajnime nga perspektiva gjinore për institucionet e sigurisë në Kosovë.
- Të implementohen dhe monitorohen ligjet dhe strategjitë e hartuara në Kosovë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave.
- Të përmirësohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve, mekanizmave institucional dhe organizatave joqeveritare, të cilat me merren drejtpërsëdrejti me dhunën në baza gjinore.
- Të zbatohet Rregullorja 2003/12 mbi dhunën në familje dhe veçanërisht të respektohen procedurat dhe afatet gjyqësore në trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga gjykatat.

FAQE 017

- Mediat të trajtojnë dukurinë e dhunës në familje në mënyrë profesionale.
- Strehimoret e viktimave të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore, të kenë mbështetje financiare të rregullt nga institucionet qeveritare.
- Të krijohen mekanizma institucional për risocializimin e viktimave të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore.
- Institucionet e Kosovës të kenë rol më aktiv në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Të përmirësohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore në adresimin e çështjes së trafikimit të qenieve njerëzore.
- Të nxitet bashkëpunimi rajonal në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Të organizohen fushata vetëdijësimi për dorëzimin vullnetar të armëve të vogla dhe të lehta.
- Të zbatohen dhe monitorohen ligjet ekzistuese për armëmbajtje.
- Kushtet brenda burgjeve dhe Qendrës Korrektuese në Lypjan të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Të ngritet cilësia e shërbimeve shëndetësore për gratë dhe të miturit brenda qendrës korrektuese në Lypjan.
- Të sigurohet kuadër arsimor i mjaftueshëm për gratë dhe të miturit në qendrën korrektuese në Lypjan.
- Të mundësohet monitorimi i përhershëm dhe i papenguar i burgjeve dhe i qendrës korrektuese nga institucionet që merren me të drejtat e njeriut.
- Të sigurohet qasje dhe mundësi e barabartë e gjinive në arsim.
- T'i kushtohet kujdes më i madh çështjes së analfabetizimit tek gratë dhe vajzat.
- Të krijohet një bazë e të dhënave për evidentimin e numrit të saktë të braktisjes së shkollimit.

FAQE 018

- Institucionet arsimore të adresojnë në mënyrë të veçantë çështjen e braktisjes së shkollimit nga vajzat.
- T'i kushtohet vëmendje institucionale prezencës së dhunës në shkolla qoftë asaj fizike, verbale apo psikologjike.
- Institucionet t'u mundësojnë grave qasje të barabartë në punësim dhe resurse, të garantuara me ligjin për barazi gjinore.
- Grave dhe vajzave t'u mundësohet qasje e barabartë në kualifikime, rikualifikime, kurse, aftësime profesionale dhe trajnime.
- Të sigurohen dhe ofrohen shërbime shëndetësore kualitative për gratë dhe fëmijët
- Të përmirësohet kujdesi për shëndetin reproduktiv te gruas.
- Të përshpejtohet aprovimi i ligjit të ri për ndërprerjen e shtatzënisë.
- Të krijohet një sistem i qëndrueshëm dhe i besueshëm i mbledhjes së të dhënave për numrin e saktë dhe shkaqet e abortit në institucionet publike dhe private
- Të sensibilizohen vendimmarrësit mbi sëmundjen e kancerit të gjirit dhe mungesën e kujdesit shëndetësor për gratë që janë të prekura nga kanceri i gjirit.
- Të krijohet infrastrukturë shëndetësore për trajtimin e kancerit të gjirit (funksionalizimi i Institutit Onkologjik).
- Të adresohet urgjentisht mungesa e të dhënave statistikore lidhur me numrin e rasteve me kancer të gjirit në Kosovë, nga institucionet përgjegjëse.
- Të organizohen fushata vetëdijësuese për HIV/AIDS-in dhe mënyrat e infektimit me virusin HIV, si dhe rëndësinë për testim vullnetar për HIV/AIDS.
- Të zbatohet ligji për ushqimin.
- Të sigurohet qasje në ushqim të sigurt si dhe kontroll të tij nga institucionet kompetente.

FAQE 019

- T'i kushtohet kujdes i veçantë qasjes në ushqim të mjaftueshëm dhe të sigurt grave shtatzëna dhe grave që ushqejnë foshnjat me gji.
- Institucionet përgjegjëse të Kosovës t'iu sigurojnë qytetarëve ujë të kontrolluar në tërë territorin e saj.
- Të hartohen dhe zbatohen politika në përputhje me standardet evropiane për mbrojtjen e ambientit.
- Të monitorohen dhe të bëhen publike rezultatet e ndotësve të ambientit.
- Të iniciohen projekte hulumtuese lidhur me ndikimin e plumbit në shëndetin e qytetarëve, veçanërisht të grave shtatzëna, në rajonin e Mitrovicës.
- Të implementohen dhe monitorohen ligjet dhe strategjitë ekzistuese, që kanë të bëjnë me përmirësimin e pozitës së komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë.
- Të përfshihet perspektiva gjinore kur trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë.
- Të organizohen fushata vetëdijesimi dhe informimi për kujdesin shëndetësor të grave dhe vajzave të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.
- Të përkrahen organizatat joqeveritare të grave nga komuniteti serb, RAE, boshnjak, turk etj në përpjekjet e tyre për adresimin e problemeve të grave dhe vajzave të këtyre komuniteteve.
- Të rritet përfshirja e grave RAE në të gjitha sferat e jetës.
- Ministria e Arsimit të adresoj problemin e analfabetizmit dhe braktisjes së shkollimit nga gratë dhe vajzat e komunitetit RAE, duke krijuar programe për ndarjen e bursave, për të gjitha nivelet e arsimit.
- Të rritet bashkëpunimi dhe koordinimi i OJQ-ve të grave RAE dhe institucioneve qeveritare në trajtimin e problemeve me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat e këtij komuniteti.

FAQE 020

KONCEPTET DHE PERCEPTIMET E BURRAVE DHE GRAVE MBI SIGURINË

“Në vazhden e konflikteve, definicioni i sigurisë po evoluon drejt një të kuptuarit tjetër më të gjerë”

Fillimisht, koncepti i sigurisë është perceptuar si sinonim i mbrojtjes së territorit nga kërcënimet e jashtme, mirëpo sot, gjithnjë e më shumë po shfaqet nevoja për një qasje të sigurisë e cila vë theksin në individin.

Përderisa, qasja e sigurisë tradicionale i referohet shtetit dhe politikat e saj janë të dizajnuara për të promovuar kërkesat që i atribuohen shtetit më shumë sesa individëve, siguria njerëzore ka një kuptim më të gjerë: “Me siguri njerëzore, nënkuptohet çdo gjë që u nevojitet burrave dhe grave në botë: ushqim i mjaftueshëm për familje, strehim i përshtatshëm, shëndet, arsimim, mbrojtje nga dëmet e shkaktuara nga njeriu ose natyra, si dhe një shtet, i cili nuk i shtyp qytetarët e tij, por që udhëheq me miratimin e tyre”.²

Dimension mjaft i rëndësishëm i sigurisë njerëzore është edhe perspektiva gjinore.

“Perspektiva gjinore e sigurisë njerëzore, përfshin të kuptuarit më të nuancuar se çfarë mund të ngërthejë perspektiva e burrave dhe grave mbi sigurinë”.³ Ajo vë në spikamë se si gratë për dallim nga burrat e adresojnë dhe e perceptojnë sigurinë dhe riskun në mënyra të ndryshme.

Prandaj, përfshirja e perspektivës gjinore në institucionet e sigurisë luan një rol të rëndësishëm në avancimin e mekanizmave të krijimit të sigurisë për të gjitha kategoritë.

“Përderisa theksi i sigurisë njerëzore mbi individin është i zëshëm, kërkohet të kuptuar më radikal mbi kompleksitetin e krizave të sotme dhe mënyrave në të cilat faktorët lokal dhe ndërkombëtarë po formësojnë riskun e veçantë, me të cilin po përballen komunitetet, e në veçanti gratë”.⁴

¹ United Nations Secretary – General Kofi Annan. Milenium Report, Chapter 3, p. 42 - 44
<http://www.un.org/millennium/sg/report/full.htm>, 08 /22/ 01

² Statement by the United Nations Deputy Secretary – General Louise Frechette to a high – level panel discussion on the occasion of the twentieth anniversary of the Vienna International Centre (VIC), October 9, 1999. http://www.un.org/News/Press/docs/1999/19991012_dsgsm70.doc.html, Marrë nga interneti më 08.02.01

³ http://popdev.hampshire.edu/projects/dt/pdfs/DifferenTakes_14.pdf “Human Security: A gender Perspective”, by Angela Raven Roberts. Marrë nga interneti më 06.04.2007

⁴ Po aty

FAQE 021

Elementi kyç i agjendës së sigurisë njerëzore shtrihet në nocionin e domosdoshëm të promovimit dhe mbrojtjes së sigurisë njerëzore. Konferenca botërore mbi të Drejtat e Njeriut e vitit 1993, në Vjenë, si dhe Deklarata e OKB-së mbi "Eliminimin e dhunës kundër Grave", miratuan veçantinë e diskriminimit kundër grave dhe dhunën në baza gjinore si dhe vërtetuan principet se mbrojtja kundër këtyre shkeljeve (dhunimeve), ishte shumë me rëndësi për çështjet e të drejtave të njeriut. Kjo qasje e të Drejtave të Njeriut, gjithashtu vë në pah aspekte të tjera që ndikojnë në sigurinë njerëzore si p.sh: martesat e detyruara, trafikimi me qeniet njerëzore dhe prostitucioni i detyrueshëm. Këto nuk janë vetëm kërcënim për individin dhe integritetin e tij, identitetin dhe sigurinë, por gjithashtu janë shkelje të të drejtave të njeriut.

Gratë dhe burrat kanë perceptime të ndryshme mbi sigurinë e tyre. Kjo vije si rezultat i pozitës, nevojave dhe roleve të ndryshme që ata kanë në shoqëri.

Në fokus grupet e organizuara me gratë dhe burrat nga Qendra Kosovare Për Studime Gjinore, gratë i kanë trajtuar çështjet më shumë nga aspekti i sigurisë njerëzore, përderisa burrat nga aspekti i sigurisë tradicionale.

Sa i përket sigurisë së grave apo burrave, që të dy gjinitë kanë përshtypjen se gratë i janë ekspozuar më shumë pasigurisë. Sipas burrave kjo ndodh shkak i natyrës së gruas, e cila sipas një qasjeje tradicionale trajtohet si "e dobët" dhe me mundësi minimale të mbrojtjes. Në këtë kontekst, burrat mendojnë se gratë për shkak të pafuqisë së tyre fizike janë më të rrezikuara. Një bindje të përafërt gratë e kanë edhe për vetveten. Për më tepër ato pohojnë se janë të rrezikuara në çdo aspekt të jetës së tyre.

Burrat mund të vetëmbrohen, ndërsa gratë jo...

Grua, e punësuar në sektorin privat (27 vjeçare)

Siguria e burrave dhe grave dallon shumë, sepse gjinia femërore është më e dobët, më e ndjeshme...

Burrë, i punësuar në sektorin publik (46 vjeçar)

Më konkretisht, burrat që kanë marrë pjesë në fokus grup mendojnë së gratë janë më të rrezikuara nga trafikimi, sulmet dhe plaçkitjet në rrugë. Për dallim prej tyre, gratë kanë bindjen se atyre u kanoset rreziku në çdo sferë të jetës⁵.

⁵ Perceptimet e grave dhe burrave mbi çështjet e sigurisë janë të elaborura më gjërsisht në kapitujtë e tjerë.

FAQE 022

Mendimet e disa akterëve⁶ mbi çështjen e definimit të sigurisë, nga perspektiva gjinore

Ne mësojmë se siguria është mbrojtja me armë dhe tankse. Militarizimi është perspektivë maskuliniste dhe gratë nuk ndihen të sigurta në këtë kontekst⁷

Perceptimet e të intervistuarve mbi çështjet e sigurisë reflektojnë në një masë të madhe nga pozita në të cilën janë të involvuar. Sipas Naim Malokut, kryetar i komisionit parlamentar për siguri, nuk ka dallim nga aspekti gjinor sa i përket sigurisë së përgjithshme.

Nuk ka ndonjë theks të veçantë për nivelin e pasigurisë së grave në Kosovë, nuk ka parametra apo elemente që japin indikacione që gruaja është e rrezikuar në rrugë ditën apo natën⁸

Për gjeneral major, Behar Selimin, asistent komisar për administratë në Shërbimin Policor të Kosovës, termi siguri nënkupton të qenit i lirë nga çfarëdo shtrengimi, fizik, emocional apo psikologjik në kuptimin e gjerë të fjalës, apo nga ndonjë faktor i jashtëm⁹

Kurse Ramadan Ahmeti, shef i sektorit antitrafikim në SHPK, mendon se nuk ekziston dallim gjinor kur flitet për sigurinë. “Nuk mendoj se gratë apo burrat duhet të mbrohen ndryshe, mirëpo, kam bindjen që gratë janë më të rrezikuara në situata të caktuara p.sh. ato kanë frikë të dalin vetë natën¹⁰

Hysni Shala, këshilltar për barazi gjinore në SHPK, dallimet mbi perceptimet e sigurisë për burrat dhe gratë, i përshkruan në bazë të rasteve që ndodhin në Kosovë. “Nëse ndalemi të ndarja gjinore e viktimave, çështja e trafikimit, dhuna në familje, ngacmimi seksual – dhunimi, lënë të kuptojnë që siguria nuk është e njëjtë për të dy gjinitë¹¹. Ndërkaq Fahri Sadriu, koordinatori për

⁶ Akterët e intervistuar janë përfaqësues të institucioneve që merren me çështjet e sigurisë. Për më tepër shih shtojcën “Lista e personave të intervistuar”.

⁷ Intervistë me Clare Hutchinson, Zyra për Çështje Gjinore, UNMIK. 19.06.2007. Prishtinë

⁸ Intervistë me Naim Malokun, kryetar i komisionit parlamentar për siguri. 16.05.2007. Prishtinë

⁹ Intervistë me gjeneral Behar Selimi, asistent komisar për administratë në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK). 17.05.2007. Prishtinë

¹⁰ Intervistë me Ramadan Ahmetin. 28.06.2007

¹¹ Intervistë me Hysni Shalën, këshilltarë për barazi gjinore në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK) 24.05.2007. Prishtinë

FAQE 023

barazi gjinore në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, mendon se kërcënimi i sigurisë është më shumë i shprehur tek gratë sesa tek burrat, me theks të veçantë në fushën e shëndetësisë. “Gratë për shkak të natyrës së tyre, kanë nevojë më të shpeshta për mbikëqyrjen institucionale, mjekësore”¹². Ai nuk lë pa përmendur edhe rrezikun që i kanoset lirisë së lëvizjes së grave/vajzave në orët e vona të natës.

Sipas Cyme Mahmutajt, zyrtare për të drejta të njeriut, mundësi të barabarta, çështje gjinore, antidiskriminim në zyrën e kryeministrit, siguria përfshinë aspektet e ndryshme të jetës së grave dhe burrave duke filluar nga arsimimi, shëndetësia, siguria në punë, ambienti etj. “Dallimi i sigurisë për burrat dhe gratë është historikisht shumë i madh duke iu referuar aspektit politik, ekonomik dhe atij shoqëror”¹³.

Nëse i referohemi sigurisë, besoj se është e njëjtë si për burrat ashtu edhe për gratë

*Ismail Musa*¹⁴

Sipas Visare Gorani-Gashi, shefe e Agjencionit për barazi gjinore, në zyrën e kryeministrit, “kur flitet për sigurinë në përgjithësi, atëherë automatikisht një pjesë e madhe e njerëzve e mendojnë atë nga aspekti policor, ushtarak dhe ai i kufijve të jashtëm”¹⁵. Duhet bërë dallim ndërmjet sigurisë njerëzore dhe asaj tradicionale, pasi që siguria njerëzore ka të bëjë drejtpërsëdrejti me jetën e përditshme, qasjen në shërbime, në burime, mundësinë e të qenit i/e sigurt në vendin ku jeton, sqaron Gorani-Gashi. Sipas saj problemi kryesor që rëndon sigurinë njerëzore të grave për dallim nga burrat është qasja e kufizuar në burime financiare.

Ndërkaq Lulzim Peci, drejtor ekzekutiv në KIPRED, çështjet e sigurisë nga perspektiva gjinore i shpjegon në tri aspekte. “Niveli i shkollimit është shumë më i ulët tek gratë sesa tek burrat dhe kjo paraqet një rrezik për sigurinë e tyre jetësore në kuptimin që nuk mund të kyçen në tregun e punës, gjë e cila i kategorizon gratë në rendin e dytë shoqëror. Problemi i dytë sipas Pecit qëndron në përgjithësi në pabarazinë gjinore që është e shprehur në shoqërinë tonë, e cila rezulton në një rrezik tjetër për gruan, sepse nuk i mundëson të

¹² Intervistë me Fahri Sadriu, koordinator për barazi gjinore në TMK. 28.05.2007. Prishtinë

¹³ Intervistë me Cyme Mahmutaj, zyrtare për të drejta të njeriut, mundësi të barabarta, çështje gjinore, antidiskriminim në zyrën e kryeministrit. 20.08.2007. Prishtinë

¹⁴ Intervistë me Ismail Musa, zyrtar në zyrën për të drejta të njeriut, çështje gjinore, mundësi të barabarta dhe standarde në Ministrinë e Punëve të Brendshme. 06.06. 2007. Prishtinë

¹⁵ Intervistë me Visare Gorani-Gashi.

FAQE 024

njëjtin progres me gjininë tjetër. Ndërkaq, aspekti i tretë dhe i fundit është, gruaja si objekt i dhunës familjare dhe dhunës seksuale¹⁶.

"Mendoj që në një shtet stabil, në një shtet ku mbizotëron ligji nuk duhet të ketë aspak privilegje apo dallime në aspektin e garantimit të sigurisë. Policia, ushtria dhe format e tjera të brendshme të një shteti janë garantues të sigurisë për qytetarin, e qytetari është grua-burrë pa dallim"¹⁷, thekson Ferdinand Nikolla, drejtor ekzekutiv në FIQ.

Sipas Hilmi Jasharit, ushtrues detyre i Ombudspersonit, gratë janë më të rrezikuara në aspektin e sigurisë. "Është evidente që disa grupe të caktuara të shoqërisë kosovare janë më të cenueshme sesa të tjerat. Këtu bëjnë pjesë: gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, dhe të burgosurit"¹⁸, shprehet Jashari. Pozitën e tillë të grave në aspektin e sigurisë, Jashari e sheh të lidhur ngushtë me traditën dhe kulturën e krijuar për një kohë të gjatë në Kosovë.

Në këtë kontekst, Flora Macula nga UNIFEM-i ka bindjen se ekziston dallimi gjinor sa i përket sigurisë. "Ky dallim ekziston, sepse dallojnë obligimet, përgjegjësitë e gjinive"¹⁹, thotë Macula.

Akterët e intervistuar shfaqin dy këndvështrime mbi çështjet e sigurisë. Njëri grup mendon se siguria është e njëjtë si për burrat ashtu edhe për gratë, mendim ky i cili i ofrohet më shumë qasjes tradicionale të sigurisë, ku shteti me mekanizmat e tij, ka për obligim që t'i ofrojë siguri të gjithë qytetarëve në mënyrë të njëjtë. Ndërkaq, grupi tjetër, sigurinë e lidhin me çështje të tjera, të cilat si të tilla i ofrohen më shumë qasjes së sigurisë njerëzore, brenda së cilës gjinitë kanë nevojë të veçanta, në situata të caktuara.

Rezoluta 1325, "Gratë, Paqja dhe Siguria"

Më 31 tetor të vitit 2000, shtetet anëtare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara kanë votuar unanimisht Rezolutën 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria", e cila kërkon nga shtetet anëtare që përmes obligimeve të ndryshme të saktësuara, të merren me ndikimin e luftës të gratë dhe kontributin e grave për zgjidhjen e konfliktit dhe paqen e qëndrueshme.

Nëpërmjet kësaj rezolute, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, adreson për herë të

¹⁶ Intervistë me Lulzim Pecin, drejtor ekzekutiv në KIPRED. 16.05.2007. Prishtinë

¹⁷ Intervistë me Ferdinand Nikolla, drejtor ekzekutiv në FIQ. 17.05.2007, Prishtinë

¹⁸ Intervistë me Hilmi Jasharin, u.d i Ombudspersonit të Kosovës, 25.05.2007. Prishtinë

¹⁹ Intervistë me Flora Maculën, këshilltare për qeverisje dhe paqe për Evropën Juglindore, UNIFEM, zyra në Kosovë 19.09. 2007. Prishtinë

FAQE 025

parë ndikimin e veçantë të konfliktit të armatosur tek gratë, si dhe kontributin që japin gratë në parandalimin e konfliktit, paqeruajtjen, zgjidhjen e konfliktit dhe ndërtimin e paqes, e që shpeshherë është i pashfrytëzuar dhe i nënvlerësuar. Në këtë Rezolutë, gjithashtu theksohet rëndësia e pjesëmarrjes së barabartë dhe të plotë të grave, si subjekt aktiv në paqe dhe siguri: "Rezoluta 1325 nënvizon përgjegjësinë për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga abuzimi i të drejtave të njeriut, përfshirë dhunën në baza gjinore. Ajo i sistemon gratë në mënyrë të barabartë dhe vendosmërisht në qendër të të gjitha negociatave për paqen dhe sigurinë: parandalimin e konfliktit, paqeruajtjen, paqendërtimin dhe rindërtimin pas konfliktit"²⁰. Kjo rezolutë është e mbështetur në katër fusha kryesore:

- Pjesëmarrja e grave në proceset e vendimmarrjes dhe të paqes
- Përfshirja e perspektivës gjinore në të gjitha trajnimet e stafit të policisë dhe ushtrisë
- Përfshirja e perspektivës gjinore në raportet e OKB-së dhe
- Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të grave dhe vajzave

²⁰ <http://www.aic.gov.au/conferences/policewomen3/bearlin.html>. Marrë nga interneti më 20.04.2007

FAQE 026

Njohuria mbi Rezolutën 1325 nga përfaqësues të mekaniz- mave implementues

Të gjithë akterët, si ata të nivelit qeveritar dhe joqeveritar, institucionet mbrojtëse, agjencitë humanitare, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare janë të obliguar të kontribuojnë në implementimin e Rezolutës 1325. Në nenin 17 të saj thuhet se Sekretari i Përgjithshëm duhet t'i raportojë Këshillit të Sigurimit lidhur me *"progresin e përfshirjes së perspektivës gjinore në të gjitha misionet paqeruajtëse dhe në të gjitha aspektet tjera që kanë të bëjnë me gratë dhe vajzat"*.

"Mekanizmat institucional për arritjen e barazisë gjinore, kanë rëndësi të jashtëzakonshme për institucionalizimin e çështjeve gjinore në shoqërinë kosovare. Përmes tyre, synohet që në perspektivë afatgjate çështjet gjinore të bëhen pjesë e rëndësishme përbërëse e strategjive dhe politikave të institucioneve kosovare"²²

Plani Kombëtar i Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore në Kosovë²³

Ideja për krijimin e këtij Plani ka qenë prezente në qarqet e shoqërisë civile në Kosovë që në vitet e para të pasluftës. Përpilimi i tij, me përkrahje të UNIFEM, ka filluar në qershor të vitit 2002 dhe ka përfunduar në prill të vitit 2003, ndërsa është aprovuar nga Qeveria e Kosovës, respektivisht nga ish-kryeministri Bajram Rexhepi, me 14 prill të vitit 2004.

Aprovimi i këtij plani mundësoi krijimin e Ligjit për Barazi Gjinore, i cili u miratua nga ana e Kuvendit të Kosovës në vitin 2004. Ky ligj krijoi hapësirë për krijimin e mekanizmave institucionalë për arritjen e barazisë gjinore në nivelin qendror dhe atë lokal..

- a) Mekanizmat Institucional për Barazi Gjinore në nivelin qendror:
- Agjensioni për Barazi Gjinore / Zyra e Kryeministrit
 - Zyra Këshillëdhëse për Qeverisje të Mirë – Divizioni për Çështje Gjinore Zyra e Kryeministrit
 - Institucioni i Ombudspersonit - Njësia për Barazi Gjinore
 - Zyrtaret/ët për Barazi Gjinore në Ministri
 - Këshilli Ndërmintor për Barazi Gjinore

²² Po aty

²³ Po aty

FAQE 027

- b) Mekanizmat Institucional për Barazi Gjinore në nivelin lokal:
- Zyrtarët/et për Barazi Gjinore në Komuna
 - Komitetet Komunale për Barazi Gjinore

Nga të intervistuarit lidhur me implementimin dhe njohuritë mbi Rezolutën 1325, kemi marrë informacione nga më të ndryshmet.

Visare Gorani Gashi, shefe e ABGJ-së, ka bindjen se Rezoluta 1325 implementohet në Kosovë.

Gratë kosovare nga shoqëria civile luajtën një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e vendimmarrësve për Rezolutën 1325. Kjo u bë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si p.sh: takimet me vendimmarrësit, organizmi i debateve në media, organizimi i trajnimeve dhe protestave, projekteve, rrjetëzimeve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare, përmes së cilave lobuan në promovimin e implementimit të kësaj Rezolutive. "Si shembull i fundit i për-pjekjeve të organizatave joqeveritare të grave për implementimin e Rezolutës 1325 është edhe avokimi për pjesëmarrjen e grave në procesin e definimit të statusit final të Kosovës, më saktësisht avokimi për pjesëmarrjen në Grupin Negociator të Kosovës"²⁴, tregon Luljeta Vuniqi. Ajo më tej shton se UNIFEM, zyra në Kosovë, ka përkrahur shumicën e aktiviteteve që kanë të bëjnë me zbatimin e Rezolutës 1325, ndër to formimin e Lobit të Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore; Iniciativën e Rrjetit të Grave në të Zeza në Serbi dhe Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës për krijimin e Koalicionit për Paqe të Grave.

Gjithashtu, UNIFEM ka përkrahur edhe krijimin e bordeve për barazi gjinore në kuadër të Shërbimit Policor të Kosovës dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Anëtarët e Lobit të Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore, duke përfshirë edhe disa aktiviste të njohura nga Serbia – u takuan me Ahtisarin si dhe me anëtarët e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, lidhur me Rezolutën 1325 dhe statusin e ardhshëm të Kosovës. Si rezultat i këtyre takimeve, drafti i Rezolutës së Këshillit të Sigurimit mbi Kosovën²⁵ i cili ishte i bazuar në pakon e propozuar të Ahtisarit dhe i përkrahur nga Sekretari i Përgjithshëm i KB Ban Ki-moon, përfshinte kërkesën e drejtpërdrejtë për implementimin e Rezolutës 1325

²⁴ Intervistë me Luljeta Vuniqi, Drejtore Ekzekutive në Qendrën Kosovare për Studime Gjinore. 30.10.2007, Prishtinë

²⁵ Deri më tani, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara nuk ka miratuar ndonjë Rezolutë për Statusin Final të Kosovës.

FAQE 028

Çështja e implementimit të Rezolutës hapë antagonizma të theksuar. Derisa një grup i të intervistuarve mendojnë se Rezoluta implementohet, pjesa tjetër është shumë skeptike.

"Rezoluta 1325 nuk implementohet, njerëzit që punojnë në Qeveri as që dinë që ajo ekziston, ngaqë kjo rezolutë nuk është pjesë e politikave të Kosovës"²⁶, thekson Lulzim Peci.

Ngjashëm shprehet edhe Behar Selimi. Sipas tij kjo Rezolutë nuk njihet nga shumë institucione. Madje, Selimi ka shfaqur shqetësimin për moszbatimin e saj në praktikë nga ana e ndërkombëtarëve. "Rezoluta si e tillë nuk ka një sendërtim konkret në mekanizmat ndërkombëtarë në Kosovë. Po ta shohim shtyllën e parë të UNMIK-ut, shtylla për polici dhe drejtësi, me kompetencë e them se nuk ka të arritura konkrete të zbatimit të Rezolutës 1325 në krye të ekzekutivit. Po të kishim pritur motivim nga ta do të ishim prapa", ka theksuar Behar Selimi²⁷.

"Rezoluta 1325 akoma vazhdon të mos njihet nga shumë agjenci, të cilat janë të parat që do të duhej ta zbatojnë"

Behar Selimi

Po ashtu, për moszbatimin e kësaj Rezolute, Selimi e akuzon edhe Qeverinë e Kosovës. "Është faji i qeverisë, sepse rezoluta obligon shtetet anëtare të OKB-së që të shtohet pjesëmarrja e gruas, sidomos në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, si dhe ndërtimin e paqes"²⁸. Megjithatë, sipas Selimit, institucioni ku punon ai, ka arritur të zbatojë Rezolutën në pjesën e përfshirjes së grave në organet vendimmarrëse. "Falë përpjekjeve të UNIFEM-it dhe Rrjetit të Grave të Kosovës, çështjet gjinore janë trajtuar edhe në SHPK"²⁹.

Naim Maloku, shef i Komisionit Parlamentar për Siguri, ka pohuar të ketë dëgjuar shkarazi për këtë Rezolutë: "Ndoshta 20 herë e kam lexuar, por nuk po më kujtohet, na janë bërë shumë rezoluta"³⁰. Për dallim prej Malokut, kolegja e tij nga i njëjti Komision, Samije Zeqiraj pohon të ketë njohuri për Rezolutën 1325. "Kjo rezolutë është për të drejtat e grave dhe vajzave"³¹, sqaron ajo.

²⁶ Intervistë me Lulzim Peci

²⁷ "Siguria e Kujt", dokumentar. Intervista e dhënë nga Behar Selimi.

²⁸ Intervistë me Behar Selimin

²⁹ Intervistë me Behar Selimin

³⁰ Intervistë me Naim Malokun, kryetar i Komisionit Parlamentar për Siguri. 16.05.2007. Prishtinë

³¹ Intervistë me Samije Zeqiraj, anëtare e Komisionit Parlamentar për Siguri. 17.05.2007. Prishtinë

FAQE 029

Edhe të intervistuarit nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës, kanë bindjen se e implementojnë Rezolutën për çështjen e barazisë gjinore. "Ne mendojmë që në TMK implementohet rezoluta 1325, ndoshta jo plotësisht, krahasuar me kushtet të cilat i kemi, ngaqë ne jemi pjesë e rezervuar e PSSP-së dhe mbikëqyrjen e TMK-së e ka KFOR-i"³², thotë Fahri Sadriu, koordinator për Barazi Gjinore në TMK.

Përkundër përpjekjeve për implementimin e Rezolutës dhe adresimit të çështjeve gjinore nga Institucionet vendëse dhe ndërkombëtare, shoqëria civile, apo organizatat e grave, mbetet ende për t'u bërë në këtë drejtim.

Gratë dhe roli i tyre në ndërtimin e paqes në Kosovë

"Gratë që kuptojnë aq mirë koston e konfliktit, janë po ashtu më mirë të pajisura për të parandaluar ose zgjidhur konfliktin"

Kofi Annan

Përvojat e ndryshme të grave gjatë konfliktit, nevojat dhe rreziqet e veçanta që u kanosen atyre, japin arsye të mjaftueshme që ato të përfshihen në ndërtimin e paqes. "Pjesëmarrja e grave në proceset e vendimmarrjes dhe të paqes" është ndër çështjet kryesore që trajton Rezoluta 1325.

Gratë aktiviste e konsiderojnë Rezolutën si garanci për pjesëmarrjen e grave në bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës, megjithatë, ekipi negociator³³ përbëhet krejtësisht nga burrat.

Për dallim nga Konferenca e Rambujesë³⁴ (1999), ku në delegacionin kosovar merrte pjesë një grua, në negociatat për përcaktimin e statusit të Kosovës nuk ka marrë pjesë asnjë grua.

Përkundër faktit se OJQ-të aktive të grave kosovare me sukses kanë parashtruar një varg çështjesh të rëndësishme gjatë tetë viteve të fundit, në përgjithësi ato nuk përfillen nga institucionet qeveritare, ndaj ndikimi i tyre në sektorin e sigurisë mbetet i ulët.

Kjo nxitë nevojën për rikonceptualizimin nga perspektiva gjinore e kuptimit

³² Intervistë me Fahri Sadriun, koordinator për barazi gjinore në TMK. 28.05.2007. Prishtinë

³³ Grupi Negociator pesë anëtarësh, i ashtuquajtur i Unitetit, u themelua në vitin 2005, i cili do të vendosë rreth qëndrimeve të Kosovës ndaj zgjidhjes përfundimtare të prezantuar nga Ahtisari.

³⁴ Më datën 6 shkurt të vitit 1999, u mblodhën për fillimin e negociatave përfaqësuesit nga Federata Jugosllave dhe qeveria e Serbe si dhe përfaqësuesit nga Kosova, me bashkëkryesim nga Herbert Vedrine dhe Rubin Cook, si dhe me përfshirjen e drejtpërdrejtë të Grupit të Kontaktit. Më 18 mars, marrëveshja nënshkruhet nga pala shqiptare dhe refuzohet nga pala serbe.

FAQE 030

tradicional të paqes dhe sigurisë, në mënyrë që të sigurohet përfshirja e grave në të gjitha proceset e ndërtimit dhe ruajtjes së paqes.

“Në praktikë, angazhimi i drejtpërdrejtë i grave në procesin vendimmarrës, në zgjidhjen e konflikteve dhe në veprimtaritë në mbështetje të paqes kërkon ndryshimin e vizionit tradicional në lidhje me rolet përkatëse të burrave dhe të grave në shoqëri dhe në situatat konfliktuozë”³⁵.

Struktura Gjimore dhe pozitat vendimmarrëse në Institucionet e Kosovës

Përfaqësimi gjinor në strukturat udhëheqëse në Kosovë është jo proporcional. Bazuar në statistikat e Ministrisë së Shërbimeve Publike – Departamentit të Administratës së Shërbyesve Civil, raporti i përfaqësimit gjinor në poste udhëheqëse është përafërsisht 1 me 10 në favor të burrave. Më konkretisht, këto statistika tregojnë se përqindja e gjithmbarshme e grave të punësuar në institucionet qendrore dhe lokale është 35.64 përqind, ndërkaq nga 893 poste udhëheqëse, në nivel lokal, vetëm 90 poste udhëhiqen nga gratë.

Përbërja aktuale e Kuvendit të Kosovës, i cili numëron 120 vende “ka rezervuar” 27.5 përqind të vendeve për gratë. Gratë gjithashtu mbajnë 28 përqind të të gjitha ulëseve të Kuvendeve Komunale. Në Qeverinë e Kosovës, postin e ministres e ka vetëm 1 grua. Ndërsa, 2 nga 5 shefat e grupeve parlamentare janë gra.

Struktura gjimore në postet udhëheqëse në komuna, sipas këtyre të dhënave është: 1 kryeshefe ekzekutive, 28 gra drejtorë drejtorie prej 280 të punësuarve dhe 3 gra zv. drejtorë drejtorie nga 24 të punësuar.

Edhe pse Kosova ka bërë hapa të dukshëm në avancimin e pozitës së grave në IPVQ ende mbetet shumë për t’u bërë që të arrihet nivel i përfaqësimit gjinor, siç është paraparë me Ligjin për Barazi Gjinore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. (Neni 3 pika 3.1 thotë: “Me zbatimin e masave ligjore dhe afirmative vendoset pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në organet e të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucioneve publike, në mënyrë që pjesëmarrja në këto institucione të arrij nivelin e pjesëmarrjes së tyre të popullata të përgjithshme të Kosovës”. Ndërsa neni 3 pika 3.2 i LBGj thotë: “Pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave sipas nenit 3 pika 3.1 arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione,

³⁵ IPU e DCAF

FAQE 031

organe apo në nivele të pushtetit është 40 përqind”.

Qeveria e Kosovës ka hartuar dhe aprovuar Strategjinë për periudhën 2006-2015 për Ngritjen e Numrit dhe të Pozitës së Grave në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes. Qëllimi i kësaj strategjie është që të shërbejë si udhëzim dhe mekanizëm për avancimin profesional të grave me qëllim të shtimit të pjesëmarrjes së tyre në poste udhëheqëse.

Strategjia është përpiluar në pajtim me Ligjin për Barazinë Gjinore si dhe Planin e Veprimit për Partneritet Evropian.

Strategjia për Ngritjen e Numrit dhe të Pozitës së Grave në IPVQ përcakton aktivitetet që duhet të ndërmerren IPVQ-të për realizimin e këtij qëllimi, si dhe planin e veprimit që përcakton detyrat konkrete për bartësit e përgjegjësive. Strategjia për ngritjen e numrit dhe të pozitës së grave në IPVQ shërben si masë afirmative për të siguruar përfaqësim më të lartë të grave në strukturat udhëheqëse.

Struktura Gjinore dhe pozitat vendimmarrëse në Institucionet e Sigurisë në Kosovë

Komisioni Parlamentar Për Siguri

Një organ i rëndësishëm i çështjes së sigurisë është Komisioni Parlamentar për Siguri. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të këtij Komisioni është 14, prej tyre 4 gra dhe 10 burra.

“Nuk besoj se marrja e një pozite nga gruaja në institucionet e sigurisë, kishte me rritë sigurinë për gratë.”

Naim Maloku

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë

Ministria e Punëve të Brendshme u themelua me rregulloren e UNMIK-ut 2005/53 në dhjetor të vitit 2005. Ministrisë iu transferuan kompetencat e zbatimit të menaxhimit të integruar të kufijve, për bashkërendimin ndërmjet policisë dhe autoriteteve të tjera publike që punojnë në kontrollimin e vendkalimeve kufitare.

Në këtë ministri struktura gjinore e të punësuarve është e dominuar nga burrat, prej 725 të punësuarve, 436 janë burra dhe 289 janë gra. Prej tyre në pozitat udhëheqëse janë 8 gra.

Ministria e Drejtësisë u themelua në vitin 2006. Numri i përgjithshëm i të

FAQE 032

punësuarve në këtë ministri është 246. Prej tyre 73.90 përqind janë burra dhe vetëm 26.10 përqind gra.

Shërbimi Policor i Kosovës

Qëllimi strategjik i Shërbimit Policor të Kosovës është themelimi, zhvillimi dhe caktimi i një force efektive policore vendëse, profesionalisht të trajnuar, plotësisht të pajisur, të qëndrueshme me kuadro përkatëse për funksionim efektiv dhe e aftë për mbrojtjen e sigurisë dhe të qetësisë në Kosovë, duke iu përmbytur parimeve të policisë demokratike³⁶

Sipas ekspertëve të OSBE-së përqindja e përfshirjes së grave në këtë institucion është mjaft e lartë krahasuar me shumë vende të Evropës.

Përfaqësimi i grave në strukturat e Shërbimit Policor të Kosovës është rreth 14 përqind. Krahasuar me përqindjet tjera të përfaqësimit të grave në institucione të sigurisë në Kosovë, mund të thuhet se kjo përqindje është relativisht e mirë.

Konsiderohet një politikë efektive, por nuk do të thotë se është zbatuar ligji për barazi gjinore në Kosovë, i cili për ne është kryesori, është diçka që synohet, por që kërkon infrastrukturë

Behar Selimi

Bazuar në raportin RSSB, kufizimet sociale dhe kulturore, si dhe mungesa e rekruteve të mjaftueshme lënë të kuptojnë se policia nuk do të ketë numër përfaqësues të grave në të ardhmen e afërt. Andaj, ka nevojë që të bëhet më shumë në inkurajimin e kandidatëve gra³⁷

Grafikoni në vijim pasqyron raportin gjinor në strukturat brenda Shërbimit Policor të Kosovës. Në përgjithësi mund të vërehet se gratë janë të përfaqësuar pothuajse në të gjitha strukturat brenda SHPK-së në proporcion me numrin e përgjithshëm (14 përqind) të përfaqësimit të grave në këtë institucion.

Shërbimi kufitar është një organ brenda SHPK-së që kontribuon në kontrollin e kufijve. "Tani, për shkak të situatës unike të Kosovës, policia kufitare është e obliguar të punoj në 13 vendkalime/kufitare – administrative. Mbikëqyrja dhe patrullimi i kufijve është përgjegjësi e KFOR-it, edhe pse janë bërë disa patrullime të përbashkëta me policinë kufitare"³⁸.


³⁶ www.kosovopolice.com, marrë nga interneti; 30.11.2007. Prishtinë

³⁷ UNDP "Rishikimi i Sektorit Për Siguri të Brendshme në Kosovë", Kosovë 2006


³⁸ UNDP "Rishikimi i Sektorit Për Siguri të Brendshme në Kosovë", Kosovë 2006

FAQE 033

Grafikoni 1: Struktura Gjinore e Shërbimit Policor të Kosovës
Burimi: SHPK, 2007



Grafikoni 2: Gradat dhe struktura gjinore e Shërbimit Policor të Kosovës
Burimi: SHPK, 2007




FAQE 034

Struktura gjinore e shërbimit kufitar përbëhet nga 832 burra dhe vetëm 66 gra. Ky shërbim luan një rol të rëndësishëm, ndër të tjera edhe në parandalimin e dukurive si trafikimi me qenie njerëzore.

Trupat Mbrojtëse të Kosovës

Formimi i TMK-së mbështet në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/8, e cila thotë se TMK-ja është "Një agjenci e shërbimit emergjent civil, detyrat e së cilës janë: sigurimi i përgjigjes adekuate në raste të fatkeqësive, të ndërmarre veprime kërkimi dhe shpëtimi, të sigurojë kapacitete për ndihmë humanitare në zonat e izoluara, të ndihmojë në dominim, t'i kontribuojë rindërtimit të infrastrukturës dhe bashkësive"³⁹.

Grafikoni 3: Struktura gjinore e TMK-së
Burimi: Trupat Mbrojtëse të Kosovës



Siç shihet edhe nga grafikoni, stafi aktiv punonjës i TMK-së përbëhet nga një numër shumë i vogël i grave. Prej tyre numri më i madh janë në pozitën e tetares (22), rreshtere (16), kaptere (19), togere (10), kapitene (12), majore (3), nënkolonele (1) dhe kolonele (1).

Pjesëmarrja e barabartë e grave si rekrute ose në përbërje të njëjësive ushtarake profesioniste mund të nxitet nga udhëheqësia politike ose mund të

³⁹ Forcimi i Mbikëqyrjes Civile dhe i Manxhimit të sektorit të Sigurisë në Kosovë". KIPRED. Prishtinë, nëntor 2005

FAQE 035

vijë si rezultat i zhvillimeve brenda vet fushës së sigurisë. Fahri Sadriu⁴⁰, tregon se TMK-ja qëndron relativisht mirë me përfaqësimin e gruas në strukturat e saj, por natyrisht që ka vend për përmirësime. Ai ka deklaruar se në krahasim me vitet paraqake, kjo gjendje është duke u përmirësuar .

“Numri i grave police dhe ushtarë ka qenë shumë i vogël, por është e rëndësishme që kjo çështje nuk është tabu, tani kemi police dhe ushtarë”⁴¹.

KFOR-i

KFOR-i është forcë ushtarake ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO, i cili në pajtueshmëri me Rezolutën 1244, ka për mision: ndërprerjen e armiqësive dhe ruajtjen e armëpushimit, demilitarizimin e UÇK-së, krijimin e mjedisit të sigurt për kthim të refugjatëve, garantim të sigurisë publike, mbikëqyrjen e dominimit, përkrahjen e pranisë ndërkombëtare civile, vëzhgimin e kufijve dhe garantimin e lirisë së lëvizjes⁴².

Numri aktual i trupave të KFOR-it kapë shifrën 16.000 ushtarë, të cilët vijjnë nga 34 shtete. Këto të dhëna nuk janë të ndara mbi baza gjinore⁴³.

Shërbimi Korrektues i Kosovës

Misioni i Shërbimit Korrektues të Kosovës, është krijimi i sistemit penal të bazuar në standardet ndërkombëtare – sistemit që ka për qëllim riintegrimin social të personave të caktuar në shoqëri në vend të dënimit. Qëllimi i Shërbimit Korrektues të Kosovës është respektimi i të drejtave fundamentale njerëzore dhe ndihma për riintegrimin e të burgosurve në shoqëri.⁴⁴

Shërbimi Korrektues i Kosovës⁴⁵ është themeluar më 5 nëntor të vitit 1999, fillimisht me hapjen e një qendre të paraburgimit në Prizren.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Shërbimin Korrektues të Kosovës është 1.850. Prej tyre 1.305 ose 82.59 përqind janë burra dhe 275 ose 17.40 përqind gra.

⁴⁰ Intervistë me Fahri Sadriu, koordinator për barazi gjinore në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. 28.05.2007

⁴¹ Po aty

⁴² “Forcimi i Mbikëqyrjes Civile dhe i Menaxhimit të Sektorit të Sigurisë në Kosovë”, KIPRED Prishtinë 2005

⁴³ “Monitorimi i implementimit të Rezolutës 1325 në Kosovë”, Përmbledhje Ekzekutive, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, nëntor 2007. Prishtinë.

⁴⁴ Ministria e Ekonomisë dhe Financave – Buxheti 2006

⁴⁵ Institucionet Korrektuese janë: Burgu i sigurisë së lartë në Dubravë me një aneks të tipit gjysmë të hapur; Qendra Korrektuese Lypjan (tipi gjysmë i hapur); Qendrat e paraburgimit (Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren dhe Lipjan) dhe Spitali në burgun e Dubravës.

MONITORIMI I SIGURISË NË KOSOVË NGA PERSPEKTIVA GJINORE

FAQE 036

TRAJNIMET NGA FUSHA E BARAZISË GJINORE TË ORGANIZUARA NË INSTITUCIONET E SIGURISË NË KOSOVË

Neni 7 i Rezolutës 1325 nxit Shtetet Anëtare që të rrisin mbështetjen e tyre financiare vullnetare, teknike dhe logjistike për trajnime me karakter gjinor, përfshirë edhe ato të ndërmarra nga fondet dhe programet përkatëse...

“Shërbimi Policor i Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës⁴⁶, UNIFEM-i, KFOR-i, Policia e UNMIK-ut, dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, kanë iniciuar një bashkëpunim drejt avancimit të zbatimit të Rezolutës 1325. Në mënyrë specifike UNIFEM-i dhe RRGK-ja përkrahin njësitë e porsaformuara në SHPK dhe TMK, nëpërmjet trajnimeve, këmbimit të informatave dhe bashkëpunimit rreth aktiviteteve, të cilat adresojnë rolin e grave në vendim-marrje, çështjet e trafikimit dhe dhunës në familje. Përgjithësisht, iniciativa ka për qëllim të ngrejë nivelin e komunikimit ndërmjet grave, policisë dhe sektorëve të sigurisë”.⁴⁷

Kur është fjala për organizimin e trajnimeve për çështje gjinore për pjesëtarët e SHPK-së, Behar Selimi, tregon se deri tani ka pasur trajnime të vazhdueshme në Akademinë Policore me programe të avancuara, brenda dhe jashtë vendit. Sipas tij, këto trajnime kanë qenë të natyrave të ndryshme, duke filluar prej trajnimit bazik, çështjes së dhunës në familje, si dhe çështjeve të tjera që lidhen me Rezolutën 1325 dhe implementimin e ligjit për barazi gjinore.

Sipas Hysni Shalës, koordinator i SHPK-së për çështje gjinore, zyra për çështje gjinore brenda SHPK-së ka bashkëpunim me OJQ-të dhe institucionet tjera që merren me çështjet gjinore. Në të njëjtën kohë ai ka sqaruar se stafi i SHPK-së ka kaluar nëpër disa trajnime që kanë të bëjnë më çështjet gjinore. Këtë e konfirmon edhe Flora Macula, këshilltare për Qeverisje dhe Paqe për Evropën Juglindore në zyrën e UNIFEM-it në Kosovë. Sipas saj, aktualisht është duke u zbatuar projekti për integrimin e çështjeve gjinore në program-

⁴⁶ Trupat Mbrojtëse të Kosovës u krijua pas shpalljes së Rregullores 1999/8 të UNMIK-ut. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/8 thotë se mandatë i TMK-së përfshin asistencën humanitare dhe kontributin ndaj ndërtimit të infrastrukturës dhe komuniteteve.

⁴⁷ Raport mbi zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Hartuar nga Organizatat vendore në Kosovë dërguar Organizatës së Kombeve të Bashkuara në New York më 30 mars 2006. Raport përshkruan ngjarjet dhe aktivitet kryesore të ndërmarra në Kosovë në organizata vendore dhe përkrahësit e tyre të cilat synonin avancimin e zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

FAQE 037

et dhe strukturat e SHPK-së, si dhe integrimi i çështjeve gjinore në kurrikulën e trajnimeve të SHPK-së. Përveç kësaj, Macula pohon se në të njëjtën kohë janë duke u zhvilluar edhe trajnimet për trajnerët e SHPK-së.

Në TMK, janë realizuar trajnime nga lëmi i Barazisë Gjinore, të cilat janë mbështetur nga UNIFEM-i, Instituti i Kosovës për Administratë Publike, si dhe trajnime të cilat realizohen brenda TMK-së me kapacitete të pavarura (instruktorë të barazisë gjinore në TMK).

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të grave në Kosovë

Koncepti i diskriminimit në bazë të gjinisë përfshin dallimin në trajtim, përjashtimin apo kufizimin në bazë të gjinisë, që me atë rast e rrezikon apo parandalon gëzimin ose ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në politikë, shoqëri, kulturë apo fusha tjera⁴⁸.

Ndonëse në Kosovë janë hartuar një sërë ligjesh dhe strategjish për mbrojtjen e lirive njerëzore të grave dhe vajzave, problemi më i madh qëndron në implementimin dhe respektimin e tyre.

Në kuadër të këtyre ligjeve dhe strategjive bëjnë pjesë: Korniza Kushtetuese e Kosovës, Kodi i përkohshëm Penal i Kosovës, Ligji Kundër Diskriminimit, Ligji për Barazi Gjinore, Ligji i Familjes, Rregullorja Kundër Dhunës në Familje, Plani Kombëtarë i Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore, Strategjia Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, duke përfshirë edhe Konventën CEDAW, e cila është pjesë integrale e ligjeve të aprovuara në Kosovë, etj.

Legjisllacioni mbi çështjet e barazisë gjinore duhet t'i adaptohet edhe më tej situatës ekzistuese në Kosovë. Agjencia për Barazi Gjinore ka nevojë për kapacitete, legjitimitet dhe status më të qartë. Këto probleme institucionale kanë ndikim të kundërt në gjendjen e gruas në Kosovë, e cila është e karakterizuar me dhunë familjare dhe diskriminim ekonomik.

Legjisllacioni mbi dhunën në familje nuk është efikas. Për të duhen rregulla të qarta zbatuese. Njohja e dobët e legjisllacionit nga ana e gjykatësve dhe prokurorëve paraqet një pengesë shtesë⁴⁹.

⁴⁸ Ombudspesoni. Raporti i Shtatë Vjetor 2006 / 2007

⁴⁹ Raporti i Progresit 2007 për Kosovën RKSOKB 1244. Komisioni i Komuniteteve Evropiane. Bruksel 06.11.2007

FAQE 038

DHUNA NË FAMILJE

“Fatkeqësisht dëgjoj që ka raste të dhunës në familje, por nuk është dukuri shqetësuese, çdo rast i tillë është për t’u brengosur dhe nuk është i mirëseardhur, është një fenomen që nuk na ka përcjell neve në shoqërinë tonë”
Agim Çeku⁵⁰

Organizata e Kombeve të Bashkuara përkufizon “dhunën në familje” si një akt që rezulton, me dëmtimin fizik, seksual ose mendor duke përfshirë kërcënime ose akte të ngjashme, kufizimet ose heqjen arbitrare të lirisë.

Grafikoni 4 Rastet e dhunës në familje në Kosovë në periudhën Janar 2002– Prill 2007.
Burimi: Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK)




Tabela e mësipërme, pasqyron rastet e dhunës në familje, në periudhën kohore prej 2002 deri në 4 mujorin e parë të vitit 2007. Numri i rasteve nga viti në vit nuk ka ndonjë dallim drastik, mirëpo në rast se krahasohet numri i rasteve të dhunës në familje të vitit 2002 (1.273) me atë të vitit

⁵⁰ “Siguria e Kujt”, dokumentarë. Intervista e dhënë nga Agim Çeku. 2005


FAQE 039

2006 (1.371), vërehet se dhuna në familje në këtë vit (2006) është rritur për 98 raste.

Bazuar në të dhënat e marra nga SHPK-ja, kjo dukuri më shumë prekë gratë sesa burrat. Prej 1.370 rasteve në vitin 2005, 1.107 ose 81 përqind janë gra dhe vetëm 19 përqind janë burra. Ndërkaq, për vitin 2006 numri i viktimave është 77 përqind gra dhe 23 përqind burra. Po ashtu janë regjistruar 78 raste të dhunës në familje në të cilat viktimat kanë qenë fëmijët.

Sipas Tahire Haxhollit, zyrtare për dhunë në familje në SHPK⁵¹, në të shumtën e rasteve, gratë janë viktimat të dhunës në familje si rezultat i mosbarazisë ndërmjet burrit dhe gruas.

Grafikoni 5 Struktura gjinore e kryesve të dhunës në familje
Burimi: Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK)



Të dhënat e vitit 2006 tregojnë që burrat janë të "përfaqësuar" në ushtrimin e dhunës në 92 përqind të rasteve, përderisa gratë ushtrojnë dhunë në masën 8 përqind të rasteve.


⁵¹ Intervistë me Tahire Haxhollit, zyrtare për dhunë në familje në Shërbimin Policor të Kosovës. 06.07.2007

FAQE 040

Dhuna në familje më së shpeshti është e shprehur ndër çiftet bashkëshortore. Megjithatë, rastet e dhunës në familje natyrisht nuk kufizohen vetëm në relacionet bashkëshortore. Prandaj, dhuna në familje ka një shtrijë më të gjerë dhe marrëdhënia familjare në mes të viktimës dhe të kryesit prekë edhe relacione të tjera brenda familjes së gjerë.

Tabela e mëposhtme pasqyron vetëm disa nga rastet e dhunës në mes të anëtarëve me status të ndryshëm në familje. Për më gjerësisht shih grafikonin 6.

Grafikoni 6 Disa nga rastet më të shpeshta ndërmjet kryesit dhe viktimës në familje
Burimi: Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK)



Ekzistojnë forma të ndryshme të manifestimit të dhunës në familje. Tabela e mëposhtme tregon disa nga format më të shpeshta të raportuara: lëndimet trupore, sulm fizik, kanosje, keqtrajtim fizik, shqetësim, mosmarrëveshje, keqtrajtim psikik dhe largim me dhunë nga shtëpia etj.

Flora Macula nga UNIFEM-i, thotë se dhuna në familje nuk është trajtuar nga qeveria, por nga shoqëria civile. Sipas saj, kjo ka krijuar mundësinë në rritjen e vetëdijes te gratë, për të raportuar dhunën në institucionet relevante dhe për ta zhvendosur këtë çështje nga sfera e mbyllur private në atë publike.

FAQE 041

Tabela 1 Format e dhunës në familje
Burimi: Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK)

Numri i rasteve më të shpeshta	Format e dhunës
408	Lëndim i lehtë trupor
341	Sulm Fizik
252	Kanosje
83	Keqtrajtim Fizik
81	Shqetësim
71	Mosmarrëveshje
47	Keqtrajtim psikik
16	Largim me dhunë nga shtëpia e përbashkët

Kur një burrë rrah gruan, ajo nuk i tregon as fëmijëve as prindërve. Mirëpo tash lajmërojnë policinë, edhe pse nuk zgjidhin asgjë, sepse prapë kthehen dhe bashkëjetojnë me ta.

48 vjeçare, e punësuar

Tahire Haxholli, zyrtare në sektorin e dhunës në familje në SHPK, tregon se ka trende të rritjes së raportimit të dhunës në familje, por jo të dhunës. Adile Basha, udhëheqëse e sektorit për mbrojtjen e familjes në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mendon se dhuna në familje është një problem social që ekziston ndër shekuj dhe Kosova nuk është vendi i parë në botë që po përballet me këtë dukuri⁵²

Edhe Behxhet Shala, drejtor ekzekutiv në KMDLNJ, gjenezën e dhunës në familje e nxjerrë të hershme në shoqërinë kosovare. "Shumica e shqiptarëve, gruan dhe fëmijët i kemi konsideruar si pronë private. Meqë kemi pas një trajtim të tillë, atëherë i kemi dhënë të drejtë vetes që sipas vlerësimeve tona të marrim edhe masa ndëshkuese ndaj tyre. Pra, në qoftë se ne e kemi rrah

⁵² Intervistë me Adile Bashën, udhëheqëse e Sektorit për Mbrojtjen e Familjes, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. 11.07.2007. Prishtinë,

FAQE 042

gruan, kemi konsideruar se meqë jemi burra na takon edhe nga natyra, edhe nga Kanuni, edhe nga Zoti⁵³, shprehet Shala.

Gruaja e meriton dajakun atëherë kur i tejkalon normat e mirësjelljes dhe kur tradhton, sepse kur i kalon normat e mirësjelljes, atëherë ajo bëhet e rrezikshme sikurse arma. Ajo meriton jo vetëm dajak, por edhe ndarje, bile në aso raste, po them pak keq, por meriton edhe ta mbysësh krejt.

Burrë, 45 vjeçar, i punësuar në sektorin publik

“Qëndrimet shoqërore tradicionale për gratë në këtë shoqëri të dominuar nga burrat kanë kontribuar që niveli i dhunës në familje të jetë i lartë, ndërsa numri i rasteve të raportuara të jetë i vogël⁵⁴, vë në pah raportin e Qeverisë së SHBA-ve. Gjithnjë sipas këtij raporti, “dhunimi nuk ka qenë i raportuar sa duhet për shkak të stigmës kulturore lidhur me viktimat dhe familjet e tyre.”⁵⁵

“Meqë shumica e viktimave të dhunës në familje janë gra dhe fëmijë, zakonisht ky problem trajtohet nga instrumentet ndërkombëtare që mbulojnë të drejtat e njeriut të grave dhe fëmijëve. Në këtë kontekst, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave CEDAW⁵⁶ dhe Konventa për të drejtat e fëmijëve janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë”.

Raporti i OSBE-së “Raport mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë”⁵⁷ tregon që problemi kryesor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje është vonesa e paligjshme në marrjen e vendimit mbi kërkesat për urdhër dhe mbrojtje apo caktim të seancave gjyqësore, ngaqë sipas Rregullores, kërkesa për mbrojtje duhet të vendoset brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e marrjes së kërkesës nga gjykata.⁵⁸

Sipas Behar Selimit “Për luftimin e dhunës në familje nuk mund të mbështetem vetëm në polici. Policia arrin ta largojë viktimën nga vendi ku shkaktohet dhuna, por nuk ka infrastrukturë në Kosovë për t’u kujdesur për sigurinë e tyre”⁵⁹

Mediat kanë raportuar raste të dhunës sistematike, të cilët janë lajmëruar në polici vetëm pas fundit tragjik.

⁵³ Intervistë me Behxhet Shalën, drejtor ekzekutiv në KLMDNJ. 16. 07.2007. Prishtinë

⁵⁴ Raporti i Qeverisë së SHBA-ve për Respektimin e të Drejtave të Njeriut në Botë, për vitin 2005; Pjesa për Kosovën. Qershor 2006.

⁵⁵ Po aty

⁵⁶ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave (CEDAW) është miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 34/180 më 18 dhjetor 1979

⁵⁷ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Mision në Kosovë (OSBE) “Raport mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë”, korrik 2007

⁵⁸ Neni 7 (1) i rregullores mbi dhunën në familje 2003/12

⁵⁹ “Siguria e Kujt”, dokumentarë. Intervista e dhënë nga Behar Selimi. 2005

FAQE 043

Nga artikujt e gazetave lidhur me dhunën në familje, kryesisht të periudhës kohore 2006/2007, vërehet se dhuna në familje në shoqërinë kosovare është prezente në përmasa shqetësuese.

E përbashkëta që del nga këta artikuj, si dhe nga statistikat në përgjithësi, është se kryesisht viktimat të dhunës në familje janë gratë. Pasojat nga kjo dukuri rëndojnë edhe anëtarë të tjerë të familjeve, këtë e dëshmojnë edhe artikujt e ndryshëm në disa gazeta të përditshme.

Ka pasur raste kur mediat kanë raportuar në mënyrë jo korrekte për dukuritë e dhunës në familje. Në përgjithësi mediat, gjatë raportimit dhe trajtimit të dukurisë së dhunës në familje, nuk tregojnë ndjeshmërinë e duhur, për më tepër shpesh herë me gjuhën të cilën e përdorin, konfirmojnë dhe forcojnë paragjykimet ekzistuese karshi kësaj dukurie.

“dajaku tani është duke u përdorur më pak për stabilizimin e raporteve në familjet kosovare”

E shkëputur nga një e përditshme

Infrastruktura ligjore për mbrojtje kundër dhunës në familje

Në Rregulloren e UNMIK-ut, Nr. 2003/12 Mbrojtja Kundër Dhunës në Familje përmenden forma të ndryshme të ushtrimit të dhunës ndaj familjes, siç janë: shkaktimi i lëndimit trupor, marrëdhëniet seksuale ose keqtrajtimi seksual pa pëlqim, shkaktimi i frikës për gjendjen e saj fizike emocionale dhe ekonomike, rrëmbimi, kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes, largimi me dhunë nga banesa, ndalimi për të hyrë në banesë të përbashkët, përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër, etj. Në këtë drejtim për parandalimin e këtyre veprimeve, organet gjyqësore dhe organet tjera që merren me luftimin e dhunës në familje janë institucionet si: Policia, Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë) etj. Këto organe janë të obliguara që viktimës së dhunës në familje apo dëshmitarëve t'i sigurojnë të gjitha parakushtet në mënyrë që ai/ajo t'i realizojë të drejtat në bazë të ligjit. Për ta mbrojtur viktimën nga dhuna në familje janë parashikuar masat e urdhrave për mbrojtje, urdhrave për mbrojtje emergjente dhe urdhrave për mbrojtje emergjente të përkohshme, me të cilat masa do t'i ndalohet të pandehurit që të mos kryejë ose të mos kërcëno-

FAQE 044

jë se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje ndaj personit të mbrojtur në këtë rast gruas viktimë. Sipas kësaj rregullore, urdhrin mbrojtës e lëshon gjykata kompetente në territorin e të cilës është paraqitur dhuna në familje, në bazë të kërkesës së palës ndaj të cilës është ushtruar dhuna në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Organet për zbatimin e ligjit kanë përgjegjësi të veçantë në zbatimin e masave mbrojtëse e veçmas në përcjelljen e respektimit të urdhreve mbrojtëse, dhe përkitazi me këtë në marrjen e vendimeve adekuate dhe njoftimin e gjykatës. Shkelja e urdhreve për mbrojtje sipas nenit 15 të kësaj rregullore paraqet vepër penale të dënueshme me gjobë prej 200 deri 2.000 euro, ose dënim me burg deri në gjashtë 6 muaj.

Në bazë të procedurave, të cilat përputhen me rregulloren për dhunën në familje, pas raportimit të një rasti në polici, dhe pasi që Njësi për Avokim dhe Ndihmë Viktimave kontaktohet drejtpërsëdrejti, njësi e cakton një zyrarë (avokat) mbrojtës të viktimës. Nëqoftëse viktima nuk ka strehim, njësi e sugjeron nga të orientohet. Ky njësi, i paguan si kompensim OJQ-ve (vend-strehimin) dhe më pas viktima përcillet deri në fund të gjykimit. Pas këtyre procedurave, viktimat zakonisht vendosen në strehimore. Aktualisht në tërë Kosovën janë 5 strehimore në pesë komuna: Gjilan, Mitrovicë, Prishtinë, Pejë dhe Gjakovë. Shërbimet që u ofrohen viktimave në këto strehimore, që janë kryesisht organizata joqeveritare të grave⁶⁰ janë: strehimi, ushqimi, përkrahja psiko-sociale më konkretisht seanca me psikologë dhe këshillime, trajnime me përmbajtje të ndryshme (kurse të gjuhës angleze, të rrobaqepësisë, për kompjuterë etj), vetëdijësim mbi të drejtat e tyre e deri te përkrahja ligjore. Sipas anketës së realizuar me përfaqësues të këtyre strehimoreve dhe OJQ-ve arsyet më të shpeshta që gratë orientohen në strehimore janë: dhuna psikologjike, dhuna fizike në familje, dhuna seksuale dhe trafikimi.

Viktimat që orientohen në këto qendra kryesisht janë nga Kosova, duke mos përfshiruar edhe rastet e rralla të viktimave nga vende të tjera. Koha më e shkurtër që viktima mund të qëndroj në strehimore zakonisht është 24 orë, përderisa ajo më e gjata sillet përafërsisht prej 6 muaj deri në 3 vjet. Përveç trajtimit që merr viktima në strehimore, duket se nuk ka mekanizma që punojnë drejt procesit të risocializimit të viktimës, dhe për këtë arsye në të shumtën e rasteve mundësia e vetme që u mbetet viktimave është kthimi në ambientin e njëjtë ku janë keqtrajtuar më parë. Ndërsa, sa i përket sigurisë së viktimave brenda objekteve të strehimoreve ka raste kur ato kërcënohen, ndonëse këto raste nuk janë të shpeshta.

⁶⁰ Një pjesë të mbështetjes financiare këto strehimore sigurojnë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare dhe në raste të caktuara edhe ndonjë ndërmarrje private.

FAQE 045**TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE**

Trafikimi i qenieve njerëzore, veçanërisht i grave dhe fëmijëve vazhdon të jetë ndër dukuritë më brengosëse në tërë rajonin. Duke pasur parasysh që Kosova ndodhet në një periudhë transicioni, Shërbimi Policor i Kosovës, e cilëson këtë si periudhë të përshtatshme për shfrytëzim moral dhe psikik të personave.⁶¹

Në përgjithësi, në Kosovë, viktimat më të shpeshta të trafikimit janë gratë dhe vajzat, të cilat kryesisht trafikohen me qëllim të shfrytëzimit seksual. Përveç kësaj, trafikimi mund të bëhet për qëllime përfitimi, p.sh. për transplantim të organeve apo punë skllavërie.

Këtë e pohon edhe Ramadan Ahmeti, shef i sektorit antitrafikim në Shërbimin Policor të Kosovës, sipas të cilit megjithatë në Kosovë nuk janë regjistruar raste të tilla: "Te ne nuk ka qëllime të tilla, së paku deri tani nuk kemi arritur të zbulojmë rrjete që shfrytëzojnë viktimat për transplantim organesh apo punë të detyrueshme."⁶² Përkundër kësaj, trafikimi me gratë dhe vajzat për qëllim të shfrytëzimit seksual ndodh në mbarë botën. Gratë dhe vajzat nga Moldavia, Rumania, Ukraina, Shqipëria janë të detyruara në prostitucion."⁶³

Gjatë periudhës 2001 - 2006 janë identifikuar 91 viktimat të trafikimit, 85 prej tyre janë shfrytëzuar për qëllime seksuale, 4 për punë të detyrueshme, ndërsa 2 prej tyre janë shfrytëzuar për kërkim lëmoshe apo vjedhje.⁶⁴

Sipas një hulumtimi për Trafikimin e Qenieve Njerëzore në Kosovë, shumica e respondentëve besojnë se gratë dhe vajzat e reja janë më të rrezikuara nga dukuria e trafikimit. Sipas tyre, kjo ndodh për arsye se trafikantët fitojnë para shpejtë dhe lehtë.⁶⁵

Në bazë të kategorizimit të IOM-it, në periudhën 2001 - 2006, prej gjithsej 91 viktimitave, 30 prej tyre kanë qenë në vitin 2006, 17 në vitin 2003, nga 12 në vitin 2002 dhe 2005, 11 më 2004, 6 më 2001 dhe deri në mars të vitit 2007 janë regjistruar 3 viktimat.


⁶¹ Gazeta "Express", e diel, 15 korrik 2007, faqe 13

⁶² Intervistë me Ramadan Ahmetin, shef i sektorit antitrafikim. 28.06.02007 Prishtinë

⁶³ IOM "Njësitë Kundër Trafikimit". Projekti i kthimit dhe riintegritimit 2000-2002

⁶⁴ Të dhënat janë të marra nga IOM

⁶⁵ Research Study on Trafficking in Human Beings. Partnership Against Trafficking in Human Beings, Kosovo 2007, faqe 7

FAQE 046**Grafikoni 7:** Numri i viktimave të reja lokale të vlerësuara sipas muajit dhe vitit
Burimi: IOM


Numri i viktimave u dyfishua brenda një viti, kur dihet se në vitin 2001 kishte 6 viktima ndërsa në vitin 2002, 12 viktima. Edhe në vitin 2003 numri i rasteve ishte më i lartë për 5 viktima në krahasim me vitin 2002. Më 2004 kishte një rënie të rasteve të trafikimit për 5 viktima më pak në krahasim me vitin paraprak. Në bazë të kësaj, vërehet se numri më i madh i viktimave u shënuar në vitin 2006 dhe krahasuar me vitin 2001 (6 viktima) numri i viktimave është rritur 5 herë më shumë (30 viktima).

Numri më i madh i rasteve është shënuar në Prishtinë, me 28.57 përqind prej numrit të përgjithshëm. Më pas radhiten: Mitrovica me 23.07 përqind, Gjilani me 15.38 përqind, Ferizaj me 12.08 përqind, Peja me 6.59 përqind, Gjakova dhe Prizreni me nga 5.49 përqind, dhe Kaçaniku me 3.29 përqind të rasteve.

Numri më i madh i viktimave të trafikimit apo 36 përqind prej numrit total janë të moshës 16 -18 vjeçare apo moshës së mitur, 26 përqind i takojnë moshës 19 - 25 vjeç, prej moshës 25 vjeçare e më lartë janë 20 përqind, ndërsa 18 përqind janë të moshës 12-15 vjeçare.

FAQE 047**Grafikoni 8.** Numri i viktimave sipas vendit (në %)

Burimi: IOM



Në kategorizimin sipas shkallës së edukimit të viktimave të trafikimit, prej numrit total (91), del se numri më i madh i viktimave, më konkretisht 41 prej tyre kanë të kryer shkollimin elementar 9 vjeçar, 33 të tjera janë me shkollim elementar 5 vjeçar, 11 janë të pashkolluara, 5 me shkollë të mesme dhe 1 me fakultet. Nga i njëjti burim, sa i përket metodave të rekrutimit, të dhënat tregojnë se 59 viktimave u është premtuar punë, 26 të tjerave u është premtuar martesë, ndërkaq 6 viktima janë kidnapuar.

E përbashkëta e të gjitha raporteve mbi trafikimin e qenieve njerëzore, është se shumica e viktimave vijnë nga viset rurale, me status të ulët socio-ekonomik, ndërsa po t'i referohemi nivelit arsimorë të viktimave del se më shumë se gjysma e tyre kanë pasur nivel të ulët të arsimit.

“Njësitë Antitrafikim është njësitë brenda Shërbimit Policor të Kosovës, misioni i të cilit është luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore, në tri drejtime: **parandalim** të krimit dhe veprave të tilla, **ndjekje** të kryesve dhe prezantimi i fakteve në gjykatë dhe **mbrojtje** dhe asistencë të viktimave të trafikimit”⁶⁶

Në raportin e punës së këtij njësitë, për periudhën Janar – Qershor 2007, thuhet se në disa rajone ka mungesë të personelit, si dhe në përgjithësi struk-

⁶⁶ Marrë nga raporti i Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK)

FAQE 048

tura e organizimit të këtij njësi është e paqartë.


Në kuadër të operacioneve të këtij njësi antitrafikim në SHPK, në tërë Kosovën janë bërë 91 vëzhgime, 37 operacione të fshehta, 56 operacione të përbashkëta me njësi të tjera dhe 15 operacione me komuna.

Ndërkaq sa i përket lokaleve të dyshuara për zhvillim ilegal të prostitucionit, janë kontrolluar 591 të tilla dhe 10 të tjera janë mbyllur. Sipas këtij raporti janë intervistuar 46 persona për dyshim të trafikimit me njerëz, 15 për kundërvajtje "emigrim" dhe 83 dëshmitarë.

Pjesëtarët e këtij njësi në periudhën janar – qershor 2007, kanë arrestuar gjithsej 26 persona, prej tyre 18 burra dhe 8 gra. Sa u përket rasteve, në këtë periudhë kohore ka pasur 29 raste të reja, 13 raste të dorëzuara në gjykatë, 10 raste të mbyllura dhe 17 raste nën hetime.

Një burrë 40 vjeçar është arrestuar nga policia gjatë fundjavës në Gjilan dhe po mbahet në paraburgim me urdhër të prokurorit pasi dyshohet të jetë përfshirë në një rast të trafikimit të qenieve njerëzore. Policia gjatë kontrollit të një veture pa leje, kishte hasur në një femër, e cila ishte e trafikuar.⁶⁷

Grafikoni 9 Numri dhe nacionaliteti i viktimave gjatë periudhës janar – qershor 2007
Burimi: Njësi antitrafikim; Shërbimi Policor i Kosovës



⁶⁷ Gazeta "Express", e martë 10 korrik 2007, faqe 11

FAQE 049

Vetëm në periudhën janar – qershor 2007 janë identifikuar 19 **viktima** të trafikimit. Prej tyre 6 janë shtetase shqiptare, 9 kosovare, 2 nga Moldavia, 1 shqiptare nga Maqedonia dhe 1 shqiptare nga Serbia. Nga 19 viktima, 13 u është ofruar ndihma e institucioneve, ndërsa 6 të tjera janë riatdhesuar.

Ariana Qosja - Mustafa, Këshilltare Ligjore Nacionale për Gratë dhe Fëmijët dhe pjesë e Njësitit kundër Trafikimit në OSBE, duke folur për problemin e trafikimit ka bërë të ditur se ende pjesa më e madhe e vajzave të trafikuar vijnë nga Moldavia e Rusia, përderisa nuk është i vogël as numri i atyre që vijnë nga Bullgaria dhe në raste të rralla edhe nga Shqipëria e Rumania. Sipas saj ka një trend të barazimit të numrit të viktimave me vajzat kosovare.

Shumica e vajzave kanë qenë nga Kosova, kryesisht në mes moshës 16 deri 25 vjeçare.

Viktimitë e trafikimit, shqiptare nga Kosova⁶⁸

Të njëjtën gjë e ka pohuar edhe Virginia Dumnica (UNDP), sipas së cilës numri i vajzave që trafikohen brenda për brenda Kosovës është rritur. “Është bërë një problem i madh, veçanërisht në rajonin e Ferizajt dhe në një pjesë të Prizrenit”⁶⁹, ka sqaruar Dumnica.

Raporti i qeverisë amerikane, për respektimin e të drejtave të njeriut në botë, në pjesën për Kosovën, tregon se “Kosova është burim, transit dhe pikë destinimi për personat e trafikuar. Trafikimi i brendshëm është një problem në rritje. Sikurse dhe vitet e kaluara, shumica e viktimave ishin gra dhe fëmijë të trafikuar prej Evropës Lindore, Ballkanit, ish-Bashkimi Sovjetik në Kosovë, në mënyrë primare për eksploatim seksual, por edhe për shërbime ose punë të detyruar në bare dhe restorante, ndërsa nga Kosova viktimat trafikohen në Maqedoni, Shqipëri, dhe Evropën Perëndimore.”⁷⁰

Hulumtimi për Trafikimin e Qenieve Njerëzore në Kosovë vë në pah se më shumë se gjysma e të intervistuarve besojnë se Kosova është vend transit për trafikim, ndërsa vetëm një e katërta e të intervistuarve në fjalë pranojnë se Kosova është vend i origjinës së trafikimit.

Hulumtimi i lartpërmendur thekson edhe një aspekt tjetër që kishte të bënte

⁶⁸ Research Study on Trafficking in Human Beings. Partnership Against Trafficking in Human Beings, Kosovo 2007, faqe 55

⁶⁹ Intervistë me Virginia Dumnica (UNDP). Intervista e dhënë projektit të CEDAW (QKSGJ), intervistuar nga Lynne Alice. 22.06.2007 Prishtinë

⁷⁰ Raporti i Qeverisë së SHBA-ve për respektimin e të drejtave të njeriut në botë për vitin 2005, pjesa për Kosovën. 119. Research Study on Trafficking in Human Beings. Partnership Against Trafficking in Human Beings, Kosovo 2007

FAQE 050

me njohurinë e qytetarëve për dukurinë e trafikimit si dhe dallimin ndërmjet trafikimit dhe prostitucionit. "Respondentët kishin dëgjuar fjalën "trafikim me qenie njerëzore" dhe për shumicën e tyre trafikimi kishte kuptimin e shfrytëzimit seksual. Një pjesë e tyre nuk dinin ta bënin dallimin ndërmjet prostitucionit dhe trafikimit me qenie njerëzore. Më shumë se 65 përqind e respondentëve nuk kanë mundur ta shpjegojnë dallimin ndërmjet trafikimit dhe prostitucionit"⁷¹.

Prostitucionin e bëjnë me dëshirë gratë/vajzat, askush nuk i detyron. Unë nuk kam dëgjuar që dikush është grabitur me dhunë. Te ne thonë "fjalë të grave", që dikush është grabitur apo është vjedhur, ndërsa sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore, unë nuk kam njohuri që ekziston në Kosovë. Nuk mendoj se është e zhvilluar një dukuri e tillë, vetëm nëse personi dëshiron, në këtë rast vajza me grupacionin janë në pajtueshmëri, ndoshta ai mund të quhet trafikim, unë nuk e di.

Student, 22 vjeçar⁷²

Shpeshherë, për shkak të mentalitetit, viktimat e trafikimit pos mungesës së përkrahjes, në të shumtën e rasteve etiketohen si prostituta. Kjo në një masë të madhe reflekton më vonë edhe në pamundësinë e risocializimit të tyre. Sipas Ariana Qosja - Mustafa, këto viktimat janë shumë të reja dhe një fatkeqësi tjetër është se për shkak të mentalitetit tradicional ato konsiderohen nga shoqëria si prostituta: "Është një rast në Komunën e Pejës, ku një familje është injoruar komplet nga fshati, sepse prindërit kanë pranuar vajzën e tyre të kthehet në shtëpi, e cila ka qenë viktimë e trafikimit."⁷³

Këto gra janë pa karakter, ato janë imorale, njëjtë sikurse edhe klientët, sepse ato duhet ta dinë që janë duke vepruar gabimisht dhe se nuk duhet vizituar ato klube të natës⁷⁴

Qytetar nga një zonë e Prishtinës

⁷¹ Po aty

⁷² Fokus Grup. Më gjerësisht për fokus grupet e organizuara me burra dhe gra shih "Përshkrimi i metodologjisë".

⁷³ Intervistë me Ariana Qosja Mustafa – Këshilltare Ligjore Nacionale për Gratë dhe Fëmijët dhe pjesë e Njësitit kundër Trafikimit në OSBE. Intervista e dhënë projektit të CEDAW (QKSGJ), intervistuar nga Lynne Alice. 26.06.2007. Prishtinë

⁷⁴ Research Study on Trafficking in Human Beings. Partnership Against Trafficking in Human Beings, Kosovo 2007, faqe

FAQE 051

“Aktualisht, trafikimi është një çështje e ndjeshme, mirëpo mendoj se asnjëherë nuk mund të investosh mjaft para, nuk mund të bësh mjaft trajnime dhe asnjëherë nuk mund ta marrim këtë çështje me aq seriozitet sa duhet”⁷⁵ Më shumë se 40 përqind e respondentëve besojnë se policia do të duhej të përkujdesej dhe të luftojë dukurinë e trafikimit, ndërsa 38.4 përqind mendojnë se përgjegjësia do të duhej të bie mbi Qeverinë e Kosovës⁷⁶.

Kolonel Sheremet Ahmeti, thotë se po punohet me intensitet të shtuar për zbulimin dhe kapjen e akterëve të kësaj dukurie negative. “Ne kemi njësitë tona të trajnuara për të luftuar këtë veprim dhe unë besoj që me angazhimin tonë të përbashkët do t’ia dalim që këtë dukuri ta çrrënjësim.”⁷⁷

Megjithatë, në trajtimin e kësaj dukurie, pos mungesës së stafit adekuat në Shërbimin Policor të Kosovës, ndihmon edhe trajtimi jo adekuat i trafikantëve nga ana e gjykatave.

Autoritetet qeveritare kanë bërë të ditur se janë në përpjekje për të ngritur kapacitetet, plotësimin dhe ngritjen buxhetore të atyre që kanë për të punuar në mënyrë ekskluzive në çështjen e trafikimit ka theksuar Cyme Mahmutaj, zyrtare e lartë për Qeverisje të Mirë në Qeverinë e Kosovës. Sipas saj rregullorja mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë është hartuar në kohën kur kjo dukuri kishte një shtrirje tjetër: “ne kemi pas më shumë vajza të trafikuar nga Moldavia në Kosovë, derisa tani është ndërruar struktura”⁷⁸.

Flora Macula⁷⁹, këshilltare për Qeverisje dhe Paqe për Evropën Juglindore në zyrën e UNIFEM-it në Kosovë mendon se Institucionet duhet të bëjnë më shumë në parandalimin dhe luftimin e dukurisë së trafikimit, sepse ajo ka filluar të zhvillohet brenda Kosovës dhe po kërcënon sigurinë e vajzave të mitura.

Për mungesë të ndërhyrjes së mekanizmave institucional për monitorimin e vendeve ku zhvillohet prostitucioni, në disa raste banorët vet organizohen në luftimin e kësaj dukurie: “Banorët e lagjes Sadik Tafarshiku në Ferizaj, me vetorganizim, kanë mbyllur dhjetë kafene, për të cilat thonë se janë vende ku ushtrohet prostitucioni, me çka e kanë rihapur temën alarmante të trafikimit të qenieve njerëzore, e cila në të shumtën mbahet e fshehur nën rrogë”⁸⁰

⁷⁵ Intervistë me Clare Hutchinson, kryesuese në zyrën për barazi gjinore UNIMK, 19.06.2007, Prishtinë

⁷⁶ Research Study on Trafficking in Human Beings. Partnership Against Trafficking in Human Beings, Kosovo 2007, faqe 24

⁷⁷ Gazeta “Express”, 9 janar 2007, faqe 12. Besiana Xharra

⁷⁸ Intervistë me Cyme Mahmutaj, zyrtare e lartë në zyrën për qeverisje të mirë, të drejta të njeriut, mundësi të barabarta, dhe çështje gjinore, Qeveria e Kosovës, 20.08.2007, Prishtinë

⁷⁹ Intervistë me Flora Maculën, UNIFEM

⁸⁰ www.agimi.com/modules.php?name=News&file=article&sid=339 marrë nga interneti më 30 maj 2007. Autorë: Milazim Krasniqi “Futja e Kosovës në raportet e organizatave të ndryshme, si vend i trafikimit dhe i prostitucionit skllavërues në shkallë të lartë, e vështirëson argumentin për rolin që mund ta luajë një Kosovë e pavarur si faktor i stabilitetit në rajon.

FAQE 052

Igballe Rogova, drejtoreshë ekzekutive e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës thekson se vështirësitë e luftimit të dukurisë së trafikimit lidhen me problemet e pranishme në sistemin gjyqësor si dhe me vullnetin politik të UNMIK-ut dhe KFOR-it për të parandaluar këtë dukuri. "Mekanizmat janë mirëpo duhet të funksionojë sistemi gjyqësorë që t'i dënojë trafikantët"⁸¹, thotë Rogova.

Edhe drejtori ekzekutiv i KMLDNJ-së, Behxhet Shala, ka bindjen se dukuria e trafikimit është e shprehur posaçërisht pas instalimit të administratës ndërkombëtare në Kosovë. "Trafikimi është i theksuar kryesisht tash me ardhjen e ndërkombëtarëve, ngase zakonisht ku ka forca të mëdha policore dhe ushtarake të huaja, ku ka administratë ndërkombëtare, atëherë ndihet nevoja edhe për trafikim. Megjithatë nuk është kjo dukuri që është paraqitur për herë të parë në Kosovë, mirëpo është dukuri e shprehur kryesisht në vendet ku është standardi më i ulët, në vendet ku ka pas konflikte të armatosura, pastaj ka pas intervenime ndërkombëtare"⁸², ka shfaqur mendimin Shala. Në këtë kontekst, ai ka akuzuar ndërkombëtarët për trafikim, të cilët sipas tij në vend që të krijojnë mekanizma për parandalimin e trafikimit, merren me pasojat, duke i ekstraduar, apo duke i strehuar përkohësisht viktimat, gratë dhe vajzat të cilat kanë qenë viktimat të trafikimit. "Ndërkombëtarët janë ata të cilët kanë ndihmuar në lulëzimin e trafikimit, ata e kanë udhëhequr trafikimin dhe ata nuk kanë ndërmarrë masa për parandalimin e trafikimit"⁸³, ka deklaruar Shala.

Për Adile Bashën, udhëheqëse e Sektorit për Mbrojtjen e Familjes, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, trafikimi është dukuri e pasluftës. "Dukuria e trafikimit me qenie njerëzore është një dukuri shumë shqetësuese për shoqërinë kosovare, në fakt kjo dukuri e re në Kosovë, trafikimi i qenieve njerëzore filloi të njihet pas luftës së fundit më 1999"⁸⁴, ka theksuar Basha. Të njëjtën bindje e ndanë edhe

Ariana Qosja - Mustafa: "Pas ardhjes së trupave ushtarake dhe policore ndërkombëtare në Kosovë në vitin 1999 kryesisht ndërkombëtarët kanë qenë shfrytëzues të këtyre shërbimeve. Ndërkaq, tani shfrytëzuesit kryesor janë vendorët, gjë e cila është vërtetuar me fakte dhe të dhëna statistikore"⁸⁵.

81 Intervistë me Igballe Rogovën, drejtore ekzekutive në Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës. 18.09.2007. Prishtinë

82 Intervistë me Behxhet Shalën

83 Intervistë me Behxhet Shalën

84 Intervistë me Adile Basha, Udhëheqëse e Sektorit për Mbrojtjen e Familjes, në MPMS. 11.07.2007. Prishtinë.

85 Intervistë me Ariana Qosja- Mustafa – Këshilltare Ligjore Nacionale për Gratë dhe Fëmijët dhe Pjesë e Njësitit kundër Trafikimit në OSBE. Intervista e dhënë projektit të CEDAW (QKSGJ), intervistuar nga Lynne Alice. 26.06.2007. Prishtinë

FAQE 053

Dukuria e trafikimit në Kosovë mbetet çështje mjaft shqetësuese dhe sfidë e institucioneve dhe shoqërisë për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie.

Infrastruktura Ligjore dhe dukuria e trafikimit me qenie njerëzore

Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2001/4 e datës 12 janar 2001, mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë ka paraparë ndëshkimin e trafikantëve të qenieve njerëzore. Çdo person që merret ose tenton të merret me trafikimin e njerëzve kryen vepër penale dhe pas shpalljes fajtor i nënshtrohet dënimit prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet burg. Në rast se viktimat e trafikimit është nën moshën 18-vjeçare, dënimi maksimal për personin që merret me trafikim është deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet burg. Çdo person, i cili nga pakujdesia ndihmon trafikimin me njerëz kryen vepër penale dhe pas shpalljes fajtor i nënshtrohet dënimit prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet burg (neni 2 pika 1, 2 dhe 4 i Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2001/4)

Neni 4.1 i kësaj rregulloreje thotë: “çdo person që shfrytëzon ose siguron shërbimet seksuale për një person duke qenë në dijeni se ai person është viktimë e trafikimit me njerëz kryen vepër penale dhe pas shpalljes fajtor i nënshtrohet dënimit prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet burg.”

“Në rast se personi që ofron shërbimet seksuale të cekura në nenin 4.1 është nën moshën 18-vjeçare, dënimi maksimal për personin e shpallur fajtor për shfrytëzimin ose sigurimin e shërbimeve të tilla është deri në dhjetë (10) vjet burg”. (neni 4.2)

E veçanta e kësaj rregulloreje është se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron një koordinator për ndihmë viktimave, i cili është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të kësaj rregulloreje. Gjatë ushtrimit të detyrave të tij ose të saj, koordinatori për ndihmë viktimave ndërlikohet me autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit, me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare ose me organizatat e tjera dhe sipas nevojës, me departamente administrative.(neni 9)

Neni 10 i kësaj rregullore ka të bëjë me ndihmën për viktimat e trafikimit. Sipas këtij neni “Me kërkesë të një personi që i ofron koordinatorit për ndihmë të viktimës fakte të arsyeshme për të besuar se ai apo ajo ka qenë viktimë e trafikimit, atij apo asaj, varësisht nga mjetet në dispozicion dhe në përputhje me nenin 9.2 i ofrohen shërbimet e mëposhtme: shërbime falas të përkthimit në gjuhën që e zgjedhin ata, këshillim juridik falas lidhur me çësht-

FAQE 054

jet e trafikimit (penale ose civile), strehim të përkohshëm të sigurt, ndihmë psikologjike, mjekësore dhe të mirëqenies sociale sipas nevojës për përbushjen e nevojave të tyre dhe shërbime të tjera që përcaktohen me urdhëresat administrative.

Gjithashtu, Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2003/25 (6 korrik 2003) Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, neni 139 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 ka paraparë sanksionet penale të trafikimit me njerëz.

Kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.

Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën 18- vjeçare, kryesi dënohet me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.

- Kushdo që organizon një grup personash për të kryer veprën nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.
- Kushdo që nga pakujdesia lehtëson kryerjen e trafikimit me njerëz dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- Kushdo që përdor ose siguron shërbime seksuale të një personi për të cilin e di se personi i tillë është viktimë e trafikimit, dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.

Nëse vepra penale nga paragrafi 5 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën 18- vjeçare, kryesi dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.

Nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij, kryesi dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafet 1 ose 2, me burgim prej së paku dhjetë vjetësh për veprën penale nga paragrafi 3, me burgim prej dy deri në shtatë vjet për veprën penale nga paragrafet 4 ose 5 ose me burgim prej pesë vjetësh deri në dymbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 6.

FAQE 055**NDIKIMI I ARMËVE TË VOGLA DHE TË LEHTA NË DHUNËN GJINORE**

"Kam dëgjuar fjalë të pleqve, sipas të cilave nëse gruaja e di që ke armë në shtëpi, atëherë lirisht dorëzoje ose shite atë"⁸⁶

Hulumtimet në shumë vende të botës nxjerrin në pah se shumica e krimeve të kryera me armë të vogla dhe të lehta, kanë për autorë burrat, të cilët gjithashtu të shumtën e rasteve janë edhe viktimat.

Sipas hulumtimit "Hulumtimi mbi Armët e Vogla dhe të Lehta në Kosovë", prej janarit 2000 deri në prill 2006, burrat përbënin 95 përqind, të të dyshuarve për vrasje, ndërsa gratë përbënin 5 përqind. Megjithatë, gratë ishin viktimat në pothuaj 13 përqind të vrasjeve me Armë të Vogla dhe të Lehta

"Armët vrasin dhe plagosin më shumë burrat sesa gratë. Mbi 90 përqind e viktimitave të vrara nga armët në tërë botën janë burra. Në Kosovë, llogaritet të jenë në duar të civilëve 330.000-460.000 armë të lehta. Sipas këtyre të dhënave del se më së shumti bartës të këtyre lloj armësh janë burrat mbi moshën 18 vjeçare."⁸⁷

Në këtë kontekst, Kosovën e pret një angazhim i madh në drejtim të vënies nën kontroll të këtyre armëve.

"Qëllimi kryesor i autoriteteve në procesin e kontrollit të armëve me kalibër të vogël nuk është çarmatimi i popullsisë, por forcimi i kontrollit të armëve me kalibër të vogël dhe atyre të lehta në Kosovë."⁸⁸

Sipas Blerim Kuqit, Ministër i Punëve të Brendshme, ministria që ai e drejton e vlerëson si çështje mjaft të rëndësishme kontrollin mbi armët e vogla dhe të lehta. Për t'u bërë kjo, Kuçi ka thënë se kusht është që, institucionet kompetente, të jenë të afta.⁸⁹

Helena Vazquez, udhëheqëse e projektit KOSSAC⁹⁰, ka shfaqur brengën për mungesë të një rregulloreje për kontrollin e armëve. "Korniza kushtetuese ka shumë mangësi. Kjo është gjendje që duhet të ndryshojë dhe kosovarët duhet të reagojnë. Duhet të ketë patjetër një bashkërendim të punëve në mes të ministrive përkatëse dhe Kuvendit të Kosovës" u shpreh ajo, në konferencën e organizuar nga UNDP-ja.⁹¹

⁸⁶ Fokus Grupi me burra i organizuar më 25.10.2007.

⁸⁷ Koha Ditore/ e premte, 25 maj 2007 – Ann Sofie Nilsson (autorja është shefe e zyrës ndërlidhëse suedeze në Kosovë).

⁸⁸ Marrë nga interneti më 23 prill 2007. Gani Lajqi "Sfidat e Kosovës me armët ilegale". Intervista e dhënë nga Frode Muring, shef i UNDP-së

⁸⁹ Po aty, intervistën e dhënë nga Blerim Kuçi, Ministër i Punëve të Brendshme

⁹⁰ KOSSAC - Kosovo Small Arms Control

⁹¹ Koha Ditore, e enjte 12 prill, 2007 Kastriot Jaha "Armët për vetëmbrojtje"

FAQE 056

Përkundër përpjekjeve të bëra nga KFOR-i dhe organizata tjera ndërkombëtare për grumbullimin e armëve në Kosovë, statistikat tregojnë se prania e armëve në duar të qytetarëve vazhdon të jetë e lartë.

Tabela 2 Monitorimi i mediave nga UNDP-ja në 6 vende të Ballkanit
Burimi: UNDP – South Eastern and Eastern Europe Clearing House for the Control of Small Arms and Light Weapons

Vendi	Autorët		Viktimat	
	Burra	Gra	Burra	Gra
Shqipëria	92 - 98 %	2 - 2 %	55 - 81 %	13 - 19 %
Bosnja dhe Hercegovina	60 - 98 %	1 - 2 %	45 - 92 %	4 - 8 %
Kroacia	219 - 98 %	4 - 2 %	110 - 63 %	66 - 37 %
Maqedonia	59 - 100 %	0 - 0 %	43 - 90 %	5 - 10 %
Kosova	620 - 98 %	10 - 2 %	219 - 93 %	16 - 7 %
Mali i Zi	24 - 100 %	0 - 0 %	22 - 92 %	2 - 8 %
Përqindja %	99 %	1 %	85 %	15 %

Duke u bazuar në një analizë të monitorimit të mediave (të vitit 2007), e cila ka përfshirë 6 vende të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Kosovë dhe Mal të Zi) të bërë nga UNDP-ja del se në përgjithësi në këto vende, kryes të krimit me armë zjarri janë burrat dhe atë në 99 përqind të rasteve. Një shifër skajshmërisht e vogël i referohet gjinisë femërore, e cila në këtë lloj krimi është e përfshirë vetëm me 1 përqind. Sipas këtij raporti, viktimat të këtyre krimeve në përgjithësi janë burrat me 85 përqind, ndërsa gratë me 15 përqind.

Nga kjo nënkuptohet se burrat në këto vende të Ballkanit, vrasin por edhe e vriten më shumë nga armët e zjarrit.

FAQE 057

Kosova, prinë si për nga numri i kryesve të veprave ashtu edhe nga numri i viktimave në krahasim me këto 6 vende, gjithnjë bazuar në këtë raport. Nga 630 autorë të krimeve me armë zjarri në Kosovë, 620 prej tyre kanë qenë burra, ndërsa vetëm 10 prej tyre gra. Ky raport nxjerrë burrat jo vetëm si kryes më të shpeshtë të krimeve, por edhe si viktimë. Kështu nga 235 viktima në Kosovë, 212 janë burra, ndërsa 16 gra.

Pas kosovarëve, sipas këtij monitorimi, më së shumti "vrasin dhe vriten" kroatët. Edhe në Kroaci autorë të krimit me armë zjarri më shumë janë burrat, nga 223 autorë krimi, 219 janë burra, ndërsa 4 prej tyre janë gra. Kështu, monitorimi i mediave në Kroaci tregon se nga numri i përgjithshëm i viktimave prej 176 sosh, 110 janë burra dhe 66 janë gra.

Në Shqipëri nga 94 autorë të krimit, 92 prej tyre janë burra, ndërsa vetëm 2 prej tyre nga numri i përgjithshëm janë gra. Këto akte, në Shqipëri kanë rezultuar me 68 viktima, prej të cilëve 55 persona e tyre janë burra dhe 13 gra. Në Bosnje dhe Hercegovinë autorë të krimit me armë zjarri, nga numri i përgjithshëm 60 janë burra dhe 1 grua. Nga 49 viktima me armë zjarri në Bosnje dhe Hercegovinë, 45 janë burra, ndërkaq 4 janë gra.

Gjithnjë duke u bazuar në analizën rajonale të monitorimit të mediave, në Maqedoni janë regjistruar 59 autorë të krimit me armë zjarri dhe që të gjithë janë burra. Ndërkaq nga 48 viktima të këtyre krimeve, 43 persona janë burra dhe 5 gra.

Statistikat në Mal të Zi tregojnë se janë regjistruar 24 burra autorë të krimit me armë zjarri, të cilët kanë vrarë 22 burra të tjerë dhe 2 gra.

Ann Sofie Nilsson, shefe e zyrës suedeze në Prishtinë, në një artikull të saj, botuar në të përditshmen "Koha Ditore", ndër të tjera thekson se: "Keqpërdorimi i armëve të vogla dhe të lehta kontribuon në pabarazinë mes grave dhe burrave dhe në krimin mbi baza gjinore në vendet përreth tërë globit, të prekura nga lufta ose në gjendje paqej. Përderisa shumica dërmuese e atyre që i përdorin, mbesin të vrarë ose të plagosur nga armët e vogla dhe të lehta janë burrat, në veçanti gratë janë të cënueshme nga tytat e armëve."⁹²

Sipas hulumtimeve të ndryshme, gratë më shumë janë të rrezikuara nga armët e lehta dhe të vogla në familje, respektivisht nga dhuna ndërmjet partnerëve. "Marrja parasysh e çështjes gjinore në implementimin e politikave për kontrollin mbi armët e lehta mbetet e zbehtë në tërë botën. Normat kulturore që

⁹² Koha Ditore, e premte, 25 maj 2007 – Ann Sofie Nilsson (autorja është shefe e zyrës ndërlidhëse suedeze në Kosovë).

FAQE 058

lidhin burrërinë me dhunën duhet të sfidohen në nivelin ndërkombëtar dhe në atë vendor.⁹³ Më tej Ann Sofie, shton se: "Lidhja në mes burrave dhe armëve nuk është rezultat biologjik drejtë të qenit burrë. Sidoqoftë, burrat dhe gratë në shumicën e kulturave e perceptojnë dhunën dhe posedimin e armës si pjesë përbërëse të burrërisë."⁹⁴

Lidhshmëria në mes të armëve dhe burrërisë, është karakteristike edhe për shoqërinë kosovare. Këtë e pohojnë edhe qëndrimet e respondentëve të të dy gjinive mbi armët, të cilët ishin pjesë e fokus grupit të organizuar nga QKSGJ-ja.

Për gratë, prania e armëve në shtëpi është e panevojshme, sepse ato cilësohen më parë si mjete të rrezikut, sesa të sigurisë personale.

Djalin e kam 18 vjeçar. Një shok i tij dhe fqinjë yni e ka ftuar një ditë në shtëpinë e tij. Më pas që të dy janë ngjitur në tavanin e shtëpisë, ku shoku i ka treguar djalit tim armën e babait të tij. Djali im ishte frikësuar dhe më tregoi për ngjarjen. Unë bisedova pastaj më fqinjin, por ajo kërkoi që të mos e bëj problem këtë gjë.

Grua, e punësuar në sektorin privat (44 vjeçare)

Burrat kanë deklaruar se duke pasur parasysh gjendjen aktuale të sigurisë në Kosovë, mbajtja e armëve në shtëpi është e nevojshme.

Duke u bazuar në situatën në të cilën jemi, zvarritjen e mosdefinimit të statusit të Kosovës që nuk e dimë se si po përfundon, unë e ndiej se është e nevojshme me pas armë.

Burrë, i papunë (22 vjeçar)

Respondentët e të dy gjinive, kanë qëndrim të njëjtë sa i përket pranisë së armëve në shtëpi. Të gjithë pajtohen se në Kosovë ka numër të madh të armëve të vogla dhe të lehta në duar të qytetarëve. Mirëpo, derisa respondentët burra praninë e armëve në duar e qytetarëve e shohin si burim të sigurisë, gratë këtë e shohin më tepër si burim i rrezikut.

"Siguria për mua është perspektivë tjetër nga ajo tradicionale. Definimi i sigurisë për mua është përtej kuptimit tradicional, prandaj për mua armët paraqesin pasiguri"⁹⁵.

93 Po aty

94 Po aty

95 Intervistë me Clare Hutchinson

FAQE 059**Përdorimi i armëve të vogla dhe lehta në dhunën në familje**

Duke pasur parasysh faktin që viktima më të shpeshta të dhunës në familje janë gratë⁹⁶, prania e armëve në shtëpi, rritë ndjeshëm rrezikun për jetën e grave.

“Kur dhuna mes partnerëve përfshin përdorimin e armës, rreziku ndaj jetës së gruas rritet në mënyrë drastike. Arma e rritë rrezikun e vdekjes për 12 herë në krahasim me mjetet e tjera të dhunës. Dhuna nëpërmjet armës është më vdekjeprurëse nga të tjerat, sepse gjuajtjet me armë lehtësisht shkaktojnë plagë të rënda, të rrezikshme për jetën dhe për shkak të vetë prania e armës i zvogëlon gjasat e viktimit për të ikur si dhe të të tjerëve që të ndërhyjë e t'i ndihmojnë”⁹⁷

Sipas shënimeve të SHPK-së, në vitin 2004 janë raportuar 1.318 raste të dhunës në familje, ndërsa në vitin 2005 ky numër ka pësuar rritje në 1.370. Përdorimi i armëve të zjarrit është regjistruar në 17 raste të incidenteve të dhunës në familje në vitin 2005 dhe 13 raste në vitin 2006. Në të gjitha këto raste, me një përjashtim, të dyshuar për kryerjen e veprës ishin burra, derisa 81 përqind e viktimave ishin gra.

Të dhënat nga hulumtimi mbi AVL-të tregojnë se në pjesën dërmuese të rasteve janë përdorur armët e zjarrit nga një burrë për të kërcënuar një grua. Vetëm në tri raste armët e zjarrit janë përdorur nga një burrë ndaj një burri tjetër në familje, ndërkaq në tri raste të tjera burri dhe gruaja kanë sulmuar njëri - tjetrin.⁹⁸

Disa forma të dhunës ndaj grave janë të veçanta dhe të kuptuarit e kësaj problematike është hap drejtë intervenimit të efektshëm. Artikulli i Ann Sofie Nilsson, vë në pah se shpeshherë përpjekjet e grave në luftimin e dhunës së shkaktuar nga armët, janë të marginalizuara dhe marrin pak përkrahje. Prandaj, ajo beson se resurset e grave, përfshirë ndërgjegjësimin dhe analizat e tyre mbi këtë çështje, ekspertizën mbi zgjidhjen e konflikteve dhe ndikimin në shtëpi, si dhe votat për pushtet janë vendimtare për ndikimin afatgjatë në zvogëlimin e keqpërdorimit të armëve.

Nga ana tjetër në kontekstin lokal, procesi i kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta do të duhej të përfshinte më shumë perspektivën gjinore. Përfshirja e kësaj perspektive në procesin e kontrollimit të armëve të vogla dhe të lehta, do të kontribuonte në krijimin dhe ruajtjen e një paqeje të qëndrueshme, që njëherësh është edhe komponent i rëndësishëm i Rezolutës 1325.

⁹⁶ Shih kapitullin “Dhuna në Familje”

⁹⁷ Po aty

⁹⁸ FIQ “Hulumtimi mbi Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL) në Kosovë, faqe 27.

FAQE 060

Infrastruktura Ligjore

Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2003/25 mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës në nenin 328 ka paraparë dispozitat ndëshkuese për mbajtjen në pronësi ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Sipas këtij neni: "Kushdo që përdor apo vringëllon armët me frikësim, kërcënim ose në ndonjë mënyrë tjetër të paautorizuar apo urdhëron personin tjetër të veprojë në mënyrë të njëjtë dënohet me gjobë deri në 10.000 euro ose me burgim prej një deri në dhjetë vjet". Kjo rregullore parasheh edhe gjobë deri në 7.500 euro ose 1-8 vite burgim për të gjithë personat që mbajnë në pronësi, kontrollojnë, posedojnë ose përdorin armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve.

Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni përfshinë një sasi të madhe armësh, kryesi dënohet me burgim prej 1-10 vite.

Gjithashtu, Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2001/7 për Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë, parasheh kushtet dhe procedurat për lëshimin e lejeve për armëmbajtje.

Sipas nenit 2 të kësaj Rregulloreje, Policia e UNMIK-ut, si organ i vetëm përgjegjës për autorizimin e mbajtjes së armëve në Kosovë, është përgjegjëse për lëshimin e lejeve për armëmbajtje, me përjashtim të armëve të autorizuara nga KFOR-i.

Komisari i Policisë së UNMIK-ut nxjerrë udhëzime administrative dhe procedura standarde të punës për lëshimin e lejeve për armëmbajtje, ku përcaktohen kushtet dhe rrethanat që vlejné për to, duke përfshirë këtu edhe procedurat dhe kërkesat për përdorimin e tyre.

Një person vetëm ligjërisht mund të posedojë, kontrollojë apo ta përdorë armën për të cilën i është lëshuar leja për armëmbajtje. Leja për armëmbajtje i lëshohet vetëm personit të rrezikuar për vetëmbrojtje apo truprojave personale të tij apo të saj, të regjistruar dhe të aprovuar zyrtarisht vetëm për mbrojtjen e një personi të tillë të rrezikuar apo të kërcënuar nga përdorimi i forcës vdekjeprurëse.

FAQE 061**SIGURIA E GRAVE DHE BURRAVE NË BURGJET E KOSOVËS**

Misioni i Shërbimit Korrektues të Kosovës, në bashkëpunim me të gjithë partnerët e Drejtësisë Penale dhe në përshtatshmëri me ligjet e aplikueshme në Kosovë synon të rehabilitojë dhe risocializojë të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën dhe religjionin si dhe të siguroj ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë. Shërbimi Korrektues i Kosovës⁹⁹ është themeluar më 5 nëntor të vitit 1999 fillimisht me hapjen e një qendre të paraburgimit në Prizren.

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në Shërbimin Korrektues të Kosovës, 83 përqind janë burra dhe 17 përqind gra.

“Me rregulloren 2006/26 ne na janë kthyer kompetencat nëpër burgje, por kompetencat faktike janë kthyer në shtatorin e vitit 2006. Sot, ne menaxhojmë Qendrën Korrektuese në Lypjan, burgun me siguri të lartë të Dubravës dhe Qendrat e paraburgimit nëpër regjione, me përjashtim të pavijonit nr. 1 në Dubravë, ku janë të burgosurit të UÇK-së, i cili ende menaxhohet nga UNMIK-u”, thotë ministri Jonuz Salihaj¹⁰⁰

Për Xhevat Mexhuanin, komisar i Shërbimit Korrektues të Kosovës, elementet që e përbëjnë sigurinë e të burgosurve janë: siguria fizike, siguria procedurale dhe siguria dinamike. Sipas tij, me siguri fizike nënkuptohen: rrethojat dhe grilat e burgjeve, që i ka secili burg ne botë. Siguria procedurale është ai element i sigurisë që i ka të gjitha standardet e parapara me ligj, që garanton një jetë të qetë dhe të sigurt për të burgosurin. Ndërkaq, siguria dinamike, nënkupton afërsinë e stafit me të burgosurit në mënyrë që ata të përjetojnë më lehtë sfidat që i presin gjatë vuajtjes së dënimit në burg.¹⁰¹

Behxhet Shala, drejtor ekzekutiv në KMLDNJ, thotë se “gjendja e përgjithshme e burgjeve në Kosovë nuk është në përputhje me standardet e parapara, ndonëse është më e mirë sesa më parë”¹⁰².

Të njëjtën gjë e pohon edhe Xhevat Mexhuani, i cili pranon se në të gjitha burgjet, shtëpitë korrektuese, ndëshkuese dhe burgjet e qarkut duhet përmirësuar kushtet fizike.

Çështja e mbipopullimit në burgje ka qenë njëra nga çështjet kryesore, të

⁹⁹ Institucionet korrektuese janë: Burgu i sigurisë së lartë në Dubravë me një aneks të tipit gjysmë të hapur; Qendra Korrektuese Lipjan (tipi gjysmë i hapur); Qendrat e paraburgimit (Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren dhe Lipjan) dhe Spitali në burgun e Dubravës.

¹⁰⁰ Kosova Press, 4 qershor 2007 Intervistë me Jonuz Salihaj “Ata që kanë përdorë forcë joprofesionale gjatë 10 shkurtit duhet pajtë të përgjigjen”.

¹⁰¹ Intervistë me Xhevat Mexhuanin, Komisar i Shërbimit Korrektues të Kosovës. 09.07.2007. Prishtinë


¹⁰² Intervistë me Behxhet Shalën

FAQE 062

cilën Ombudspersoni e ka ngritur në departamentin e Drejtësisë. "Qelitë në burgun e Dubravës dhe hapësirat tjera ku janë të vendosur të burgosurit që janë duke e mbajtur dënimin janë të pamjaftueshme dhe nuk janë në përputhje me standarde ndërkombëtare"¹⁰³, ka vënë në pah Hilmi Jashari.

Për të parë nga afër se sa respektohen të drejtat e të burgosurve, brenda burgjeve, Institucioni i Ombudspersonit në Kosovës, ka vendosur kutitë e ankesave, në të cilat të burgosurit mund të shprehin pakënaqësitë e tyre. Në bazë të inspektimeve dhe ankesave, Ombudspersoni bënë rekomandime konkrete. Sipas Hilmi Jasharit, ushtrues detyre i Ombudspersonit në Kosovë, këto rekomandime në të shumtën e rasteve përfillen. Disa nga rekomandimet konkrete kanë qenë: përmirësimi i kushteve higjienike, çështja e instalimit të ventilatorëve nëpër dhoma të qelive etj. Për ta mbikëqyrur gjendjen e të burgosurve Ombudspersoni rregullisht dërgon nga dy përfaqësues të vet në burgun e Lypjanit, të cilët në afatin kohorë prej dy javësh vizitojnë, intervistojnë edhe marrin shkresa dhe ankesa."¹⁰⁴

Grafikoni 10: Paraqitja e të burgosurve sipas përkatësisë etnike
Burimi: Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues i Kosovës 1999-2007



Qendra Korrektuese në Lypjan, është e vetmja Qendër që ka gra të burgosura, të paraburgosura dhe të mitura, pohon Ilir Kelmendi, zëvendës drejtor

¹⁰³ Intervistë me Hilmi Jasharin u.d. Ombudspersoni i Kosovës. 25.05.2007. Prishtinë

¹⁰⁴ Intervistë me Hilmi Jasharin

FAQE 063

në këtë Qendër. "Për të gjitha këto kategori duhet kujdesur që të jenë të ndara dhe t'i kenë të drejtat të cilat u takojnë me ligj"¹⁰⁵, sqaron Kelmendi. Sipas tij në një dhomë janë të vendosura nga 2 gra, ndërkohë që kriterin e përzgjedhjes së tyre e bënë ekipi mbikëqyrës. Po ashtu, në këtë burg ka edhe të burgosura të nacionaliteteve tjera.

Sa i përket kategorizimit të burgosurve nëpër dhoma, Kelmendi thotë se zakonisht nuk lejohet që vrasësi me vrasës të jenë në të njëjtën dhomë. Ai tregon se pavijoni i pranimit ku personat e dënuar mbahen 30 ditë lehtëson punën tyre, dhe u mundëson të njohin personat e arrestuar.

Në burgun e Lypjanit aktualisht janë të vendosura 31 gra, 18 të dënuara dhe 13 të paraburgosura.

Përkundër deklaramëve të drejtuesve të Qendrës Korrektuese në Lypjan, se të burgosurit janë të ndarë, KMLDNJ-ja ka vërejtur se ka pasur raste të grave dhe të vajzave të mitura në Lypjan që janë mbajtur afër burrave që kanë qenë të dënuar për krime më të vogla.¹⁰⁶

Në burgun e Dubravës funksionon shkolla me emrin "Rudina". Në vitin shkollor 2006/2007 në të janë regjistruar 120 të burgosur në të gjitha drejtimit. Edhe në Qendrën Korrektuese të Lypjanit funksionon shkolla për të miturit. "Është shkollë obligative për të miturit, kemi raste kur tek ne vijnë analfabetë dhe duhet të merremi me ta prej fillimit"¹⁰⁷, ka bërë të ditur Ilir Kelmendi. Sipas tij, në vitin shkollor 2006/2007 kanë vijuar mësimet 35 nxënës. Ka pasur raste kur në këtë shkollë kanë vijuar mësimet të mitur analfabet.

Më tej Kelmendi ka shtuar se ka mungesë të kuadrit për këtë kategori, janë vetëm tre profesorë, të cilët mbajnë tri lëndë.¹⁰⁸

Të burgosurit kanë mundësi të ndjekin kurse të ndryshme, të cilat kanë për qëllim aftësimin e tyre për ndonjë lëmi të caktuar. Mundësia për të kryer kurse brenda hapësirës së burgut është e barabartë për të dy gjinitë. Gratë në këtë qendër korrektuese mund të kryejnë kursin e rrobaqepësisë, floktarisë, pastiqerisë etj. Përveç këtyre atyre u mundësohen të merren edhe me veprimtari artizanale.

Në ora 7 të mëngjesit zgjohem dhe shkoj në punë, në kuzhinë ku pastroj enë. Orari i punës më zgjatë deri në ora 13 e 30 dhe pastaj kthehem në pavijon. E burgosur në Qendrën Korrektuese të Lypjanit¹⁰⁹

¹⁰⁵ Intervistë me Ilir Kelmendin, zv. Drejtor në Qendrën Korrektuese në Lypjan. 19.07.2007

¹⁰⁶ Raporti i Qeverisë së SHBA-ve për respektimin e të drejtave të njeriut në botë për vitin 2005, pjesa për Kosovën.

¹⁰⁷ Intervistë me Ilir Kelmendin

¹⁰⁸ Intervistë me Ilir Kelmendin

¹⁰⁹ Intervistë me një të burgosur në Qendrën Korrektuese të Lypjanit. 19.07.2007, ora 14:05. Lypjan.

FAQE 064

Problem tjetër me të cilin ballafaqohen gratë e burgosura është edhe çështja e kontaktit me të afërmit e tyre. Një e burgosur e intervistuar, tregon se çdo dy javë ato kanë të drejtë nga një orë vizitë nga familjarët e tyre. Megjithatë sipas saj këto vizita nuk u mjaftojnë¹¹⁰

Si mjet tjetër të kontaktit me të afërmit e tyre "të burgosurat kanë të drejtë të shfrytëzojnë telefonin 2 herë në javë nga dhjetë minuta."¹¹¹

Xhevat Mexhuani thekson se: "legjislacioni e parasheh që i burgosuri së paku në tre muaj nga 3 orë t'i kalojë me familjen së bashku në një ambient të veçantë". Mirëpo, të burgosurit janë të privuar nga një e drejtë e garantuar me konventat evropiane – e drejta për të patur marrëdhënie seksuale me bashkëshorten\bashkëshortin. "Ne respektojmë ligjin, por edhe në bazë të amendamenteve, të cilat së shpejti do të miratohen në Kuvend, do të fillojmë së aplikuari me këtë të drejtë, sepse këtë e garantojnë konventat ndërkombëtare", sqaron Xhevat Mexhuani.

Mungesa e dhomave intime në burgun e Dubravës, ka shtuar rastet e homoseksualitetit, prostitucionit dhe dhunimeve në mes të burgosurve. Rastet më të reja janë paraqitur në KMDLNJ. Më së rëndi është për të burgosurit që nisin vuajtjen e dënimit aty.¹¹²

"Është e vërtet se në Kosovë është ngritur niveli i alarmimit, ngase ne kemi dëgjuar për këtë dukuri, prandaj ne kemi shkuar, kemi vizituar të burgosurit dhe mund të themi se ka raste të homoseksualitetit dhe dhunimit", ka vënë në pah Behxhet Shala.

Faktori kryesor që stimulon këtë dukuri, sipas KMDLNJ-së, është mungesa e një pavijoni intim për takimet e të burgosurve me, të fejuarat apo gratë e tyre. "Pamundësia e kontaktit me gjininë e kundërt, me të cilët kanë jetuar më herët, domosdoshmërisht ndikon që të paraqiten rastet edhe të homoseksualizmit edhe agresivitetit, të cilat edhe përfundojnë me dhunë mes të burgosurve dhe me detyrim për prostitucion", thotë Behxhet Shala.

Mungesa e dhomave intime është problem në të gjitha burgjet dhe shtëpitë korrektuese të Kosovës, prandaj kërkon adresim urgjent.

Një çështje tjetër, e cila gjithashtu paraqet një nga format diskriminuese për të burgosurat është edhe çështja e lindjeve brenda burgjeve në Kosovë. "Është një e metë e madhe e burgjeve, ngaqë kushtet për një grua shtatzënë janë minimale. Sipas standardeve evropiane, burgu duhet të sigurojë kushte

¹¹⁰ Intervistë me një të burgosur grua 19.07.2007 ora 14 : 05

¹¹¹ Po aty

¹¹² Gazeta "Express", 7 qershor 2007, faqe 10. Autor: Nebih Maxhuni

FAQE 065

që fëmija të rritet pranë nënës. Në burgjet evropiane ekzistojnë edhe çerdhet në kuadër të burgjeve¹¹³, ka sqaruar Behxhet Shala nga KMLDNJ-ja. Ndërkaq, Xhevat Mexhuni, pohon se në kuadër të Shërbimit Korrektues është një objekt që quhet “Nëna dhe fëmija”. Ato kanë mundësinë që sipas ligjit, 1 vit e 6 muaj të qëndrojnë së bashku me fëmijën e vet në këtë objekt. Qendra Korrektuese në Lypjan ofron edhe shërbimet shëndetësore. Sipas drejtuesve të QK-së, të burgosurit kanë mundësinë që gjatë gjithë kohës të kërkojnë ndihmën mjekësore. Tri herë në javë QK-në e viziton edhe gjinekologu dhe stomatologu.

“Sa i përket cilësisë së shërbimeve, ajo varet prej mjekëve, se këtu kemi 2 mjekë, një grua dhe një burrë. Nuk është kujdesi kushedi sa i madh, mirëpo mund të shkojmë sa herë që duam”¹¹⁴, thotë një i mitur i burgosur.

Shërbimet mjekësore përbrenda burgjeve udhëhiqen plotësisht nga Departamenti i Drejtësisë, e jo nga Ministria e Shëndetësisë. Të gjithë të burgosurit kanë qasje në mbrojtjen shëndetësore dhe në momentin e futjes në qendrën e paraburgimit ata i nënshtrohen ekzaminimit mjekësor. Nëpër burgje nuk ka vlerësim rutinor apo mbikëqyrje për IST, TBC apo HIV.¹¹⁵

Gjatë intervistave të realizuara me të mitur dhe të burgosura në Qendrën Korrektuese në Lypjan, nuk janë ngritur shqetësime lidhur me ushtrimin e dhunës, qoftë nga personeli, qoftë ndërmjet të burgosurve. Deklaratat e dhëna nga të burgosurit në burgun e Dubravës, tregojnë se aty ushtrohet dhunë, ndërkohë që përgjegjësit e burgjeve e mohojnë një gjë të tillë. Sipas Behxhet Shalës nga KMLDNJ-ja, aktualisht nuk ka ndonjë mekanizëm që garanton mbikëqyrjen e kësaj situate: “Ne e kemi tani një situatë ku të burgosurit thonë se janë rrahur, ndërsa personeli i burgut e mohon këtë gjë, por këtu padyshim që ka keqtrajtim të të burgosurve, por nuk dihet se sa dhe çfarë dhune përdoret ndaj tyre, sepse nuk ka një mekanizëm, i cili do ta bënte monitorimin e përhershëm të burgjeve”¹¹⁶. Kësisoj, KMLDNJ-ja ka raportuar të ketë marrë më se 10 thirrje telefonike në ditë prej të burgosurve dhe familjeve të tyre, të cilët akuzojnë autoritetet e burgut për abuzim dhe izolim të plotë në burg. “Nuk është hera e parë që dhuna ndaj të burgosurve përdoret tani, kjo dhunë është përdorur edhe më herët e pikërisht dhuna dhe trajtimi jo i mirë i të burgosurve ka rezultuar me dhunë, pastaj me rebelimin

¹¹³ Intervistë me Behxhet Shalën

¹¹⁴ Intervistë me një të mitur në Qendrën Korrektuese të Lypjanit. 19.07.2007 ora 14:00.

Lypjan

¹¹⁵ Strategjia e parandalimit të HIV/AIDS-it në Kosovë 2004 – 2008 Komiteti Kosovar për AIDS

¹¹⁶ Pro et Contra gusht 2007. Behxhet Shala, drejtor ekzekutiv në KMLDNJ

FAQE 066

e të burgosurve në vitin 2003, ku ka pasur edhe të vdekur dhe shumë të lënduar”¹¹⁷.

Nga ana tjetër, Sokol Zogaj, Drejtor i burgut të Dubravës, ka mohuar prezencën e dhunës në burgje: “Raste të përdorimit të forcës nuk ka, ka ndoshta ndonjë konflikt verbal, mirëpo ne si staf jemi të interesuar që edhe nëse ka raste individuale ato të minimizohen, mundohemi paraprakisht t’i eliminojnë ato”¹¹⁸.

Ndër problemet që u evidentuan dhe trajtuan në këtë kapitull, vërehet se përkundër përpjekjeve të deritanishme, duhet bërë më shumë në evidentimin dhe trajtimin adekuat të këtyre çështjeve, me qëllim të përmirësimit të kushteve të përgjithshme dhe ngritjes së kujdesit dhe mirëqenies së të burgosurve, shtimit të programeve adekuate që sigurojnë risocializim të sa më të suksesshëm, duke nënkuptuar me këtë edhe ngritjen e nivelit të sigurisë në këto ambiente.

Infrastruktura Ligjore

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (Rregullore e UNMIK-ut, Nr. 2004/46, rregullon çështjen e grave shtatzëna dhe atyre që kanë fëmijë gjatë vuajtjes së dënimit.

Sipas nenit 53, paragrafi 1 dhe 2 i këtij ligji Institucioni korrektues ka për obligim të sigurojë kujdesin shëndetësor për gra shtatzëna. Sipas këtyre paragrafëve, Institucioni Korrektues duhet të bëjë të gjitha përgatitjet që shtatzëna të lindë në spital. Mirëpo, nëse fëmija lind në institucionin korrektues, nuk shënohet në certifikatën e lindjes.

Sipas Nenit 54, pika 1: “Gratë e dënuar që ka fëmijë mund ta mbajë atë derisa i mbush tetëmbëdhjetë muaj dhe pastaj prindërit e fëmijës vendosin nëse kujdestaria e fëmijës i besohet babait, të afërmeve ose personave të tjerë”.

Nëse prindërit nuk pajtohen për kujdestarinë e fëmijës ose nëse marrëveshja e tyre është e dëmshme për fëmijën, gjykata e cila është kompetente sipas vendbanimit ose vendqëndrimit të nënës në kohën kur është dënuar ajo vendos se kujt i besohet fëmija (pika 2 e nenit 54).

Kurse sipas paragrafit 2 të këtij neni, gjykata para së gjithash merr parasysh interesin më të mirë të fëmijës, duke përfshirë mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijës si dhe mirëqenien e tij fizike e shpirtërore.

¹¹⁷ Pro et Contra, gusht 2007. Behxhet Shala, drejtor ekzekutiv në KMLDNJ

¹¹⁸ Pro et Contra, gusht 2007. Sokol Zogaj

FAQE 067

Kur fëmija mbahet në institucionin korrektues me nënën e tij merren masa të posaçme për sigurimin e një dhome fëmijësh me persona të kualifikuar, në të cilën vendoset fëmija kur nuk është nën kujdesin e nënës së tij.

Organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore nxjerrë urdhëresë për sigurimin e kujdesit të nënave dhe fëmijëve në institucionin korrektues.(paragrafi 3, 4 dhe 5 i nenit 54). Kësisoj, sipas nenit 81 "gruaja e dënuar ka të drejtë të mos punojë për shkak të shtatzënësisë, lindjes dhe amësisë, në pajtim me dispozitat e përgjithshme të punës".

Gjithashtu ky ligj në nenin 19 paragrafi 2, 3 dhe 4 parasheh edhe arsyet dhe kohëzgjatjen e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit për gratë shtatzëna dhe që kanë fëmijë.

FAQE 068

ARSIMI DHE SIGURIA

Arsimi dhe siguria janë ndër faktorët kryesor që ndikojnë në kualitetin e jetës së grave dhe burrave. Studimet e shumta të kësaj fushe, tregojnë se niveli i arsimimit, qasja dhe mundësitë e barabarta të gjinive, determinojnë në një masë të madhe nivelin e sigurisë si dhe zhvillimin socio – ekonomik të shoqërisë në përgjithësi.

Në të shumtën e rasteve, këto çështje ndikojnë tek gratë dhe vajzat në Kosovë, sidomos në viset rurale, pasi që shumë shpesh ato nuk e vazhdojnë shkollimin për shkak të largësisë së vendbanimeve nga shkolla, bindjes se rrugëtimi mund të jetë i pasigurt, kushteve të vështira ekonomike, etj.

Sipas Arbena Kuriut, zyrtare për mbrojtjen e fëmijëve në UNICEF, arsimimi i barabartë i gjinive krijon edhe gjysmën e shoqërisë ekonomikisht aktive. "Të gjitha studimet tregojnë se në vendet ku është arritur zhvillimi ekonomik, faktor kryesor ka qenë emancipimi i grave"¹¹⁹. Për t'u arritur ky emancipim natyrisht që është e nevojshme që gruaja të jetë sa më e përfshirë në procesin e arsimimit.

"Edukimi, po ashtu mund të luaj një rol kyç në përmirësimin e statusit të grave dhe dukshëm do të shtonte të ardhurat në familje, do të reduktonte sëmundjet dhe do të ulte mortalitetin e grave dhe fëmijëve."¹²⁰

Zijadin Gashi, inspektor rajonal në MASHT, arsimin dhe sigurinë i sheh në një lidhje të ngushtë. "Arsimi i gjinive nënkupton krijimin e sigurisë, afrimin dhe respektimin e gjinive në shkollë. Sa më efektiv që të jetë arsimi atëherë edhe siguria e gjinive do jetë më e madhe"¹²¹. Sipas tij, një edukim jo i barabartë ndërmjet gjinive krijon mundësi për pasiguri të përgjithshme. "Edukimi jo i barabartë jo vetëm në mes gjinive, por edhe në mes të rajoneve të ndryshme ndikon në pasigurinë e individëve dhe gjithnjë duhet të mendohet në edukimin e barabartë si të gjinive, ashtu edhe të rajoneve dhe krijimin e kushteve për një edukim normal"¹²²

Në Kosovë, ka pak raporte dhe të dhëna statistikore për numrin dhe shkaqet e sakta të nivelit të analfabetizmit tek gratë dhe vajzat. Përqindja e analfabetizmit që paraqitet në raportet e ndryshme që trajtojnë këtë problematikë, shpeshherë nuk është konsistente, kryesisht për shkak të mungesës së regjistrimit civil në Kosovë. Sidoqoftë, analfabetizmi duket se ka përmasa shqetësuese për shoqërinë kosovare. Luljeta Vuniqi, drejtoreshë ekzekutive në Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, ka bindjen se për ta ulur shkallën e anal-

119 Intervistë me Arbena Kuriun, zyrtare e projektit për mbrojtjen e fëmijëve. UNICEF, 20.07.2007. Prishtinë

120 <http://www.fao.org/Gender/en/educ-e.htm> "Edukimi, shtrirja dhe komunikimi". Marrë nga interneti më 14.07.2007

121 Intervistë me Zijadin Gashin, inspektor rajonal në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 05.07.2007. Prishtinë

122 Intervistë me Zijadin Gashin

FAQE 069

fabetizmit, duhet bërë më shumë në shkollimin e grave dhe vajzave. "Edhe pse janë bërë përpjekje të konsiderueshme nga ana e organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare për ta ulur nivelin e analfabetizmit në Kosovë, arsimimi i grave dhe vajzave mbetet çështje së cilës duhet kushtuar vëmendje të posaçme."¹²³

Një raport i UNICEF-it, i cili citon një studim të kryer nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe Qendra për Arsim e Kosovës, nxjerrë në pah se në zonat rurale shkalla analfabetizmit ndër gra dhe vajza është 40 përqind, prej të cilave 14.8 përqind janë krejtësisht analfabete (që nuk dinë shkrim-lexim), ndërkaq 12.5 përqind me aftësi të pjesshme në shkrim-lexim. Megjithatë, më shqetësues është fakti se shkalla e analfabetizmit për vajzat e moshave 16-19 vjeçare është më e lartë sesa për të gjitha grupmoshat tjera. Kjo ka ardhur si pasojë e mosvijimit të shkollimit paralel gjatë viteve të 90-ta¹²⁴.

Analfabetizmi ndër gratë dhe vajzat shqiptare në Kosovë kap shifrën 9 përqind dhe është tri herë më e lartë sesa tek burrat dhe djemtë shqiptarë¹²⁵. Sipas "Raportit të Zhvillimit Njerëzor të Kosovës", përqindja e analfabetizmit ndër të rriturit në përgjithësi është më e ulët tek burrat, krahasuar me përqindjen e grave kosovare. Të njëjtën gjë e argumenton edhe raporti "Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme në Kosovë". Sipas raportit të zyrës për çështje gjinore të UNMIK-ut "përqindja e grave pa asnjë formë arsimit është (6.6 përqind) – dy herë më e lartë sesa e burrave (3.1 përqind)"¹²⁶.

Përqindjet e analfabetizmit të gratë në Kosovë, nga më e ulëta tek më e larta janë: për serbët 4 përqind, për shqiptarët 9 përqind, për grupet e tjera etnike 11 përqind dhe për gratë e komunitetit RAE, 25 përqind.¹²⁷

Afërdita Jaha, zyrtare për edukim joformal në Zyrën Rajonale të Arsimit, thekson se projektet e edukimit joformal kanë për qëllim zbutjen e shkallës së analfabetizmit tek gratë dhe burrat. Projekti shkrim-lexim bazik për gratë dhe vajzat zbatohet prej viti 2001.¹²⁸

Braktisja e shkollimit është po ashtu një dukuri tjetër shqetësuese, e cila kërcënon sigurinë e individëve.

Një numër i konsiderueshëm i nxënësve të komunës së Skenderajt, për shkak të kushteve të rënda ekonomike po detyrohen të ndërpresin shkollimin. Numri i saktë i këtyre nxënësve nuk dihet, mirëpo, sipas drejtuesve të arsimit komunal, ai po rritet në vazhdimësi¹²⁹

¹²³ QKSGJ "Auditimi i Çështjeve Gjinore në Sistemin Arsimor", faqe 4, Prishtinë, 2007

¹²⁴ Analizë e gjendjes së fëmijëve dhe të grave në Kosovë. UNICEF. Shkurt 2004. faqe 49

¹²⁵ Raporti i Zhvillimit Njerëzor: Ngritja e Qytetarit: Sfidat dhe Mundësitë. UNDP. Kosovë. 2004. faqe 30

¹²⁶ Raport: "Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme në Kosovë", UNDP, Kosovë 2006, faqe 81

¹²⁷ Zëri i Grave, raport nga (KWN, KWI, UNICEF, UNIFEM, UNDP, UNFPA, WHO, UNHCR), Prishtinë (2004) faqe 18

¹²⁸ Intervistë me Afërdita Jahën, zyrtare për Arsim Joformal në Zyren Rajonale të Arsimit, Prishtinë, 06.06.2007

¹²⁹ Express, 16 janar 2007. Jeton Rushiti, faqe 9

FAQE 070

Sipas Xhavit Ismajlit, zëvendës drejtor i Shkollës së Mesme Teknike "Anton Çeta" në Skenderaj, kjo është një dukuri shqetësuese, meqë ndër nxënësit që kanë braktisur shkollimin ka edhe të tillë që kanë treguar sukses mjaft të mirë. "Kemi një rast kur prindërit me përgatitje superiore nuk kanë arritur të punësohen dhe si rrjedhojë, përballen me kushte të vështira ekonomike. Ata janë të detyruar që nga tre fëmijët që kanë në shkollim të mesëm, njërin nga ta ndalin në shtëpi, ndonëse ishte nxënës shumë i mirë".¹³⁰

Veterania e arsimit, Naxhije Buçinca, mendon se ndërprerja e shkollimit të shumë vajza pas klasës së parë apo të dytë ka bërë që ato vajza të shndërrohen në analfabete. "Sipas analizave që kemi bërë, kemi vërejtur se ato vajza, të cilat e kanë ndërprerë shkollimin pas klasës së parë apo të dytë kanë qenë shumë të pasigurta dhe thjeshtë edhe atë që e kanë ditur nuk kanë pasur siguri ta thonë. E drejta për arsim zakonisht i takon fëmijës djalë, ndërkaq vajza mbetet e dyta".¹³¹

Për të njëjtën çështje, raporti i Entit të Statistikës së Kosovës, "Gratë dhe burrat në Kosovë", vë në pah se djemtë kanë gjasa më të mëdha se vajzat për të ndjekur shkollimin themelor ose atë universitar. "Diferenca në mes të gjinive rritet krahas nivelit të shkollimit. Në grup moshat 5-14 vjeç, djemtë gëzojnë përparësi ndaj vajzave, por diferencat nuk janë të mëdha. Në grupmoshën 15-19 vjeç, djemtë kanë avantazh prej 17 përqind krahasuar me vajzat. Ndërsa, në grup moshën 25-29 vjeç përparësia e burrave krahasuar me gratë është shumë më e madhe".¹³²

Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, braktisja e shkollës është më e lartë në fund të klasës së tetë, sidomos pas zgjatjes së arsimit fillor edhe për një vit. Kjo ndodh për shkak të mungesës së hapësirës shkollore në disa lokacione, në veçanti në vendet rurale, mësimi organizohet në objekte të shkollave të mesme, kështu që nxënësit duhet të udhëtojnë me kilometra për të vijuar klasën e nëntë. Kjo gjithashtu ka bërë që një numër i vajzave të ndërpresin shkollimin për shkak të kushteve të vështira ekonomike, sociale, mungesës së transportit, mungesës së sigurisë.¹³³

Agim Bërdynaj, drejtor i Departamentit të arsimit parauniversitar, mendon se dukuria e braktisjes së shkollimit nuk është edhe aq shqetësuese. Këtë e arsyeton me mungesën e të dhënave të sakta si dhe mungesën e regjistrimit të

¹³⁰ Po aty

¹³¹ Intervistë me Naxhije Buçincën (udhëheqëse e organizatës "Veteranët e Arsimit), BBC. Marrë nga interneti <http://www.bbc.co.uk/albanian/021121125623.shtml>.

¹³² Enti i Statistikës së Kosovës, raport, "Gratë dhe burrat në Kosovë", Prishtinë, shkurt 2007, faqe.28

¹³³ Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë, UNICEF, MASHT, Nëntor, 2004, faqe 3 - 4.

FAQE 071

popullsisë: "Kjo është si rezultat i mosfunksionimit të një mekanizmi të të dhënave, dhe ne jemi duke u munduar ta përsosim përmes menaxhimit të të dhënave në arsim. Në anën tjetër, nuk kemi regjistrim të popullatës dhe siç po e shihni janë shumë faktorë që ndikojnë që këto të dhëna të mos jenë të sakta"¹³⁴

Me braktisjen e shkollës nga djemtë lidhet ngushtë puna e fëmijëve, ku për arsye ekonomike ata zgjedhin të punojnë për t'i kontribuar buxhetit të familjes së tyre¹³⁵

Sipas raportit "Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë", vlerësohet se prej atyre që regjistrohen në klasën e parë, deri në klasën e tetë, shkollën e braktisin afër 20 përqind të nxënësve. Prej tyre, shifrat e vijueshmërisë janë më të ulëta tek vajzat, tek fëmijët e zonave rurale dhe tek pjesëtarët e minoritetit RAE¹³⁶.

Për dallim, nga zyrtarët e MASHT-it, të cilët dukurinë e braktisjes së shkollimit e arsyejnë me mungesën e një mekanizmi për evidentimin e rasteve, Halim Hyseni nga Qendra për Edukim e Kosovës, thekson se studimet, të cilat i ka zhvilluar Qendra, tregojnë se pozita e vajzave është shumë më e afektuar dhe se vajzat më shumë e braktisin shkollimin.¹³⁷

Edhe inspektori rajonal i arsimit, Zijadin Gashi pohon të ketë mungesë të të dhënave të sakta për rastet e braktisjes së shkollimit: "Është për tu çuditur që drejtoritë komunale nuk mbajnë shënime për këto".

Vetëm 74 përqind e fëmijëve regjistrohen në shkolla të mesme pasi e përfundojnë shkollën fillore. Duke marrë parasysh se Kosova ka popullatën më të re në Evropë, fëmijët që nuk mbarojnë shkollën e mesme, janë potencial për probleme, potencial për të mbetur në rrugë, papunësia është më e madhe.¹³⁸
Arbena Kuriu - UNICEF

¹³⁴ Intervistë me Agim Bërdynaj, zyrtar i arsimit parauniversitar. 04.07.2007. Prishtinë

¹³⁵ Intervistë me Agim Bërdynaj

¹³⁶ Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë, UNICEF, MASHT, Nëntor, 2004, faqe 3 - 4.

¹³⁷ Intervistë me Halim Hysenin udhëheqës i sektorit për zhvillimin e programve të trajnimit në KEC. 09.07.2007. Prishtinë

¹³⁸ Intervistë me Arbena Kuriun, zyrtare e projektit për mbrojtjen e fëmijëve. UNICEF, 20.07.2007. Prishtinë.

FAQE 072

DHUNA NË SHKOLLA DHE DUKURITË TJERA QË RREZIKOJNË SIGURINË E NXËNËSVE DHE MËSIMDHËNËSVE

Bazuar në Ligjin për arsim fillor dhe të mesëm, mësimsdhënësit i ndalohet të ushtrorjeh dhunë mbi nxënësit, por edhe obligohet të marrë masat e nevojshme në mënyrë që nxënësit të mos lëndohen ose të bien viktimë e fjalëve apo veprimeve ofenduese.

“Ndëshkimi trupor dhe çdo formë tjetër e ndëshkimit poshtërues është e ndaluar në të gjitha institucionet arsimore, pavarësisht a financohen nga fondet publike apo private”, thuhet pos të tjerash në nenin 4 të këtij ligji.

Ushtrimi i dhunës në shkolla ka marrë përmasa alarmuese dhe konsiderohet si çështje mjaft shqetësuese. Një aspekt tjetër i dhunës, i cili po ashtu po merr përmasa të mëdha, është edhe dhuna në shkolla e shkaktuar nga personat jashtë shkollës dhe pikërisht për këtë, arsye në disa shkolla tashmë ka patrullime të rregullta të policisë.

Çështja e sigurisë është problemi që më së shumti shqetëson nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike “28 Nëntori” në Prishtinë¹³⁹

Një studim i Ministrisë së Arsimit dhe UNICEF-it mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkolla, konstaton se përfundimi më domethënës është që dënimi trupor është ende një praktikë e pranueshme si në shtëpi ashtu edhe në shkolla. Një numër i madh i fëmijëve kanë përjetuar ose kanë qenë të pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës në shkolla.

Sipas këtij studimi, 78 përqind e të anketuarve kanë thënë se personalisht janë keqtrajtuar nga arsimtarët, ndërkaq 17 përqind rrallë janë keqtrajtuar vetëm verbalisht. Diku 44 përqind kanë thënë se janë cilësuar me epitete fyese apo janë përqeshur nga mësimsdhënësit e tyre.

Arsimtari A. R., i cili jep lëndën e artit figurativ në shkollën fillore “Emin Duraku” të Shtimes, është prangosur të premtën, pasi ka përgjakur nxënësin e klasës së shtatë A. S. (13 vjeç).¹⁴⁰

Psikologjia Marie Culaj, thotë se ka shumë nxënëse që i trajton në seanca psikologjike të cilët kanë pësuar nga dhuna në shkollat e Pejës¹⁴¹. Sipas saj,

¹³⁹ Lajm, e hënë 30 prill 2007, faqe 16.

¹⁴⁰ Koha Ditore, e diel 20 maj 2007, “Pranga arsimtarit që ka përgjakur nxënësin” Besnik Krasniqi, faqe 9, Shtime

FAQE 073

shpesh rritja e mosvijueshmërisë së shkollimit nga vajzat ka qenë pasojë e dhunës që kanë ushtruar arsimtarët e tyre.

“Policia para 3 ditësh ka marrë vesh për ngjarjen e rrahjes masive të nxënësve nga mësimdhënësi i tyre në gjimnazin “Bedri Pejani” të Pejës dhe është duke mbledhur fakte për të”¹⁴², ka thënë togeri Avni Gjevukaj

Mirëpo, përveç fenomenit të dhunës dhe rrezikueshmërisë së nxënësve nga dhuna e mësimdhënësve, në shkollat kosovare është prezente edhe dhuna ndaj mësimdhënësve që vije nga nxënësit apo prindërit e tyre. Sipas Hajdar Binakut, drejtor i Shkollës së Mesme Teknike “28 Nëntori” në Prishtinë, dhuna është e shprehur edhe ndaj mësimdhënësve, dhe sipas tij ka raste kur siguria e personelit është e rrezikuar nga nxënësit. “Kjo shprehet me ofendime të ndryshme, sidomos ndaj mësimdhënësve, por ka edhe raste të dhunës fizike, kur nxënësi e ka kapur për flokë mësimdhënësen”, ka sqaruar Binaku. Sipas tij, është krijuar një përshtypje se nxënësi mund të bëjë në shkollë çfarë të dojë: “në të vërtetë edhe ligji e ka ndihmuar një gjë të tillë, meqenëse nuk ka pas rregullore e cila e ndëshkon nxënësin, i cili ka thyer rregullat dhe rendin.”¹⁴³

Njohësit e rrethanave në arsim, Halim Hyseni dhe Zijadin Gashi, vlerësojnë se dhuna verbale ushtrohet kryesisht më shumë ndaj vajzave. Që të dy kanë bindjen se kjo dhunë ushtrohet më shumë te moshat më të reja dhe atë kryesisht në formën verbale. E kundërta sipas tyre ndodh me djemtë, ndaj të cilëve ushtrohet zakonisht dhunë fizike. Një formë tjetër e kërcënimit të sigurtisë së nxënësve në shkolla është edhe ajo që vije nëpërmjet vetë nxënësve. Sipas Arbena Kuriut, statistikant tregojnë për një nivel të lartë të dhunës që ushtrohet edhe në mes të fëmijëve.

Rastet e konflikteve ndërmjet nxënësve të shkollave në Kosovë janë rritur ndjeshëm.

“Dy grupe të rinjsh janë rrahur mes vete, të enjten në mesditë, pranë shkollës së fshatit Qyshk të Pejës, ndërkohë që policia më pas ka arritur të kapë edhe një armë AK-47, që dyshohet të jetë parë, por jo edhe përdorur, në konfliktin ku pos tjerësh ishin të përfshirë edhe nxënës të kësaj shkolle”¹⁴⁴

¹⁴¹ Koha Ditore, e mërkurë, 7 nëntorë 2007, “Profesori rrah nxënësit me rrip, thotë se ishte shaka” Marin Kelmendi, Pejë

¹⁴² Po aty

¹⁴³ Intervistë me Hajdar Binaku, drejtor i shkollës teknike “28 Nëntori”. 27. 07. 2007. Prishtinë

¹⁴⁴ Koha Ditore, e shtunë 20 janar 2007, faqe 17

FAQE 074

Zijadin Gashi mendon se me krijimin e kushteve optimale për një punë normale jo vetëm në shkollë, krijimin e një ambienti të mirë shkollor, krijimin e kushteve të drejtpërdrejta për organizimin e aktiviteteve të lira në shkollë, do të mundësohej eliminimi i kësaj dukurie.

Në hulumtimin "Siguria në shkolla, sfidë për komunitetin", realizuar nga Forumi i Iniciativës Qytetare, Oficeri i SHPK-së në Ferizaj, Rasim Rashiti thotë se patrullimet e rregullta përreth shkollave kanë ulur dukshëm praninë e huliganëve.

Definimi jo i qartë i kompetencave të institucioneve përgjegjëse, ka ndikuar në joefikasitetin e parandalimit të këtyre dukurive në shkollat e Kosovës. Kësisoj, zyrtarët e arsimit të komunës së Prishtinës kanë prezantuar si problem serioz edhe përjashtimin e nxënësve nga shkolla nga ana e drejtorëve. Sipas tyre kjo nuk është punë e drejtorëve, por e Drejtorisë së Arsimit.¹⁴⁵

Hulumtimi "Siguria në shkolla, sfidë për komunitetin", tregon se edhe "Mjedisi shkollor ka qenë njëri ndër problemet kryesore i përmendur nga drejtorët. Infrastruktura dhe siguria, janë faktorët, të cilët kanë më së shumti ndikim në mjedisin shkollor.

Njëra nga format e rrezikimit të sigurisë së nxënësve është edhe mungesa e trotuareve nëpër rrugët që qojnë për në shkollat e tyre. "Në vitet e fundit më se 7 nxënës kanë humbur jetën dhe disa të tjerë kanë mbetur invalidë duke kapërcyer rrugën për në shkollë"¹⁴⁶

Problem tjetër që rezulton nga të dhënat e hulumtimit, është edhe mungesa e një psikologu apo personi adekuat në shkollë, ku nxënësit do t'i adresonin problemet e tyre. Ky problem përmendet nga drejtorët dhe shumica e nxënësve të intervistuar në këtë hulumtim.

Derisa dhuna fizike afekton më shumë djemtë, ndaj vajzave ushtrohet më shumë dhunë verbale. Dhuna në shkolla adresohet nga institucionet vetëm atëherë kur ajo manifestohet në mënyrë brutale, ndërsa forma tjera të dhunës, si ajo verbale, psikologjike, etj nuk trajtohen si problem dhe nuk i kushtohet vëmendje e duhur.

¹⁴⁵ Po aty

¹⁴⁶ Koha Ditore, e martë 23 janar 2007 "Probleme të shumta në shkollat e kryeqytetit" (Zyrtarë komunalë të arsimit takojnë drejtorët e shkollave të Prishtinës)

FAQE 075**EKONOMIA DHE SIGURIA**

Koncepti i sigurisë ekonomike të grave ngërthen në vete një spektër të gjerë të çështjeve. Përveç çështjeve shumë të përfolura siç janë vendet e punës dhe pagat, në situatën ekonomike të grave ndikojnë edhe shumë faktorë tjerë, si: kujdesi shëndetësorë, siguria në punë, kujdesi ndaj fëmijëve, arsimimi dhe trajnimet, mundësitë e barabarta, pronësia, zotërimi i bizneseve, politikat dhe infrastruktura.

Të gjitha këto ndikojnë në shumë aspekte të sigurisë ekonomike të grave dhe janë të ndërvarura. Mungesa e cilësdo prej këtyre aspekteve, nënkupton njëkohësisht mungesën e sigurisë ekonomike.

Për të avancuar sigurinë ekonomike të grave duhet bërë progres në të gjitha çështjet e lartpërmendura. Ky proces kërkon rishqyrtim të prioriteteve dhe politikave, të cilat do të mundësonin eliminimin e barrierave në krijimin e sigurisë ekonomike të grave.

Nëse një grua është e punësuar, ajo e ka sigurinë ekonomike, ka më tepër mbështetje dhe fuqi për të ushtruar ndikim në procesin e vendimmarrjes në familje¹⁴⁷

Nita Luci, antropologe

Raporti i Bankës Botërore mbi Vlerësimin e Varfërisë në Kosovë konstaton se "37 përqind e popullatës klasifikohen si "të varfër", që jetojnë me më pak se 1.42 euro në ditë, ndërsa 15 përqind llogaritet të jenë nën varfëri ekstreme, që jetojnë me më pak se 0.93 euro për ditë"¹⁴⁸

Ky raport në mënyrë të veçantë trajton varfërinë në kuadër të ekonomive familjare të udhëhequra nga burrat, dhe të ekonomive familjare të udhëhequra nga gratë. Raporti thekson se ekonomitë familjare me kryefamiljarë të gjinisë femërore janë shumë më të varfra sesa ato me kryefamiljarë të gjinisë mashkullore. Derisa ekonomitë familjare me kryefamiljarë të gjinisë femërore llogariten të jenë vetëm 4.7 përqind të të gjitha ekonomive familjare në Kosovë, rrezikimi i tyre nga varfëria e skajshme (28.2 përqind) është shumë më e lartë sesa për ekonomitë familjare me kryefamiljarë të gjinisë mashkullore (14.6 përqind). Shfaqja më e madhe e varfërisë te kryefamiljarët gra vie kryesisht për shkak të dallimeve gjinore në burimet e të ardhurave dhe nivelin arsimor¹⁴⁹.


¹⁴⁷ Nita Luci, "Siguria e Kujt", dokumentar, 2005.

¹⁴⁸ Banka Botërore, "Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë", 16 qershor 2005, Prishtinë

¹⁴⁹ Po aty

FAQE 076

Grafikoni 11: Norma e varfërisë ekstreme sipas ekonomive familjare me kryefamiljarë sipas gjinisë (në përqindje)
Burimi: Banka Botërore, 2005



Ilustrues për shkallën e lartë të varfërisë në Kosovë, janë të dhënat nga Enti Statistikor i Kosovës, sipas të cilave në vitin 2006, ishin 42.569 familje, të cilat jetonin nga ndihmat sociale. Kjo shifër sipas statistikave ka trend të rënies, shkak i kontrollit të shtuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me kriteret që duhet plotësuar familjet për të përfituar asistencë sociale.¹⁵⁰ Njëri prej burimeve kryesore të pasigurisë ekonomike është edhe papunësia, e cila rezulton me mungesë të mundësive të barabarta në resurset elementare për jetë. Duke iu referuar “Raportit të Progresit për Kosovë, 2007” del se në fund të vitit 2006, numri i personave të regjistruar si të pa punë është ngritur për 2.4 përqind në krahasim me vitin 2005, ndërkaq ky numër është ngritur edhe më tej në vitin 2007. Numri i grave të papuna arrinë shifrën 47 përqind. Mosekzistenca e të dhënave zyrtare mbi papunësinë e bënë të vështirë analizimin e zhvillimeve të tregut të punës. Mungesa e statistikave ekonomike dhe sociale është veçori kryesore e ekonomisë së Kosovës. Sipas vlerësimit të fuqisë punëtore, papunësia arrinë nivelin 44.9 përqind të fuqisë aktive të punës në vitin 2006. Megjithatë, një numër i madh i të papunëve të regjistruar mund të kenë qasje në

¹⁵⁰ Enti Statistikor i Kosovës.

FAQE 077

ekonominë joformale. Në përgjithësi, pjesërisht për shkak të shkallës së vlerësuar të ekonomisë së hirtë, regjistrimi i të papunëve ende nuk reflekton sistematikisht dinamikën e ekonomisë¹⁵¹.

Mundësitë e punësimit për gratë janë më të vogla. Sipas të dhënave nga Banka Botërore, mundësia për punësim tek gratë kapë shifrën 8.4 përqind, kurse për meshkuj 35.1 përqind. Këtë e determinojnë në masë të madhe disa nga faktorët, siç janë: qasja jo e barabartë në shkollim, braktisja e shkollimit, martesat e hershme etj.

Sipas raportit të UNIFEM-it, arsye të tjera që ndikojnë në vështirësinë e punësimit të grave janë edhe mungesa e reformave strukturore, kërkesa për rikualifikim dhe ristrukturimi i vendeve të punës.

“Gratë më të vjetra se 45 vjeç, të cilat kanë punuar më herët, por që nuk punojnë për momentin, e kanë të vështirë të adaptohen me kërkesat e tregut të ri të punës, për shkak të ndryshimeve strukturore në atë treg¹⁵²”

Divizioni për Aftësi Profesionale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, organizon trajnime profesionale për personat e regjistruar si të papunë në qendrat për punësim. Numri i grave që kanë marrë pjesë në trajnime është në shpërputhje me numrin e burrave. Edhe pse ka një ngritje të përqindjes së numrit të grave pjesëmarrëse në trajnime, prapë se prapë kjo çështje mbetet ende problematike, pasi që numri i grave të papuna dhe të pakualifikuara mbetet ende i lartë, përderisa pjesëmarrja e tyre në trajnime është më e ulët në krahasim me burrat. Kjo problematikë thellohet edhe më

Tabela 3 Punësimi sipas gjinisë

Burimi: Promovimi i punësimit – Raporti i performancës 2005/2006 (Departamenti i Punës dhe Punësimit)

Punësimi	06/2005		06/2006	
	F	M	F	M
Total	1466	3819	1977	5509
(shkalla e punësimit)	1,1 %	2,3%	1,3%	3,2%
Proporcioni	28%	72%	26,4%	73,6%

¹⁵¹ Komisioni i Komuniteteve Europiane, Raporti i Progresit 2007 për Kosovën nën RKSOKB 1244, Bruksel, 06.11.2007

¹⁵² “Pjesëmarrja e gruas në tregun e punës në Kosovë” (Analizë krahasuese dhe hulumtim empirik), autorë: Justina Shiroka- Pula.Kosovë 2006

FAQE 078

shumë veçanërisht kur merren parasysh vështirësitë me të cilat përballen gratë e "pakualifikuara" sa i përket riintegrit në tregun e punës.¹⁵³

Punësimi sipas sektorëve, tregon se gratë janë të përqendruara në sektorin publik me 42.4 përqind, përdërisa burrat kryesisht janë të angazhuar në sektorin privat me 54.3 përqind.

Ligji Për Barazi Gjimore në nenin 12.1 parasheh obligimin e sigurimit të të drejtave dhe mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, si dhe në institucionet ligjvënëse dhe ekzekutive në sektorin e punës dhe të punësimit.

"Në Ligjin themelor të punës në Kosovë, inspektori i punës siguron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe të dispozitave të tjera përkatëse të ligjit në fuqi, që kanë të bëjnë me kushtet në vendin e punës, me orarin e punës, pagën, sigurinë dhe me shëndetin".¹⁵⁴

Raporti i Qendrës Kosovare për Studime Gjimore, "Monitorimi i mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në Kosovë" vë në spikamë se dallimi në paga ndërmjet grave dhe burrave ligjërisht nuk ekziston në Kosovë. Megjithatë, pozita e grave në tregun e punës është e pafavorshme duke pasur parasysh faktin se në Kosovë paga mesatare e grave është më e ulët se e burrave. Njëra prej shumë arsyeve të kësaj pabarazie në paga është se gratë shumë rrallë janë të punësuara në pozita udhëheqëse dhe në fushat përkatëse në kuadër të atyre pozitave.

Në bazë të kësaj del se "dallimi i madh ndërmjet të ardhurave të grave dhe atyre të burrave në Kosovë, është shkaku kryesor pse indeksi i zhvillimit gjinor në Kosovë është relativisht i ulët".¹⁵⁵

Dallimi ndërmjet grave dhe burrave në shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është evident edhe për arsye tjera. "Shumë gra të moshuara e braktisin punën para se të arrijnë kufirin e moshës së punës, ngaqë shumica marrin përgjegjësitë mbi familjen dhe ekonominë familjare, ndaj nuk angazhohen në aktivitetet ekonomike".¹⁵⁶

Pos kësaj, kriteret që përcaktohen në shumicën e konkurseve për vende të lira të punës, janë jofavorizuese për gratë e moshës së mesme.

Edhe nga diskutimet në fokus grup, rezulton se gratë janë të diskriminuara në konkurse për vende të lira të punës. Sipas pjesëmarrëseve, kjo është pasojë edhe e stereotipizimit të profesioneve dhe diskriminimit në baza gjinore dhe moshore.

153 Promovimi i punësimit – Raporti i performancës 2005/2006 (Departamenti i Punës dhe Punësimit)

154 Po aty, faqe 19

155 Qendra Kosovare Për Studime Gjimore "Monitorimi i Mundësive të Barabarta për Gratë dhe Burrat në Kosovë", 2006, faqe 26

156 Gratë dhe Burrat në Kosovë, Enti Statistikor, faqe 29

FAQE 079

“Kërkimi i fotografisë për të konkurruar në një vend pune, ku më shumë nevojitet dija, nuk më duket i arsyeshëm, pasi që në bazë të fotografisë askush nuk mund ta dijë se sa është i dijshtëm konkurruesi”¹⁵⁷
Grua 56 vjeçare, e papunë.

Në vitin 2007, Ministria e Shërbimeve Publike ka nxjerrë një udhëzim administrativ që të sigurojë pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe të burrave, ashtu siç është përcaktuar në nenin 3 (3.1 dhe 3.2) të Ligjit për Barazinë Gjinore dhe i cili ka të bëjë me çështjen e konkurseve.

“Shpallja e parë e konkursit për të gjitha vendet e lira duhet të përmbajë edhe formulimin: Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës. Me qëllim të realizimit të barazisë gjinore në të gjitha institucionet e administratës civile, mirëpritën aplikimet nga gratë e Kosovës”¹⁵⁸.

Të gjitha çështjet e lartpërmendura, ndikojnë që varshmëria ekonomike të jetë dy herë më e lartë te gratë sesa te burrat. Kështu, “77 përqind e grave dhe 33 përqind e burrave jetojnë nga të ardhurat që sigurohen nga ndonjë person tjetër. Vetëm 13 përqind e grave dhe 41 përqind e burrave jetojnë kryesisht prej të ardhurave personale nga puna e tyre.”¹⁵⁹

Aspekt tjetër shumë i rëndësishëm që ndikon në pasigurinë ekonomike të grave është edhe çështja e trashëgimisë pronësore.

“Në rastet kur në një familje të gjithë fëmijët janë vajza, në atë familje shumë lehtë ndahet prona. Por, mjafton që në atë familje të jetë një fëmijë mashkull dhe e tërë pasuria t’i takojë atij”¹⁶⁰

Çështja e trashëgimisë pronësore është e rregulluar me ligj (Ligji për Trashëgiminë i Kosovës, Nr. 2004/26), sipas së cilit të gjithë personat fizik në kushte të njëjta kanë të drejta të barabarta në trashëgimi, pavarësisht nga gjinia e tyre, pa kurrfarë diskriminimi.¹⁶¹

Përkundër kësaj, në praktikë ky ligj nuk duket të jetë i zbatueshëm. Sipas Valbona Salihut, drejtore ekzekutive në shoqatën “NORMA”¹⁶², ligjet e mëparshme të Kosovës, e posaçërisht ato aktuale trajtojnë plotësisht në mënyrë të barabartë personat e të dy gjinive, por fatkeqësisht në realitet, në implementimin e këtyre ligjeve ka dallim.¹⁶³

¹⁵⁷ Fokus Grupi. Grua 44 vjeçare

¹⁵⁸ Qeveria e Kosovës. Ministria e Shërbimeve Publike. Udhëzim Administrativ Nr. 2007/03 MSHP

“Masat për Arrijjen e Barazisë Gjinore në Institucionet e administratës Publike gjatë vitit 2007. faqe 4-8

¹⁵⁹ Qendra Kosovare Për Studime Gjinore (QKSGJ) “Monitorimi i Mundësive të Barabarta për Gratë dhe Burrat në Kosovë”, 2006.

¹⁶⁰ Intervistë me Valbona Salihu, drejtore ekzekutive në shoqatën “Norma”. 12.11.2007. Prishtinë

¹⁶¹ Ligji për Trashëgimi i Kosovës

¹⁶² Shoqata NORMA është shoqatë e juristeve të cilat ofrojnë ndihmë juridike për gratë.

¹⁶³ Intervistë me Valbona Salihu.

FAQE 080

Njëri ndër faktorët kyç që ndikon në moszbatimin praktik të këtij ligji, sipas Salihut është tradita në Kosovë, e cila ende mbizotëron, dhe në të shumtën e rasteve pasurinë e trashëgojnë burrat, kurse femrat heqin dorë kushtimisht, d.m.th. nuk e shfrytëzojnë këtë të drejtë. Kjo përfshinë në vete edhe mosnjohjen e ligjit nga gratë dhe të drejtës së tyre për trashëgimi të barabartë në pronë. Lidhur me këtë, shoqata "Norma" ka organizuar mëse 250 punëtorë kryesisht me gra dhe vajza nëpër viset rurale për vetëdijesimin mbi të drejtat e tyre dhe ligjet. Niveli i sigurisë në ambientet e punës në Kosovë është i ulët. "Punëtorët punojnë në kushte dhe rrethana shumë të vështira dhe të pasigurta, gjithë kjo ndodh për shkak se punohet me një teknologji të vjetëruar, pa përgatitjen e duhur fizike dhe psikike të punëtorëve, ose ndodh që punëtorët janë të pa trajnuar për nivelin që kërkohet. Ka mungesë të njohurisë praktike për kryerjen e punës, nuk ka kontroll shëndetësorë të punëtorëve, detyrë kjo e punëdhënësit."

Siguria në ambientet e punës, garantohet nga Ligji për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës Nr. 2003/19. Kjo duhet të vihet në funksion përmes aktivitetit të punëdhënësit dhe të punëmarrësit¹⁶⁴.

Neni 4 i këtij ligji "Mbrojtja e të Rinjve, Grave dhe Personave me aftësi të Kufizuara", thekson: "Punëmarrësit deri në moshën 18 vjeçare, gratë shtatzëna, personat me aftësi të kufizuara për punë, nuk mund të sistemohen në punë veçanërisht të rënda, punë më të gjatë se orari i plotë i punës dhe në punë të natës". Ligji ndër të tjera obligon çdo punëdhënësi që ka mbi 50 punëtorë, të inkuadrojë punëtorë për siguri në punë.

Sipas Agim Millakut, inspektor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kapaciteti i Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, është i pamjaftueshëm për inspektimin e të gjitha subjekteve sa ekzistojnë në tërë Kosovën¹⁶⁵.

Sa i përket çështjes sesa rrezikohen gjinitë në vendin e punës dhe cila gjini rrezikohet më shumë, Millaku thekson se të dy gjinitë janë të rrezikuara në vendin e punës, varësisht prej natyrës dhe vendit të punës. Për më tepër, Millaku thekson se burrat janë më të rrezikuar p.sh nga puna në miniera, përderisa gratë janë më të rrezikuara kur punojnë në institucionet shëndetësore dhe i nënshtrohen rrezatimit. Edhe grupet e diskutimit të organizuara nga QKSGJ-ja, kanë përmendur pasigurinë në punë, sidomos kur është fjala për aksidentet që ndodhin gjatë procesit të punës.

Ka raste kur punëtorë vdes në vend të punës, familjes i ndalen të ardhurat dhe askush nuk kujdeset më për ta.

Grua 48 vjeçare, e punësuar.

Rastet e tilla vështirësohen edhe më shumë, kryesisht për shkak të mungesës së Fondit për Siguri. Kështu, në rast të lëndimit të punëtorit në vendin e punës, barra më e madhe i bie vet punëtorit, pasi që të gjitha shpenzimet i bartë ai.

¹⁶⁴ Ligji Për Siguri në Punë, mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe e ambientit të Punës.

¹⁶⁵ Intervistë me Agim Millakun, inspektor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. 17.09.2007. Prishtinë

FAQE 081**KUJDESI SHËNDETËSOR DHE SIGURIA**

Tradicionalisht zotëron bindja se shëndeti i gruas përfshinë vetëm çështjet që kanë të bëjnë me lindjet dhe shëndetin reprodaktiv. Sidoqoftë, gjithnjë e më shumë, vërehet se ky koncept përfshinë një gamë të gjerë çështjesh. Shëndeti i gruas është indikator i shumë gjërave në një shoqëri. Së pari dhe më kryesorja, është indikator i pozitës socio-ekonomike të gruas. Është indikator i qasjes që ka gruaja në kujdesin shëndetësor, veçanërisht kujdesin e shëndetit reprodaktiv, përfshirë planifikimin e familjes, arsimimin dhe statusin e ushqyeshmërisë. Po ashtu me të matet shkalla e zhvillimit të një vendi: shëndeti i ulët i nënës është veçori e vendeve më pak të zhvilluara¹⁶⁶. Shëndeti reprodaktiv, planifikimi familjar, kanceri i gjirit, sëmundjet seksualisht të transmetueshme si dhe epidemitë, janë vetëm disa nga çështjet që lidhen me sigurinë e grave dhe vajzave, të cilat janë trajtuar në këtë kapitull.

Vdekshmëria e nënave dhe foshnjave në Kosovë

Nënat dhe foshnjat paraqesin grupet më vulnerable kur flasim për kujdesin shëndetësor. Kujdesi më i madh shëndetësor, ngritja e vetëdijes mbi shëndetin dhe të drejtat reprodiktive, si dhe ofrimi i mundësive për qasje në shërbime më cilësore, janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në shëndetin e nënës dhe foshnjave.

Sipas raportit "Gjendja Perinatale në Kosovë për 2000 – 2006", në vitin 2000 janë raportuar 9 vdekje maternale në 38.907 lindje me fëmijë të gjallë (23.1/100000), përderisa në vitin 2006 janë raportuar 2 vdekje maternale në 28.450 lindje me fëmijë të gjallë (7.0/100000). Këto shifra janë të përafërta me vendet e zhvilluara. Megjithatë, nuk duhet harruar faktin se "vdekjet maternale janë të raportuara vetëm nga institucionet shëndetësore".¹⁶⁷

"Nuk ka ndonjë sistem të besueshëm për të ditur shkaqet e vdekjeve maternale në Kosovë. Megjithatë, disa nga shkaqet e mortalitetit të lartë amnor janë kushtet e rënda ekonomike e politike, në periudhën para dhe gjatë konfliktit, si dhe zhvillimi i dobët institucional, veçanërisht kualiteti i dobët i shërbimeve të kujdesit publik në periudhën e pasluftës."¹⁶⁸ Kësisoj, Kosova prinë me vdekshmërinë perinatale të foshnjave me 23 fëmijë në 1 mijë lindje, që

¹⁶⁶ Raporti bazë i Objektivave Zhvillimore të Mileniumit për Kosovën, MDG, Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, mars 2004

¹⁶⁷ Gjendja Perinatale në Kosovë, për 2000-2006, prill 2007 Prishtinë, faqe 19

¹⁶⁸ Raporti bazë i Objektivave Zhvillimore të Mileniumit për Kosovën, MDG, Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, mars 2004

FAQE 082

vlerësohet si shkalla më e lartë në Evropë.¹⁶⁹

Raporti "Gjendja Perinatale në Kosovë për 2000 – 2006" vë në spikamë disa nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë perinatale si: anomalitë kongjenitale, infeksionet perinatale, traumat në lindje, çrregullimet e shkaktuara si pasojë e komplikimeve gjatë shtatzënisë, gjendja ekonomike dhe sociale, gjinia, statusi familjar, moshë dhe profesia e nënës, numri i madh i lindjeve si dhe cilësia e kujdesit shëndetësor.

Sipas gjinekologes, Teuta Hadri "shkaqet kryesore të vdekshmërisë së foshnjave janë ato ekonomike, sociale, si dhe mentaliteti"¹⁷⁰. Sipas saj, mortaliteti i foshnjeve është më i madh në zonat rurale sesa në ato urbane dhe vjen si rezultat i nivelit më të ulët të informimit dhe planifikimit familjar të gratë e zonave rurale.

Tabela 4. Vdekja e foshnjave sipas gjinisë dhe moshës
Burimi: ESK, Statistikat Vitale

Vitet	Gjinia	Numri	Perinatale (%)	Neonatale (%)	Postnatale (%)
2002	Vajza	205	60	15	25
	Djem	198	60	10	30
2003	Vajza	265	65	11	24
	Djem	199	61	13	26
2004	Vajza	233	66	10	24
	Djem	182	64	13	23
2005	Vajza	155	66	5	28
	Djem	202	62	8	30

Statistikat tregojnë se numri i vdekshmërisë së foshnjave ka ndryshuar nga viti në vit, duke pësuar rënie dhe ngritje të lehta brenda viteve. Kështu, në vitin 2002, numri i përgjithshëm i foshnjave të vdekura ishte 403, prej tyre 205 vajza dhe 198 djem. Nëse e krahasojmë me vitin 2003, ky numër është

¹⁶⁹ Koha Ditore, e premte 21 shtator 2007. "Kosova prin me vdekshmëri të foshnjave në Evropë". Autori: Faton Ismajli

¹⁷⁰ Intervistë me Teuta Hadrin, gjinekologe. 04.09.2007. Prishtinë

FAQE 083

rritur në 464 gjithsej, prej tyre 265 vajza dhe 199 djem, duke shënuar kështu një rënie të lehtë të vdekshmërisë së foshnjave në vitin 2004, ku kishte gjithsej 415 vdekje, prej të cilave 233 vajza dhe 182 djem. Ndërsa, viti 2005 shënon prapë rënie të numrit të përgjithshëm të vdekjeve në gjithsej 357, prej të cilave 155 vajza dhe 202 djem.

Nga numri i përgjithshëm i vdekjeve të foshnjave, gjatë këtyre katër viteve, po të bëjmë krahasime në aspektin gjinor, vërehet se foshnjat e gjinisë femërore prijnë me numër më të lartë të vdekjeve.

Visare Mujko – Nimani, nga UNFPA, mendon se duhet t'i kushtohet përkujdesje më e madhe shëndetit amnor dhe atij të foshnjave duke pasur parasysh se shkalla e vdekshmërisë së nënave dhe foshnjave në Kosovë është shumë e lartë.¹⁷¹

Kur flasim për resurset njerëzore, të dhënat nga raporti i lartpërmendur, tregojnë se numri i obstetërve dhe pediatërve i tejkalon kërkesat, mirëpo shpërndarja e tyre është joadekuatë, gjë që ndikon në kapacitetin dhe funksionimin e disa materniteteve si dhe në cilësinë e shërbimeve shëndetësore. P.sh. ka raste kur në disa maternitete nuk punojnë gjinekologët-obstetrit ose numri i tyre është i kufizuar.

Identifikimi i shkaqeve që shpijnë deri te ky numër i lartë i vdekshmërisë së foshnjave, shpërndarja adekuatë e kapaciteteve mjekësore, përmirësimi i kushteve të punës dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve do të luanin rol të rëndësishëm në trajtimin e kësaj problematike, si dhe në reduktimin e numrit të vdekshmërisë së foshnjave.

Gjendja aktuale e vdekshmërisë së nënave dhe foshnjave, mbetet çështje mjaft shqetësuese dhe kërkon intensifikim të veprimeve institucionale, të cilat do të ndikonin në reduktimin e nivelit të vdekshmëri së nënave dhe foshnjave.

Ndërprerja e shtatzënisë (Aborti)

“Ka raste kur vijnë nëna dhe kërkojnë ndërprerjen e shtatzënisë për shkak të gjinisë së foshnjës, pasi e konstatojnë atë nëpërmjet ultrazërit.”¹⁷²

Mungesa e informacionit dhe vetëdija e ulët për planifikim familjar, bartin në vete një listë të gjatë të pasojave serioze për shëndetin e gruas si p.sh: abortet e pasigurta që rezultojnë nga shtatzënitë e padëshiruara, shtatzënitë e shpesh-ta, shtatzënitë që rrezikojnë gratë që janë të moshuara ose shumë të reja, etj.

¹⁷¹ Gazeta Express, e diel, 19 gusht 2007. “Shtatzënat e rrezikuara”. Autori: Artan Behrami

¹⁷² Gazeta “Lajm” e hënë 18 qershor 2007. “Vriten Foshnjat femra”. Autori: Alban Selimi

FAQE 084

Sipas Rabihane Demës, shefe e pranimit në repartin e Planifikimit Familjar në Klinikën Obstetrike - Gjinekologjike: "Aborti artificial është ndërprerja e shtatzënisë së padëshiruar, me dëshirë të pacientes dhe me ndërhyrjen e metodave mjekësore. Kjo është një ndër metodat më të rënda dhe më të rrezikshme për planifikimin familjar."¹⁷³

Ambienti fizik, kushtet dhe mjetet me të cilat kryhen abortet, në klinikat publike dhe private duhet të jenë sipas standardeve bashkëkohore në mënyrë që të garantohet një intervenim i sigurt, ngase ato ndikojnë drejtpërsëdrejti në sigurinë shëndetësore të grave. Sallat ku kryhet intervenimi, duhet të jenë nën mbikëqyrje rigoroze, të jenë të pajisura me bombola oksigjeni dhe me instrumente të sterilizuara (p.sh doreza sterile, shiringa sterile për një përdorim etj.). Zef Komoni, kryeinspektor në Inspektoratin për Shëndetësi, në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, tregon se gjatë inspektimeve të institucioneve shëndetësore është konstatuar se personeli shëndetësor në disa klinika qarkullon lirshëm nëpër sallat operative duke mos ndërruar fare rrobat dhe uniformën. Po ashtu është vërejtur se një sasi e konsiderueshme e sterilizatorëve nuk kanë matësin e temperaturës (çka do të thotë se veglat kirurgjike sterilizohen pa kritere dhe jo sipas standardit të përcaktuar).

Megjithë, Komoni e pranon se një monitorim strikt i kësaj ministrie ndaj institucioneve shëndetësore private nuk ka arritur të kryhet:

"Sektori privat ka qenë jo transparent (institucionet kanë punuar pa licencë, pa kushtet minimale të punës, dhe në thyerje të plotë të rregullave të asep-sisë). Në këtë kontekst, ndërhyrjet që kryhen në institucionet private shëndetësore, e sidomos ndërprerja e shtatzënisë paraqesin shqetësimin më të madh për ne."¹⁷⁴

"Gratë kanë perceptime, arsye dhe përvoja të ndryshme lidhur me abortin. Ato përmendin arsytet financiare, (nuk janë në gjendje të rrisin edhe një fëmijë), si arsye kryesore për abort. Përpos çështjeve ekonomike dhe planifikimit familjar, arsye tjetër për abort është edhe preferenca për fëmijë të gjinisë mashkullore (zgjedhja e gjinisë me abort) dhe kompleksi i gjyshes (shtatzëni me fëmijë dhe gjyshe në të njëjtën kohë)"¹⁷⁵

Një ndër arsytet kryesore të abortit është gjinia femërore e foshnjës, e cila mësohet pas ekzaminimit me ultrazë. "Deri para dy dekadave, ndarja e fry-

173 Intervistë me Rabihane Dema, shefe e pranimit në repartin e Planifikimit Familjar në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike (QKUK). 27.08.2007. Prishtinë

174 Intervistë me Zef Komonin, kryeinspektor në Inspektoratin për Shëndetësi, në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, 27.08.2007, Prishtinë

175 INDEX Kosova & UNFPA "Shtatzënia dhe Planifikimi Familjar në Kosovë". Studim Kualitativ

FAQE 085

tit në mashkull dhe femër nuk është marrë parasysh dhe as që është komentuar. Kjo dukuri haset kohëve të fundit, nëse është fryti femër pacientja vije të abortojë, e cila si dukuri është mjaft negative, e që e bënë termin abort edhe dy herë më të rëndë”, shprehet Rabihane Dema.

Shifrat e sakta të aborteve në Kosovë nuk dihen, pasi që një numër i konsiderueshëm i tyre kryhen në klinika private dhe të cilat nuk mbajnë evidencë për këtë gjë.

“Numri i aborteve vetëm në Klinikën Obstetrike - Gjinekologjike të QKU-së, silltet rreth tre deri në katër raste brenda një dite”¹⁷⁶.

Sa i përket numrit të aborteve në Kosovë, gjinekologjia Teuta Hadri, tregon se: “numri i aborteve nuk ka rënë, mirëpo ato nuk raportohen prej klinikave private. Kemi pasur disa statistika në vitin 2002, në 100 lindje janë bërë 4.8 përqind aborte. Kështu që këto janë vetëm shifra që i kanë dhënë klinikat publike, spitalet, ndërsa te ambulancat private askush nuk ka dhënë shifër të aborteve”¹⁷⁷

Çështja e raportimit të ordinancave private për numrin dhe arsyen e aborteve, vazhdon të mbetet e pashqyrtuar. Sipas Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, çështja e mosraportimit nga ana e institucioneve private e vështirëson njohjen më në hollësi të fenomenit të abortit në Kosovë: “Mund të spekulohet me të dhëna në mungesë të një regjistri, nuk ekziston një bazë e të dhënave sa i përket këtyre raportimeve. Derisa ka raportim nga institucionet publike është e qartë se nuk ka raportim nga institucionet private”¹⁷⁸ Se shifrat e abortit nuk raportohen nga klinikat private e pohon edhe Rabihane Dema, udhëheqëse e pranimit në repartin e planifikimit familjar në Klinikën Obstetrike - Gjinekologjike. “Klinikat private e amortizojnë këtë numër sepse ata për shkak të konfidencialitetit nuk mbajnë të dhëna dhe nuk i japin të dhënat edhe nëse i kanë”¹⁷⁹.

Këtë e pranon edhe zyrtari i MSH-së, Zef Komoni, sipas të cilit në përgjithësi gjatë inspektimeve është vërejtur se në institucionet publike dhe private, mungojnë shumë të dhëna për pacientët duke filluar nga të dhënat e përgjithshme e deri te ekspertiza dhe fletëlëshimi¹⁸⁰. Sipas tij aborti ende

¹⁷⁶ Gazeta “Lajm”, e hënë 18 qershor 2007. “Vriten Foshnjat femra”. Autori: Alban Selimi

¹⁷⁷ Intervistë me Teuta Hadrin, gjinekologe. 4.09.2007. Prishtinë

¹⁷⁸ Intervistë me Fatmire Mulhaxha, shefe e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. 30.08.2007. Prishtinë

¹⁷⁹ Intervistë me Rabihane Dema

¹⁸⁰ Intervistë me Zef Komonin.

FAQE 086

paraqitet si çështje për të cilën ekziston zbrastirë ligjore, përkundër miratimit të ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë nr 02L-73 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i cili nuk ende është i paplikueshëm për shkak se pret nënshkrimin e PSSP-së.

Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë¹⁸¹ u garanton të drejtën grave të vendosin lidhur me abortin. Ne nuk jemi prej atyre shteteve që e ndalojnë plotësisht abortin, pavarësisht që ka mendime të ndryshme lidhur me këtë çështje Fatmire Mulhaxha

Qëllimi i ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë është të vendos bazën ligjore për rregullimin e ndërprerjes së shtatzënisë. Me këtë ligj garantohet respektimi i jetës dhe dinjitetit të çdo qenie njerëzore që nga momenti i mbarësimit dhe ky parim nuk shkelet, përveç rasteve të përcaktuara në këtë ligj. Gjithashtu, me këtë ligj rregullohen shërbimet shëndetësore, rrethanat e veçanta të ndërprerjes së shtatzënisë, dhe faza pas ndërprerjes së shtatzënisë.

Sipas këtij ligji: "Çdo femër ka të drejtë në vendimmarrje të informuar për realizimin e të drejtave të saja shëndetësore riprodhuese, pa diskriminim, kanosje dhe dhunë. Çdo femër ka të drejtën e këshillimit dhe informimit lidhur me shtatzënisën dhe ndërprerjen e shtatzënisë" (Neni 4 pika 1 dhe 2).

Me këtë ligj rregullohet edhe çështja e moshës për ndërprerjen e shtatzënisë. Sipas nenit 5: "Çdo shtatzënë e moshës mbi 18 vjeç ka të drejtë që të kërkojë ndërprerjen efektive të shtatzënisë".

Sipas këtij ligji ndërprerja efektive e shtatzënisë mund të bëhet deri në fund të javës së 10-të të shtatzënisë (neni 6). Gjithashtu me këtë ligj sepecifikohet se ndërprerja e shtatzënisë bëhet vetëm në institucionet shëndetësore nga mjekët specialistë obstetër-gjinekologë të licencuar.

Kodi Penal i Kosovës, në nenin 152 ka paraparë dispozitat ndëshkuese për ndërprerjen e palejuar të shtatzënisë. Paragrafi 1 i këtij neni parasheh: "Kushdo që në kundërshtim me dispozitat ligjore mbi ndërprerjen e shtatzënisë dhe me pëlqimin e gruas shtatzënë ndërpret shtatzëninë, fillon ta kryejë ndërprerjen e shtatzënisë ose i ndihmon që ta ndërpresë shtatzëninë, dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet".

Paragrafi 2 thotë: "Kushdo që e ndërpre në fillim ta ndërpresë shtatzëninë

¹⁸¹ Ligji për Ndërprerjen Shtatzënisë është miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datë 13.07.2006 (Ligji Nr. 02/L-73), mirëpo ende nuk është nënshkruar nga PSSP-ja. Ky ligj duhet të harmonizohet edhe me direktivat e BE-së dhe dihet se PSSP-ja në bazë të mandatit të tij ka të drejtën që para shpalljes (nënshkrimit) mund të bëjë ndryshime dhe plotësime të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Edhe ky ligj para hyrjes në fuqi mund të ketë ndryshime.

FAQE 087

pa pëlqimin e gruas shtatzënë dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet". Paragrafi 3: "Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton në lëndim të rëndë trupor, me dëmtim të rëndë të shëndetit ose me vdekje të gruas shtatzënë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose më së paku tre vjet burgim për veprën penale nga paragrafi 2".

Kanceri i Gjirit

Niveli i ulët i informimit, edukimi i pamjaftueshëm shëndetësor, mungesa e specialistëve adekuat të fushës, strategjive, politikave dhe institucioneve shëndetësore, si dhe mungesa e të dhënave statistikore ndikojnë që trajtimi dhe mbijetesja e grave të prekura me kancer të gjirit të jetë e kufizuar në Kosovë. Kanceri i gjirit është sëmundja, e cila në 90 përqind të rasteve shfaqet te gratë. Hulumtimi "Kanceri i Gjirit në Kosovë" nxori në pah se prej 1.017 pacientëve të operuara nga kanceri i gjirit, 1.007 kanë qenë gra¹⁸². Sipas Nafije Latifit, drejtoreshë ekzekutive e Qendrës Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit, mungojnë të dhënat e sakta të numrit të grave, të cilat janë të sëmura nga kanceri i gjirit. "Te ne, vetëm mund të supozohet për numrin e saktë të të sëmurave nga kanceri i gjirit, mirëpo sipas të dhënave në rajon çdo e dhjeta apo e njëmbëdhjeta grua është e prekur nga kjo sëmundje". "Në Kosovë ky numër duhet të jetë i njëjtë apo edhe më i lartë, shkaku i luftës, kushteve të vështira ekonomike, stresit, ushqimit të pakontrolluar etj."¹⁸³ Megjithatë, sipas Dr. Abdyl Krasniqit, ndërmjet periudhës 1999-2004 janë mbledhur statistika të grave të ekzaminuara me kancer në gji. Në këtë periudhë, kanceri i gjirit ishte ndër malignomat më të shpeshta në Kosovë. "Ne kemi bërë një hulumtim dhe kemi parë se prej vitit 1999 e deri në vitin 2004 numri i grave që kanë qenë me simptomat e kancerit në gji është 7.646 raste, ku grup-mosha e tyre kryesisht ka qenë prej 55 e deri 70 vjeç"¹⁸⁴. Luftimin e kancerit të gjirit e pamundëson mospasja e numrit të saktë të të sëmurëve. "Mosnjohjen e numrit të saktë e determinon fakti se secili mjek punon në mënyrën e vet, nuk mbajnë shënime dhe nuk ia dorëzojnë Institutit Kombëtar për Shëndetësi Publike që do t'ia mundësonte krijimin e një sistemi të të dhënave", shprehet Nafije Latifi.

¹⁸² Qendra Kosovare Për Luftimin e Kancerit të Gjirit "Jeta -Vita". Kanceri i Gjirit në Kosovë, faqe 9.

¹⁸³ Intervistë me Nafije Latifin, Drejtore ekzekutive e Qendrës Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit. 23.08.2007. Prishtinë

¹⁸⁴ Koha Ditore e martë 17 prill 2007, faqe 6

FAQE 088

Një mangësi të tillë e pohon edhe zëvendësministri i shëndetësisë Fadil Kryeziu, i cili e pranon se nuk ka angazhim të duhur të institucioneve shëndetësore e as përkrahje materiale: "Pacientët tanë, edhe më tej do të ballafaqohen me këto vështirësi. Ne nuk kemi as sistem sigurimesh shëndetësore, i cili do të siguronte së paku një paketë bazë shërbimesh të kësaj natyre."¹⁸⁵

Përkundër përpjekjeve të shumta të Organizatave Joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare për adresimin e çështjes së kancerit të gjirit në Kosovë, institucionet qeveritare deri më tani nuk kanë treguar gatishmëri dhe interesim që ta trajtojnë këtë problem në mënyrë institucionale.

Institucionet qeveritare nuk kanë bërë asgjë, është absurde që në Ministrinë e Shëndetësisë nuk brengosen për këtë problem. Kemi kërkuar disa herë takim edhe me kryeministrin, mirëpo kemi hasur në vesh të shurdhër, sikurse për çdo problem tjetër shëndetësor.

Nafije Latifi

Shqetësim i përbashkët i të intervistuarve për këtë çështje, përfaqësues të OJQ-ve dhe institucioneve qeveritare, ishte mungesa e infrastrukturës shëndetësore si dhe mungesa e shërbimeve adekuate onkologjike (mungesa e Institutit Onkologjik).

"Në Kosovë mungon Instituti i Onkologjisë, ku gratë do ta bënin diagnostikimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit prej fillimit deri në fund, prandaj gratë përpos përballjes me probleme shëndetësore, duhet të bredhin prej ordinancë në ordinancë, shkojnë në Shkup ose Shqipëri", thekson Nafije Latifi. Në shumë vende të botës mamografia është e obliguar me ligj. Po të aplikohet ky sistem në Kosovë, do të mundësohej zbulimi në kohë i kancerit të gjirit dhe me anë të një intervenimi kirurgjik, do të tejkalohet problemi. Në të njëjtën kohë pacienti nuk do të ngarkohet me shpenzime shtesë dhe të papërbalueshme. "Këtu qëndron problemi që nuk ka mbrojtje të organizuar, nuk ka organizim shëndetësor dhe unë shpesh them që pacienti e paguan qoftë me para qoftë me kokë", thotë Xhavit Bicaj.

Mungesa e specialistëve në këtë fushë është një problem tjetër shqetësues, që ndikon në mos zbulimin e hershëm si dhe trajtimin adekuat të sëmundjeve malinje, respektivisht të kancerit të gjirit. Sipas Xhavit ka shumë pak profesionistë që janë të profilizuar në këtë drejtim: "Tek tani kanë filluar special-

¹⁸⁵ Po aty

FAQE 089

izimet e para, që janë të profilizuar për onkolog dhe kur të përfundojnë e marrin licencën onkolog”.

Të njëjtin shqetësim e ndanë edhe Nafje Latifi: “Ne kemi mjekë që e diagnostikojnë kancerin e gjirit dhe që kryejnë intervenimin kirurgjik shumë mirë, por nuk e kemi mundësinë e trajtimit pas operimit, nuk kemi njerëz të trajnuar për kimioterapi, nuk kemi as njerëz për radioterapi, të cilat janë të domosdoshme në raste tona, sepse sikur të zbulohesh më herët gruaja nuk do të kishte nevojë për asnjë terapi. Kjo terapi është shumë e shtrenjtë si dhe mënyra e aplikimit të saj kërkon profesionistë”.

HIV/AIDS

Në Kosovë, pacienti i parë i prekur me virusin HIV është diagnostikuar më 1986. Prej atëherë deri më tani, numri i personave me HIV pozitiv ka arritur në 70-të. Në vitin 2005 kishte gjithsej 41 persona të infektuar, prej të cilëve 25 burra dhe 16 gra. “Statistikat tregojnë se gjinia mashkullore është më e prekur nga ky virus, ndërsa grupmosha më e rrezikuar është 20 - 49, më saktësisht 30 - 39”¹⁸⁶.

Edona Deva, zyrtare për HIV/AIDS në Ministrinë e Shëndetësisë, ka bërë të ditur se sikurse në tërë botën edhe në Kosovë ka ndryshuar trendi përsa i përket gjinisë së personave të infektuar me HIV/AIDS. “Në suaza globale, kjo ka prekur edhe Kosovën, në një mënyrë, numri i rasteve gra të infektuara me virusin HIV është rritur në krahasim me ato më parë. Gratë konsiderohet më vulnerable në përgjithësi kur është në pyetje infeksioni me HIV dhe atë më së tepërmi në vendet e pazhvilluara dhe në vendet në zhvillim, për shkak të statusit ekonomik dhe social.”¹⁸⁷

Strategjia¹⁸⁸ e parandalimit të HIV/AIDS-it në Kosovë deri në 2008, përbën një gërshetim ndërmjet nevojave të kosovarëve për një politikë unike në

¹⁸⁶ Intervistë me udhëheqës të OJQ-së KAPHA.

¹⁸⁷ Intervistë me Edona Devën, zyrtare për HIV/AIDS në Ministrinë e Shëndetësisë. 22.08.2007. Prishtinë

¹⁸⁸ KKA (Komuniteti Kosovar për AIDS) - Përgjigjja kosovare ndaj HIV/AIDS-it do të përkufizohet nga një qasje e përbashkët shumëdimensionale. Efektiviteti i strategjisë parandaluese pesëvjeçare për HIV/AIDS në Kosovë do të varet nga vazhdimësia e bashkëpunimit ndërmjet një rrjeti të gjerë segmentesh të shoqërisë kosovare, siç janë Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Rinisë, Kulturës e Sporteve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, SHPK, TMK, organizatat joqeveritare (lokale dhe ndërkombëtare), organizatat religjioze dhe sektori privat. Zyra për HIV/AIDS në Ministrinë e Shëndetësisë - Ministria e Shëndetësisë është institucioni kryesor në përgjigjen ndaj HIV/AIDS-it dhe promotori kryesor i qasjes shumë faktoriale. MSH e ka institucionalizuar angazhimin në përgjigjen ndaj HIV/AIDS-it përmes formimit të Zyrës për HIV/AIDS-in si strukturë zyrtare.

FAQE 090

parandalimin e HIV/AIDS-it dhe përvojave më të suksesshme ndërkombëtare të kësaj lëmie. Kjo strategji sipas Devës ka arritur të implementohet për aq sa ka gjetur përkrahje financiare dhe për aq sa i është mundësuar zhvillimi i resurseve në përgjithësi.

Çështja më e ndërlikuar sa i përket kësaj sëmundjeje është testimi vullnetar i qytetarëve të Kosovës, që vazhdon të mbetet një proces sfidues për akterët kyç që merren me parandalimin e infektimit me HIV. "Nuk jemi të kënaqur, sepse ekziston stigmë dhe frikë rreth testimit për HIV", ka vënë në spikamë Edona Deva. Ndërkaq, sipas udhëheqësit të organizatës joqeveritare KAPHA, në Kosovë, ky hezitim për testim, rezulton nga vetëdija e ulët e qytetarëve në Kosovë për shëndetin në përgjithësi dhe HIV/AIDS-in në veçanti. Për pjesën më të madhe të shoqërisë kosovare, është i panjohur fakti se HIV/AIDS është sëmundje seksualisht e transmetueshme. Në këtë mënyrë, rreziku nga seksi i pasigurt afekton drejtëpërdrejtë më tepër gratë për faktin se zakonisht vendimmarrës për shumë çështje në familje janë burrat, duke mos përfshijtur as përdorimin e mjeteve kontraceptive.

Trajtimi i të infektuarve deri më tani është relativisht i mirë, por mund të jetë edhe më i mirë, thekson udhëheqësi i OJQ-së KAPHA. Nga ana tjetër Edona Deva, tregon se terapia të cilën e marrin është gratis, mirëpo fatkeqësisht për trajtimin e kësaj sëmundjeje nevojiten edhe terapitë suplementare. Sipas saj, disa nga personat e prekur me këtë sëmundje nuk e kanë të rregulluar as çështjen e banimit. Ata janë të stigmatizuar dhe të diskriminuar¹⁸⁹.

Sipas UNAIDS, Kosova është rajon me nivel të ulët të epidemive, por janë të pranishme të gjithë parakushtet për një shpërndarje të shpejtë të HIV/AIDS-it. "Një rritje, madje e nivelit alarmues, mund të shfaqet për arsye të faktorëve të ndryshëm, si: numri i madh i të rinjve, shkalla e madhe e papunësisë së bashku me rritjen e konsumimit të drogës, rritja e tregut të seksit, lëvizshmëria e lartë e kosovarëve dhe e komunitetit ndërkombëtarë"¹⁹⁰.

Një burrë nga Prishtina, 42 vjeçar, i cili kishte jetuar në Zvicër për pesë vite, me tu kthyer në Kosovë, fillon të ketë probleme shëndetësore të vazhdueshme dhe shumë shpejtë zbulon se është HIV pozitiv. Fatkeqësisht, ishte shumë vonë, sepse ai tani më kishte infektuar edhe gruan e tij 35 vjeçare¹⁹¹.

¹⁸⁹ Intervistë me Edona Devën, zyrtare për HIV/AIDS në Ministrinë e Shëndetësisë. 22.08.2007. Prishtinë

¹⁹⁰ Shqyrtimi i sektorit të Sigurisë së Brendshme të Kosovës". Pikat e Brishta, faqe 64. Prishtinë, mars 2006

¹⁹¹ <http://www.unmikonline.org/pub/focuskos/oct04/focuskocaffair3.htm> Marrë nga interneti më 11.05.2007.

FAQE 091

Ndonëse, numri i saktë i të infektuarve nga kjo sëmundje në Kosovë është supozues, Fatmire Mulhaxha-Kolçaku ka bindjen se fluksi i madh i ndërkom-bëtarëve, prezenca e punëtorëve, bashkëvendësve tonë që jetojnë dhe puno-jnë në vendet e jashtme, frekuentimi ose ardhja e tyre, janë faktorë të cilët forcojnë dyshimin se numri mund të jetë shumëfish më i madh sesa numri i atyre që kanë qenë të sëmurë dhe kanë qenë të njohur për publikun.¹⁹²

Epidemitë

Kosova është vendi më i goditur nga sëmundjet ngjitesë në shkallë të Evropës, sepse në çdo 100 mijë banorë, ekzistojnë diku rreth 5.500 - 6.000 persona të prekur nga sëmundje të tilla.

“Ekzistojnë tri grupe të mëdha sëmundjesh ngjitesë në Kosovë. Grupi i parë ka të bëjë me sëmundjet ngjitesë, të cilat përhapen me ujin dhe ushqimin e kontaminuar, grupi i dytë i sëmundjeve janë sëmundjet vaksinë - preventabile dhe në grupin e tretë janë zoonozat, të cilat bëjnë pjesë në grupin e sëmund-jeve bioterroriste, sëmundje këto me shkallë shumë të lartë të vdeksh-mërisë”¹⁹³

Sipas Jusuf Dedushajt, epidemiolog në Institutin Kombëtar Për Shëndetësi Publike, grupi i parë i sëmundjeve ngjitesë, vie si pasojë e standardit të ulët jetësorë. “Në Kosovë në vitin 2006, ka dominuar *meningjiti seroz* që përhapet në të shumtën e rasteve me ujin e kontaminuar”.

Kur jemi tek uji, ne duhet ditur se në Kosovë diku rreth 50 përqind e popull-sisë pi ujë higjienik, të kontrolluar nga ujësjellësi, kurse pjesa tjetër e popull-sisë furnizohet prej puseve të cilat nuk kontrollohen.

Jusuf Dedushaj

Në grupin e dytë të sëmundjeve ngjitesë, sipas Dedushajt bënë pjesë fruthi, i cili aktualisht në Kosovë nuk ekziston. “Kosova është vendi i vetëm në rajon dhe në botë që nuk ka fruth sepse në vitin 2002 kemi vaksinuar 535 mijë fëmijë të moshës prej 1-15 vjeçare, pra ka qenë njëra ndër arritjet më të larta”, ka bërë të ditur Dedushaj.

Në grupin e tretë të sëmundjeve ngjitesë, sipas Dedushajt bëjnë pjesë zoonozat. Prej zoonozave, në Kosovë është bruceoloza që nuk shkakton

¹⁹² Intervistë me Fatmire Mulhaxha-Kolçaku, kryetare e komisionit parlamentar për shëndetësi. 30.08.2007. Prishtinë

¹⁹³ Intervistë me Jusuf Dedushajn, epidemiolog në Institutin Kombëtar Për Shëndetësi Publike. Intervista e realizuar me 21.09.2007.

FAQE 092

vdekje masive, por shkakton invaliditet. Në Kosovë nga 30 komuna në 28 prej tyre është regjistruar kjo sëmundje.

Sëmundje tjetër vdekjeprurëse janë ethet hemorragjike - *krime kongo*.

Kjo sëmundje, pas etheve *ebolla* është sëmundja me shkallë më të lartë të vdekshmërisë, ndërkohë që Kosova përballet çdo vit me këtë sëmundje fatale. "Kjo regjistrohet në 82 vatra ende me epidemi, në 13 komuna të Kosovës, përkatësisht në zonën qendrore të saj"¹⁹⁴

Poashtu, në Kosovë paraqiten edhe ethet hemorragjike me sindrom veshkor. "Për fat të mirë po regjistrohet më pak dhe shpresoj që nëse ne kujdesemi për higjienën e vendbanimeve, për largimin e mbeturinave që i kemi në qytete, atëherë do të ketë mundësi që të ulët rreziku nga kjo epidemi"¹⁹⁵, shpreson Dedushaj.

Sëmundjet e tubit tretës dhe zgjeba janë karakteristike për gjithë Kosovën dhe të cilat në masë më të madhe shfaqen në zonat rurale. "Në qytete janë më pak të shprehura sëmundjet që përhapen me ujë dhe ushqim", ka vënë në spikamë Jusuf Dedushaj.

Sëmundjet ngjitëse zakonisht nuk janë karakteristike për moshën, përveç një grupi të sëmundjeve që janë sëmundje të fëmijëve, përderisa gratë janë më të prekura nga sëmundjet ngjitëse, kur kanë ndryshime fiziologjike, gjatë shtatzënisë dhe lehonisë. Ato janë më të prekura si rezultat i rënies së imunitetit.

Jusuf Dedushaj

Aktualisht, Institucionet shëndetësore të Kosovës, nuk janë të përgatitura dhe nuk kanë kapacitete dhe mjete adekuate për trajtimin e sëmundjeve ngjitëse, siç janë epidemitë.

Në trajtimin e këtyre epidemive, stafi i QKU-së punon në kushte mjaft të vështira. Në rastin konkret sëmundjet infektive e kërcënojnë direkt sigurinë e tyre. "Mjeku mund të infektohet nga pacienti, sepse i mungojnë veshmbathjet që i nevojiten për ndërhyrje. Ne kemi pasur tre mjek të infektuar me ethet krime kongo, një teknike, e cila ka vdekur nga ethet hemorragjike, ngaqë është infektuar me gjakun e pacientit", thekson Dedushaj.

Ushqimi

Me siguri ushqimore nënkuptojmë qasjen e mjaftueshme dhe të sigurt në ushqim për plotësimin e nevojave themelore të të gjithë njerëzve.

¹⁹⁴ Intervistë me Jusuf Dedushaj

¹⁹⁵ Intervistë me Jusuf Dedushaj

FAQE 093

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka llogaritur që burrat dhe gratë, mesatarisht kanë nevojë për së paku 2200 kalori në ditë, në mënyrë që të kenë jetë të shëndoshë. Mirëpo, gratë shtatzëna kanë nevojë së paku për 2500 kalori në ditë.¹⁹⁶

Duke pasur parasysh gjendjen e rëndë ekonomike në Kosovë, ku pjesa dërmuese e popullatës jeton në varfëri, qasja në ushqim, përveç që është e kufizuar, në të shumtën e rasteve është edhe e pasigurt.

Kjo situatë, afekton në mënyrë të veçantë gratë shtatzëna dhe lehona, duke pasur parasysh faktin e OBSH-së se për të pasur shëndet të mirë, një gruaje shtatzënë i nevojiten së paku 2500 kalori në ditë. Mungesa e ushqimit të mjaftueshëm dhe të sigurt, rrezikon drejtpërsëdrejti shëndetin e nënës dhe fëmijës.

Sa i përket qasjes së sigurt në ushqim, kontrolli i tij nga ana e institucioneve kompetente, është i vështirësuar për shkak të paqartësisë së kompetencave të institucioneve, të cilat do të duhej ta bënin kontrollin e tij.

Përderisa Institucionet vazhdojnë të kenë paqartësi në mes vete mbi kompetencat e AVUK-ut dhe përkundër përpjekjeve që janë bërë deri më tani, qytetarët e pësojnë nga produktet me afat të skaduar, të cilat mund të jenë edhe me pasoja fatale.

Uji

Qasja në ujë të pijshëm dhe higjienë publike, është bazë për shëndet të mirë. Furnizimi i dobët me ujë të pijshëm dhe praktikat e varfra të higjienës publike, paraqesin kërcënim të madh për shëndetin e grave dhe burrave.

Në mungesë të ujit të pijshëm dhe sistemit të ujësjellësit, në shumë vende të Kosovës, banorët janë të detyruar të furnizohen nga puset e tyre.

Sipas raportit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Kosova ka rezerva të kufizuara ujore që në të ardhmen do të jetë një faktor kufizues për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.¹⁹⁷

Ndërkohë, sipas epidemiologut Jusuf Dedushajt mbi gjysma e popullsisë kosovare pi ujë higjienik, të kontrolluar nga ujësjellësi, kurse pjesa tjetër e popullsisë pi ujë të pakontrolluar.

Gjithnjë sipas raportit të MMPH-së në Kosovë, në vendbanimet urbane dhe rurale, nuk ka mekanizma për pastrimin e ujërave të ndotura.

¹⁹⁶ <http://www.unfpa.org/intercenter/food/better.htm>, marrë nga interneti, 07.10.2007, Prishtinë.

¹⁹⁷ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor "Gjendja e Mjedisit në Kosovë" Prishtinë 2004

FAQE 094**Ajri**

Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor "Cilësia e ajrit nuk paraqet problem shqetësues në të gjitha zonat e vendit. Në këtë drejtim më problematike janë zonat e zhvilluara urbane, veçanërisht Prishtina, për shkak të ndikimit nga termocentralet Kosova A, Kosova B dhe automjetet, pastaj Mitrovica si pasojë e mbetjeve industriale në kompleksin e Trepçës"¹⁹⁸.

Sipas hulumtimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Kosovë ajri është i papastër dhe ndikon në vdekshëmrinë e popullatës. "Të dhënat e fundit të OBSH-së, tregojnë se shkak i rritjes së përqendrimit të grimcave të respirueshme (PM10) në ajrin urban, ka rritje të vdekshmërisë së popullatës, e në disa vende në masën 10-20 përqind"¹⁹⁹

Kur flitet për ndikim e ajrit, raporti mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë, i bërë nga MMPH-ja, vë në pah se në rajonin e Mitrovicës prezenca e sasisë së lartë të plumbit (Pb) në gjak lë pasojë të rënda në organizmin e njeriut si: çrregullime në biosintezën e hemoglobinës dhe anemi, çrregullime në sistemin kardiovaskular, dëmtimin e sistemit nervor, **dështimet dhe lindjet e parakohshme** etj²⁰⁰

198 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor "Gjendja e Mjedisit në Kosovë" Prishtinë 2004

199 Po aty

200 Po aty

FAQE 095**SIGURIA E GRUPEVE ETNIKE NË KOSOVË**

Secila shoqëri karakterizohet nga diversiteti i identiteteve (etnike, kulturore, fetare, gjinore etj) të pjesëtarëve të saj. Shoqëria kosovare pa dyshim nuk bënë përjashtim.

Që nga viti 1981, në Kosovë nuk është bërë regjistrimi i popullsisë, ndaj nuk dihet numri i saktë, si dhe prejardhja etnike e tyre. Sipas Entit Statistikor të Kosovës, vlerësohet se në Kosovë jetojnë 2.100.000 banorë, prej tyre 92 përqind janë shqiptarë, 5.3 përqind serb, që është minoriteti më i madh në Kosovë, ndërsa 2.7 përqind janë pakica të tjera²⁰¹. Pakicat tjera të cilat jetojnë në Kosovë janë: komuniteti RAE (rom, ashkali, egjiptian), boshnjakët, turqit, goranët dhe kroatët.

Kur flitet për sigurinë, në kontekstin e pakicave kombëtare që jetojnë në Kosovë, liria e lëvizjes është pa dyshim boshti i problemit. Ajo reflektohet në pasigurinë ekonomike, arsimore, e shëndetësore të tyre. Pakica serbe është ajo, e cila konsiderohet me liri më të kufizuar të lëvizjes.

Institucioni i Ombudspersonit, në raportin vjetor 2006-2007, drejtuar Kuvendit të Kosovës, flet për problemet e përgjithshme me të cilat ballafaqohen komunitetet minoritare në Kosovë. "Problemet e përgjithshme me të cilat përballen të gjitha komunitetet minoritare në Kosovë janë arsimi, papunësia dhe (pa)mundësia për t'i përdorur gjuhët e tyre përkatëse"²⁰².

Raporte të shumta që kanë trajtuar çështjet e sigurisë së komuniteteve kanë vënë në pah se ndër të gjitha komunitetet, ai RAE ndodhet në pozitën më të palakmueshme. Vështirësitë ekonomike, shkalla e ulët e arsimimit dhe integrimi i ulët në sfera tjera të shoqërisë, e vendosin këtë komunitet në pozitë të vështirë sociale, duke kërcënuar kështu sigurinë e tyre. Këtë e konfirmon edhe Behxhet Shala, drejtor ekzekutiv në KMLDNJ, i cili thekson: "minoriteti, i cili realisht është më i rrezikuari sipas KMLDNJ-së, tash për tash janë Romët, ata thjeshtë nuk kanë përkrahje."²⁰³

Për këtë shkak, gjendja e përgjithshme e komunitetit RAE, reflektohet edhe në pozitën e gruas RAE.

Komuniteti RAE në Kosovë, veçanërisht gratë ballafaqohen me një numër të

201 Enti i Statistikës së Kosovës, <http://ks-gov.net/esk> Marrë nga interneti më 31.10.2007.

202 Raporti i Shtatë Vjetor 2005-2006 – Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë, drejtuar Kuvendit të Kosovës, 11 korrik 2007

203 Intervistë me Behxhet Shalën, Drejtor ekzekutiv i Këshillit për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, 16.07.2007, Prishtinë

FAQE 096

madh të vështirësive si ato sociale, politike dhe ekonomike, siç janë liria e lëvizjes për shkak të pasigurisë së krijuar pasluftës, diskriminimi etnik, niveli i ulët i arsimit dhe mungesa e përfshirjes në vendimmarrje.

Nga intervistat me gra, përfaqësuese të disa komuniteteve që jetojnë në Kosovë, rezulton se pozita e komunitetit serb dhe atij RAE është më e pavolitshmjë, në krahasim me atë të komunitetit boshnjak dhe turk, të cilët duket se janë më të integruar në shoqërinë kosovare. Kësisoj, Shpresa Agushi, drejtoreshë ekzekutive e Rrjetit të Organizatave të Grave RAE në Kosovë, mendon se siguria e burrave dhe grave në Kosovë lidhet me mungesën e ligjeve të aprovuara si dhe mungesën e informatave për ligjet ekzistuese nga ana e qytetarëve të Kosovës, konkretisht të komunitetit RAE²⁰⁴. Po ashtu, modeli patriarkal i të jetuarit e vë gruan e komunitetit RAE, në pozitë më të rrezikuar në familje apo shoqëri. "Kjo bënë që gruaja RAE të jetë dhe të ndihet e rrezikuar, pasiqë të tjerët flasin dhe vendosin në emër të saj, duke e diskriminuar atë dhe duke mos pasur të drejtë të vendos për veten si qenie e barabartë njerëzore²⁰⁵, sqaron Agushi.

Për dallim prej komunitetit RAE, komuniteti boshnjak duket të jetë i integruar mirë në rrethanat e reja të krijuara në Kosovë. Nadira Avdiç – Vllasi, redaktore e programit në gjuhën boshnjake në Radio Televizionin e Kosovës, thekson se siguria për një grua boshnjake është e njëjtë sikur për çdo grua tjetër në Kosovë: "Nuk ka asgjë që lidhet me sigurinë e grave boshnjake, e që ndryshon në relacion me gratë shqiptare, turke etj²⁰⁶

Gjendje e ngjashme duket të jetë edhe tek pjesëtarët e komunitetit turk. Keriman Sadikay, zyrtare për çështjet e minoritetit turk në Zyrën për Qeverisje të Mirë në Qeverinë e Kosovës, pohon: "duke qenë se komuniteti turk është i integruar shumë mirë në komunitetin shumicë në çdo fushë, mendoj se me çdo problem që ballafaqohen gratë e komunitetit shumicë, ballafaqohen edhe gratë e komunitetit turk, do të thotë nuk ka dallime"²⁰⁷.

Ndërkaq për Snezhana Karaxhiqin, aktiviste për të drejtat e grave, problemet me të cilat ballafaqohen gratë serbe në Kosovë, janë të lidhura me situatën e krijuar pas luftës dhe perceptimet e tyre për gjendjen e sigurisë në përgjithësi²⁰⁸

204 Intervistë me Shpresa Agushin, Drejtore ekzekutive e Rrjetit të Grupeve të Grave Rome, Ashkali, Egjiptiane, 20.10.2007, Prishtinë

205 Intervistë me Shpresa Agushin

206 Intervistë me Nadira Avdiç – Vllasi, redaktore e programit në gjuhën boshnjake në Radio Televizionin e Kosovës (RTK), 26.10.2007, Prishtinë

207 Intervistë me Keriman Sadikay, zyrtare për çështje të komunitetit turk në Zyrën për Qeverisje të Mirë 19.09.2007

208 Intervistë me Snezhana Karaxhiç, aktiviste për të drejtat e grave. 4.10.2007. Prishtinë

FAQE 097

Nga ana tjetër, Besa Qirezi, zyrtare për barazi gjinore, mundësi të barabarta dhe antidiskriminim në Ministrinë për Kthim dhe Komunitete, ka deklaruar se kjo ministri angazhohet për sigurinë e të gjitha minoriteteve në Kosovë, pa dallime. Shumica e raporteve që flasin për sigurinë e minoriteteve në Kosovë, e trajtojnë atë më shumë në kontekstin e përgjithshëm, duke lënë anash perspektivën gjinore.

Qasja në arsim dhe shëndetësi

Arsimi përbën një komponentë thelbësore të zhvillimit të individit dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Ministria e Arsimit ka hartuar strategjinë dhjetëvjeçare, e cila u miratua nga Qeveria e Kosovës në prill të vitit 2007, në kuadër të së cilës janë paraparë masa dhe aktivitete që adresojnë problemet dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen të gjitha komunitetet.²⁰⁹

Besa Qirezi, flet për angazhimin e institucioneve kosovare për integrimin e minoriteteve në arsim. "Universiteti i Prishtinës ose Ministria e Arsimit, i ka lënë kuotat për minoritete, duke iu dhënë mundësi që ata të kenë qasje në arsim. Këto vende të rezervuara për minoritete, kanë mbetur të lira për një kohë të gjatë", ka sqaruar Qirezi. Megjithatë, kur bëhet fjalë për gratë, ajo thekson se atyre u nevojitet përkrahje më e madhe në fushën e arsimit, pa marrë parasysh dallimet etnike.

Shpresa Agushi, nga komuniteti RAE mendon se përfshirja e grave dhe vajzave RAE në shkollim, nuk është e kënaqshme. Shkaqet e kësaj përfshirjeje të vogël të grave të këtij komuniteti në arsim, sipas saj janë: siguria (largësia e shkollës, frika, etj), kushtet socio – ekonomike, mentaliteti patriarkal (martesat e hershme, vetëdiija e ulët mbi rëndësinë e shkollimit) si dhe diskriminimi gjinor dhe etnik.

Këto njëkohësisht janë edhe shkaqet e braktisjes së shkollimit, e cila sipas hulumtimit të bërë nga Rrjeti i Organizatave të Grave RAE, mbi braktisjen e shkollimit të vajzave të këtij komuniteti, duket të jetë mjaft shqetësuese.

Problemi i martesave të hershme të vajzave, është ndër shkaqet kryesore të braktisjes së shkollimit edhe tek vajzat e komunitetit boshnjak në komunën e Dragashit. Nadira Avdiç-Vllasi tregon se në komunat e tjera nuk ka edhe aq dallime, me përjashtim të komunës së Dragashit, ku shumica e vajzave e braktisin shkollimin pas klasës së katërt dhe të tetë. Ndërkaq te komuniteti RAE, sipas Shpresa Agushit, ka trend të zvogëlimit të numrit të vajzave që

209 Strategjia për Integrimin e Komuniteteve ROM, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, Komponenta e edukimit 2007 – 2017, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Qeveria e Kosovës, IPVQ, Prishtinë, korrik 2007

FAQE 098

vazhdojnë shkollimin e mesëm dhe atë superior: "Numri i atyre që regjistrohen në shkollë të mesme, është gjithnjë e më i vogël, e po ashtu edhe i atyre që arrijnë në shkollim të lartë."²¹⁰

Sipas Kerimane Sadikay, për komunitetin turk, gjendja duket të jetë ndryshe. Te pjesëtarët e këtij komuniteti braktisja e shkollimit është prezente në pilot njësinë komunale të Mamushës. Megjithatë, edhe në këtë rajon janë bërë përpjekje për përmirësimin e kësaj gjendjeje: "Në Mamushë është hapur një degë për shëndetësi (shkollë e mesme) për të siguruar përfshirje në arsim për të gjithë komunitetin".

"Qasja në arsim është e mundshme edhe për gratë e minoritetit serb, edhe pse është e kufizuar në regjione dhe e lidhur me Kosovën veriore, gjë kjo që vështirëson pjesëmarrjen e grave nga enklavat dhe rajonet tjera", thotë Snezhana Karaxhiq.

Sa i përket qasjes së komuniteteve në shërbimet shëndetësore, deklarativisht, Institucionet e Kosovës garantojnë shërbime të barabarta për të gjithë qytetarët që jetojnë në Kosovë pa dallim.

Sipas Besa Qirezit, zyrtare për barazi gjinore, mundësi të barabarta dhe anti-diskriminim në MKK, Qendra Klinike Universitare i ofron ndihmë qytetarëve në mënyrë të barabartë, kushdo që ka nevojë.

Problem i madh mbetet edukimi shëndetësor i qytetarëve në përgjithësi. Kur kjo vihet në kontekst të shkollimit të grave nga komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë, duket se gratë e komunitetit RAE, për shkak të shumë faktorëve, kanë nivel më të ulët të edukimit shëndetësor.

Projekti "Edukimi shëndetësor i vajzave dhe grave të komunitetit RAE", i zbatuar nga grupi i grave RAE "Foleja", në bashkëpunim me dy OJQ të tjera dhe Institucionet Shëndetësore, ka vënë në pah se gratë e reja të komunitetit RAE, përballen me probleme shëndetësore qysh në moshë të re dhe jetojnë me sëmundje kronike gjatë tërë jetës së tyre²¹¹. Më tej, raporti thekson se: "Kjo është pasojë e nivelit të ulët të arsimimit, të pozitës së vështirë materiale, mos-informimit të duhur nga mediat e ndryshme lokale përkitazi me gjendjen e tyre aktuale."²¹²

Ndërkaq, gratë nga komuniteti boshnjak, qasjen në shërbimet shëndetësore e kanë më të vështirë për shkak të vështirësive të komunikimit në gjuhën e tyre. Sipas Nadira Avdiç-Vllasi kjo është vërejtur më shumë në Prishtinë,

210 Intervistë me Shpresa Agushin, Drejtore ekzekutive e Rrjetit të Grupeve të Grave Rome, Ashkali, Egjiptiane, 04.10. 2007 Prishtinë

211 Edukimi shëndetësor i vajzave dhe grave të komunitet rom, ashkali dhe egjiptian, "Foleja", Prizren, shkurt 2007, faqe 8

212 Po aty

FAQE 099

përderisa në Pejë dhe Prizren, ky problem është më pak i theksuar. Snezhana Karaxhiq nga komuniteti serb, pohon se ekzistojnë qendra shëndetësore me shërbime cilësore, mirëpo zakonisht ato janë larg nga lokacioni ku jetojnë gratë serbe dhe kjo e vështirëson qasjen e këtyre grave në këto shërbime.

Krahas angazhimit të Institucioneve Qeveritare të Kosovës, edhe shoqëria civile ka dhënë kontributin e saj duke përkrahur dhe promovuar aktivitete të ndryshme që kanë për synim përfshirjen e këtyre komuniteteve në shoqëri, dhe përmirësimin e gjendjes së tyre.

Megjithatë, nevojitet vazhdimësi e këtyre planeve dhe aktiviteteve që do të përfshinin këto komunitete në të gjitha sferat e shoqërisë.

FAQE 0100

SHTOJCA 1**Realizimi i Hulumtimit****Metodologjia**

Për realizimin e projektit "Monitorimi i sigurisë në Kosovë nga perspektiva gjinore" është përdorur metodologji e kombinuar, duke vënë theksin më shumë në metodën kualitative.

Fillimisht është bërë mbledhja e raporteve dhe statistika të ndryshme, relevante me aspektet e sigurisë dhe çështjeve gjinore. Janë përcaktuar fushat (çështjet kryesore) në të cilat janë shtjelluar aspektet e sigurisë, nga perspektiva gjinore. Po ashtu, janë shfrytëzuar burime të ndryshme nga disa media të shkruara dhe elektronike, duke përfshirë edhe burime nga interneti.

Me qëllim të mbledhjes së të dhënave janë përdorur këto instrumente hulumtuese si: intervista gjysmë e standardizuar në formë të bashkëbisedimit dhe fokus grupi.

Po ashtu është bërë edhe analiza e ligjeve, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt prekin aspekte të sigurisë nga perspektiva gjinore.

Intervistat

Janë realizuar gjithsej 39 intervista me përfaqësues të institucioneve qeveritare, të sigurisë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare në Kosovë, si dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare.

Fokus grupet

Me qëllim të njohjes së perceptimeve të grave dhe burrave mbi aspekte të ndryshme të sigurisë, janë organizuar dy fokus grupe. Pjesëmarrësit janë përzgjedhur në bazë të këtyre kritereve: gjinisë, moshës, nivelit të arsimit, tipit të vendbanimit dhe statusit social.

FAQE 0101

Bashkëpunëtorët që ndihmuan në realizimin e hulumtimit

Projekti "Monitorimi i Sigurisë në Kosovë nga perspektiva gjinore", është realizuar me iniciativën dhe përkrahjen institucionale të Qendres Kosovare për Studime Gjinore. Ky hulumtim është mbështetur nga: Kvinna Till Kvinna, Swiss Agency for Development and Cooperation/ SDC in Prishtina, Network Women Program – Open Society Institute (OSI), New York

Konsultant: Nait Vrezezi në metodologji dhe Mehdi Geci në legjislacion.

Drejtoresha e hulumtimit, në emër të Qendrës Kosovare për Studime Gjinore, falënderon ekipin hulumtues: Sibel Halimi, Albulena Metaj, Artan Krasniqi, Florie Xhemajli dhe Laura Berisha.

Veçanërisht falënderon për përkrahje të vazhdueshme në realizimin e projektit, anëtarët tjerë të stafit të QKSGJ-së: Luljeta Demollin, Driton Parduzin dhe Shpresa Agushin.

Po ashtu falënderon të gjithë të intervistuarit për gatishmërinë për bashkëpunimin.

FAQE 0102

SHTOJCA 2**Lista e personave të intervistuar gjatë kërkimeve në terren**

Nr Mbiemri	Emri	Pozita	Institucioni	Data	
1.	Maloku	Naim	Kryetar i Komisionit Parlamentar për Siguri	Kuvendi i Kosovës	16.05.2007
2.	Zeqiraj	Samije	Anëtare e Komisionit Parlamentar për Siguri	Kuvendi i Kosovës	17.05.2007
3.	Nikolla	Ferdinand	Drejtor	FIQ	17.05.2007
4.	Peci	Lulzim	Drejtor	KIPRED	16.05.2007
5.	Jashari	Hilmi	Ushtrues detyre "Ombudsperson"	Ombudsperson	25.05.2007
6.	Sadriu	Fahri	Kordinator për Barazi Gjinore	TMK	28.05.2007
7.	Musa	Ismail	Zyrtar për të drejtat e njeriut në Ministri të Brendshme	MPB	1.06.2007
8.	Gorani Gashi	Visare	Shefe e Agjencionit për Barazi Gjinore	Agjencioni për Barazi Gjinore	07.06.2007
9.	Selimi	Behar	Gjeneral SHPK	SHPK	19.06.2007
10.	Huthchinstone	Clare	Kryesuese ne zyrën për barazi gjinore	JNMIK	19.06.2007
11	Ahmeti	Ramadan	Shef i sektorit për antitrafikim dhe krim në SHPK	Sektori antitrafikim -SHPK	28.06.2007
12	Haxholli	Tahire	Zyrtare e sektorit për dhunë në familje	Sektori i dhunës në familje -SHPK	03.07. 2007
13	Mexhuani	Xhevat	Komisar i Shërbimit Korrektues të Kosovës	Ministria e Drejtësisë -Sektori i burgjeve	09.07.2007
14	Berdynaj	Agim	Zyrtar i Arsimit Parauniversitar	Ministria e Arsimit, Shkences dhe Teknologjisë	04.07.2007
15	Gashi	Zijadin	Inspektor Rajonal I Arsimit	(MASHT)	05.07.2007
16	Hyseni	Halim	Udhëheqës i sektorit Për zhvillimin e programeve të trajnimit	KEC	09.07.2007
17	Shala	Behgjet	Drejtor ekzekutiv	KMLDNJ	16.07.2007
18	Basha	Adile	Udhëheqëse e sektorit për mbrojtjen e familjes	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	11.07.2007
19	Kuriu	Arbena	Zyrtare e projektit për mbrojtjen e fëmijëve	UNICEF	20.07.2007
20	burgosur (I mitur - anonim)	-	-	Qendra Korrektuese, Lypjan	19.07.2007
21	Kelmendi	Ilir	Zëvendës Drejtor	Qendra Korrektuese, Lypjan	19.07.2007

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME GJINORE

FAQE 0103

Nr Mbiemri	Emri	Pozita	Institucioni	Data	
22	E burgosur (anonime)	-	Qendra Korrektuese, Lypjan	19.07.2007	
23	Dobroshti- Deva	Edona	Zyrtare për HIV/AIDS	Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike	22.08.2007
24	Mullhaxha Kollçaku	Fatmire	Kryetare e Komisionit	Komisioni Parlamentar për Shëndetësi	30.08. 2007
25	Komoni	Zef	Kryeinspektor	Inspektorati Shëndetësor - Ministria e Shëndetësisë	27.08.2007
26	Latifi	Nafije	Drejtoreshë ekzekutive	Qendra Kosovare për luftimin e kancerit	23.08.2007
27	Dedushaj	Jusuf	Epidemiolog	Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike	21.09.2007
28	Sadikaj	Keriman	Zyrtare për çështje të komunitetit turk në Zyrën për Qeverisje të Mirë	Zyrën për Qeverisje të Mirë	19.09.2007
29	Millaku	Agim	Zëvendës kryeinspektor	Inspektorati i Punës	17.09.2007
30	Krasniqi	Nazmie	Koordinatorë për të drejtat e njeriut	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	19.09.2007
31	Mahmutaj	Cyme	Zyrtare e lartë	Zyra për Qeverisje të mirë, Mundësi të barabarta dhe barazi gjinore	20.08.2007
32	Agushi	Shpresa	Drejtoreshë ekzekutive	Rrjeti i gropave të grave RAE	24.07.2007
33	Shala	Hysni	Zyrtar për barazi gjinore	SHPK - Zyrtar për barazi gjinore	24.07.2007
34	Bicaj	Xhavit	Drejtor i Instituti Onkologjik	Instituti Onkologjik	31. 08. 2007
35	Rugova	Igballë	Drejtoreshë e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës	18.09.2007
36	Fushtica	Lulzim	Ushtrues detyre i drejtorit	Qendra Kosovare për Siguri Publike	09.10.2007
37	Macula	Flora	Këshilltare për qeverisje dhe paqe për Evropën Jug-Lindore	UNIFEM	19.09. 2007
38	Nadira	Avdic-Vllasi	Redaktore e programit në gjuhën boshnjake	RTK	26.10. 2007
39	Salihu	Valbona	Drejtoreshë ekzekutive	Norma	12.11. 2007

FAQE 0104

SHTOJCA 3**Bibliografia****Raportet dhe Publikimet**

- Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, Rezoluta 1325 (2000), E pranuar nga Këshilli i Sigurimit në takimin e tij të 4213-të, më 31 tetor 2000.
- Raporti i Progresit 2007 për Kosovën RKSOKB 1244. Komisioni i Komuniteteve Evropiane. Bruksel 06.11.2007
- Luci, Nita & Krasniqi, Vjollca, "Politika e Kujtesës dhe përkatësisë: Historitë personale të grave shqiptare në Kosovë", Center for Research and Gender Policy, Dhjetor 2006
- Agneta Soderberg Jacobson, Kvinna till Kvinna, "Security on whose terms?, If men and women were equal"
- Shtjellimi i koncepteve të sigurisë dhe aktorët: Sfida me të cilën përballemi
- Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të mirë, të drejtat e njeriut, mundësi të barabarta dhe çështjet gjinore, "Raport mbi aktivitetet në sferat kundër-diskriminim, kundër-korrupsion, kundër- trafikim me qenie njerëzore dhe të drejtat e njeriut", Korrik-dhjetor 2006
- Buletini informativ i ABGJ-së, Prishtinë 2007
- Instituti Kosovar për kërkime dhe zhvillime të politikave KIPRED, "Forcimi i mbikëqyrjes civile dhe i menaxhimit të sektorit të sigurisë në Kosovë", Prishtinë, nëntor 2005
- Hentchel, Gitti, "Gender justice in peace and security politics, Feminist approaches and perspectives in the 21. century"
- Qendra Kosovare Për Studime Gjinore "Kosovar Civil Society Report to the United Nations on Violence against Women in Kosovo" Rizvanolli, Ilire, Bean, Lauren and Farnsworth, Nicole.
- UNDP, "Rishikimi i sektorit për Siguri të brendshme në Kosovë", Kosovë 2006
- UNIFEM, "Gratë në Punë", Situata dhe mundësitë ekonomike për gratë në Kosovë, Shtator 2000
- Qendra për Mirëqenien e Gruas QMG, "Përhapja e dhunës në baza gjinore", Të dhënat nga hulumtimi, Pejë, Dhjetor 2006
- Buletini informative i Policisë së Kosovës, "Mbrotësi ... Drejtësi për të gjithë", Vëll. III, Nr. 1, Mars 2007
- Forumi i Iniciativës Qytetare FIQ, "Hulumtimi mbi Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL) në Kosovë", 24 Gusht 2006
- Forumi i Iniciativës Qytetare FIQ, Vendi i Sigurt, Duke Ndërtuar Sigurinë në Kosovë, Deklaratë për media, 31 janar 2007

FAQE 0105

- Sundstrom, Satu, Department of Political Science, University of Helsinki, "Europe and integration of gender to the new security", Helsinki, Finland
- McKay, Susan, "Women, Human Security, and Peace-Building: A Feminist Analysis", Chapter 7
- Gratë dhe burrat në Kosovë, Enti I Statistikës së Kosovës, Shkurt, 2007.
- Forumi i Iniciativës Qytetare FIQ, "Siguria në shkolla", korrik 2007, Prishtinë.
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore, "Auditimi i Çështjeve Gjinore në Sistemin Arsimor", 2006.
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore, " Si votojnë gratë në Kosovë", 2005.
- UNICEF dhe MASHT, "Hulumtim mbi Dhunën ndaj Fëmijëve në Shkollat e Kosovës, Maj – Shtator, 2005
- Shtatzënia dhe Planifikimi Familjar në Kosovë (Studim Kualitativ), UNFPA DHE INDEX KOSOVA, Dhjetor 2006, Prishtinë.
- Gjendja Perinatale në Kosovë për 2000-2006, Ministria e Shëndetësisë, Komiteti Kosovar për shëndetin e Nënës dhe Fëmijës, ShOGJK, Shoqata e Peditërve të Kosovës, Instituti Kombëtar I Shëndetësisë Publike, OBSH, UNFPA, UNICEF, Prill, 2007, Prishtinë.
- Gratë dhe burrat në Kosovë, Enti I Statistikës së Kosovës, Shkurt, 2007.
- Research on Knowledge, Attitude and Perception on Use of Contraceptives and Facilities among women and men of reproductive age 15-49 years. Final Report on the findings of KPA Study, May – October 2006, Kryqi I Kuq Zvicëran.
- Raport Vjetor i Punës për vitin 2006, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika Obstetrike Gjinekologjike, Prishtinë, 2007.
- Analizë e gjendjes së fëmijëve dhe të grave në Kosovë. UNICEF. Shkurt 2004
- Raporti i Zhvillimit Njerëzor: Ngritja e Qytetarit: Sfidat dhe Mundësitë. UNDP. Kosovë. 2004
- Zëri i Grave. Prishtinë (2004) raport nga (KWN, KWI, UNICEF, UNIFEM, UNDP, UNFPA, WHO, UNHCR
- Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë, UNICEF, MASHT, Nëntor, 2004
- FIQ "Siguria në shkolla, Sfidë për komunitetin", korrik 2007
- Raporti i Qeverisë Amerikane Për të Drejtat e njeriut në botë; Pjesa për Kosovën. Qershor 2006.

Legjislacioni i konsultuar

- Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut, Nr 2001/9)
- Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2004/18, mbi shpalljen e Ligjit për Barazi Gjinore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës;
- Rregullorja Nr. 2006/7 mbi shpalljen e ligjit për Familjen e Kosovës të miratuar nga Kuvendi i Kosovës;

FAQE 0106

- Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/7 mbi shpalljen e Ligjit për Trashëgimin e Kosovës të miratuar nga Kuvendi i Kosovës;
- Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/12 Mbrojtja Kundër Dhunës në Familje.
- Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2003/25 e datës 6 korrik 2003, mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës
- Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2004/46, e datës 19.11.2004)
- Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2001/4 e datës 12 janar 2001, Mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë;
- Ligji për Ndërprerjen Shtatzënësisë, (miratuar nga Kuvendi, Ligji Nr. 02/L-73), ende nuk është shpallur nga PSSP-ja;
- Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2000/51 (30 Gusht 2000) mbi Moshën për Vijimin e Detyrueshëm të Shkollës në Kosovë;
- Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2001/7 (21 shkurt 2001) për Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë
- 12. Udhëzim Administrativ, Numër:MASHT 40/2005, datë: 28.09.2005
- Ndalimi, ndërprerja e punës dhe iniciimi i procedurës disiplinore ndaj mësimdhënësve dhe punëtorëve të tjerë në institucionet edukativo-arsimore, aftësuese dhe shkencore.

Web faqet

- Kuvendi i Kosovës – www.kuvendikosoves.org
- Qeveria e Kosovës – www.ks.gov.net
- Ministria e Punëve të brendshme – www.mpb-ks.org
- Ministria për Komunitete dhe Kthim – www.ks.gov.net/mkk
- Gazeta Zyrtare - www.ks.gov.net/GazetaZyrtare/
- Trupat Mbrojtëse të Kosovës – www.tmk-ks.org
- Policia e Kosovës (SHPK) - www.kosovopolice.com
- Shërbimi Doganor i UNMIK-ut – www.unmikcustoms.org
- Misioni i OSBE-së në Kosovë – www.osce.org/kosovo
- <http://www.fao.org/Gender/en/educ-e.htm> “Edukimi, shtrirja dhe komunikimi” marrë nga interneti 14.07.2007
- UNDP – www.ks.undp.org
- Ombudspersoni i Kosovës – www.ombudspersonkosovo.org
- KFOR-i – www.nato.int/kosovo
- IOM - www.iomkosovo.org
- Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës – www.womensnetwork.org
- http://en.wikipedia.org/wiki/Arms_control
- http://en.wikipedia.org/wiki/International_security
- http://www.unmikonline.org/albanian/regulations/2003/RA2003_25_CC.pdf

FAQE 0107

- http://en.wikipedia.org/wiki/Human_security - 04.04.2007 Siguria Njerëzore - Definim
- http://en.wikipedia.org/wiki/Human_security - 04.04.2007 Dallimi ndërmjet Sigurisë Tradicionale dhe Humane – Definicionet dhe karakteristikat
- www.gdrc.org/sustdev/husec/Definitions.pdf - Definim
- www.gdrc.org/sustdev/husec/Definitions.pdf 05.04.2007 – Kategoritë Kryesore
- http://popdev.hampshire.edu/projects/dt/pdfs/DifferenTakes_14.pdf (06.04.2007) - Siguria Njerëzore, Perspektiva Gjimore
- http://www.humansecuritycentre.org/index.php?option=com_frontpage&Itemid=1 – 19.04.2007
- <http://www.aic.gov.au/conferences/policewomen3/bearlin.pdf> - Rreth Rezolutës 1325
- Enti Statistikor i Kosovës, www.ks-gov.net/esk
- www.kuvendikosoves.org
- <http://www.ks-gov.net/MASHT/DefaultPC.aspx>
- www.unfpakos.org
- www.rtklive.com
- 2 <http://www0.bbc.co.uk/albanian/021121125623.shtml> Intervista e dhënë nga Naxhije Buçinca në BBC

Gazetat

- Koha Ditore
- Express
- Bota Sot
- Lajm
- Infopress
- Monitoring journal articles from 1 January – 30 April 2007, to be continued for further months

Dokumentarët

- Jeta në Kosovë "Dhuna në shkollë", Maj 2007
- "Siguria e Kujt?", e realizuar nga Zyra Për Çështje Gjimore (UNMIK), 2005

FAQE 0108

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

305(496.51)(048)

Monitorimi i sigurisë në Kosovë nga perspektiva gjinore / Udhëheqëse e
hulumtimit Sibel Halimi. - Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime Gjinore,
2007. - 100 f. : ilustr. ; 21cm.

1. Halimi, Sibel

ISBN 978-9951-8643-6-7

